



KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, 9.11.2016

SWD (2016) 363 Final

**DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT**

**Raporti i vitit 2016 për Kosovën\***

*Në përcjellje të dokumentit*

**Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve**

**Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016**

{COM(2016) 715 final}

\* Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS- të OKB-së 1244/199 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës

**SHQ**

1.	Hyrje.....	4
	1.1.Konteksti .....	4
	1.2.Përmbledhja e raportit.....	4
2.	KRITERET POLITIKE .....	6
	2.1.Demokracia .....	6
	2.2.Reforma e administratës publike.....	10
	2.3.Sundimi i ligjit .....	13
	2.4.Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	22
	2.5.Çështjet regionale dhe obligimet ndërkombëtare .....	30
3.	NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBIË.....	32
4.	KRITERET EKONOMIKE .....	33
	4.1.Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale .....	34
	4.2.Kapaciteti për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian .....	39
5.	STANDARDET EVROPIANE .....	42
	5.1. Tregu i brendshëm.....	42
	5.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave.....	42
	5.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta për themelim .....	44
	5.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit.....	45
	5.1.4. Dogana dhe tatimi .....	45
	5.1.5. Konkurrenca.....	46
	5.1.6. Prokurimi publik .....	48
	5.1.7. Ligji për pronën intelektuale .....	50
	5.1.8. Punësimi dhe politikat sociale, politika e shëndetit publik.....	50
	5.1.9. Arsimi dhe hulumtimi .....	52
	5.1.10.Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë.....	54
	5.2. Politikat sektoriale.....	54
	5.2.1. Industria dhe NVM-të .....	54
	5.2.2. Bujqësia dhe peshkataria.....	54
	5.2.3. Mjedisi dhe ndryshimet klimatike .....	56
	5.2.4. Politikat e transportit.....	58
	5.2.5. Energjia .....	59
	5.2.6. Shoqëria e informacioni dhe media .....	61
	5.2.7. Kontrolli financiar .....	62
	5.2.8. Statistikat.....	64
	5.3. Drejtësia, liria dhe siguria .....	65
	5.3.1. Vizat, menaxhimi i kufirit, azili dhe migrimi .....	66
	5.3.2. Shpërlarja e parave.....	68
	5.3.3. Narkotikët .....	68
	5.3.4. Policia .....	69
	5.3.5. Lufta kundër krimit të organizuar .....	69
	5.3.6. Lufta kundër terrorizmit .....	70
	5.3.7. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale.....	72
	Shtojca I – Marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës.....	73
	Shtojca II – Shtojca e statistikave .....	74

# Hyrje<sup>1</sup>

## 1.1 Konteksti

Më 1 prill 2016, hyri në fuqi Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA) në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Kjo është marrëveshja e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës, një kornizë gjithëpërfshirëse për dialog më të ngushtë politik dhe marrëdhënie ekonomike.

Kosova është përballur me sfida serioze të brendshme, të cilat i kanë penguar reformat që lidhen me BE-në në disa fusha. Tani ajo duhet të fokusohet në zbatimin e MSA-së, të udhëhequr nga Agjenda për Reforma Evropiane, për forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe reformimit të ekonomisë.

Kosova ka bërë një punë të mirë në zbatimin e reformave për sundimin e gjerë të ligjit, duke ia mundur Komisionit në këtë mënyrë të propozojë në maj 2016 vendosjen e Kosovës në listën e shteteve të zonës Shengen. Tani kjo çështje është në duart e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, në pritje të plotësimit të dy kërkesave të mbetura nga Kosova. Kosova mbetet e përkushtuar në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Ajo ka plotësuar detyrimet e mbetura rreth themelimit të Dhomave Speciale dhe ka zgjatur mandatin e Misionit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX).

## 1.2 Përmbledhja e raportit

Sa i përket **kritereve politike**, polarizmi në mes të qeverisë dhe opozitës ka vazhduar. Funksionimi normal i parlamentit është penguar gjatë një periudhe të raportimit, poashtu përmes përdorimit të masave të dhunshme nga anëtarët e opozitës. Të gjitha partitë politike duhet të shprehin përgjegjësi dhe të riangazhohen për dialog konstruktiv me parlamentin si forumi kryesor për debate politike. Kthimi i anëtarëve të opozitës në aktivitetet e parlamentit kohëve të fundit, është një hap shumë i mirëpritur.

Institucionet e Kosovës i kanë përmbushur obligimet e mbetura rreth themelimit të Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale për të hetuar akuzat për krime ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Procedurat për marrëveshje të dyanshme me vendin pritës të **Dhomave të Specializuara** (Holandën) kanë përfunduar. Mandati i EULEX-it është zgjatur deri në qershor të vitit 2018.

Kuvendi ka përfunduar shumicën e emërtimeve të institucioneve dhe agjencive të pavarura. Megjithatë, emërtimet u diskutuan si të ndikuara politikisht. Kjo ka dëmtuar funksionimin e pavarur dhe menaxhimin efektiv të këtyre organeve. Duhet bërë shumë përpjekje për të siguruar që emërtimet janë bërë duke u bazuar në merita.

Ekziston një nivel i përgatitjeve në fushën e reformave të administratës publike. Progresi i mirë përfshiu miratimin e strategjisë gjithëpërfshirëse të menaxhimit publik financiar dhe ligjit mbi procedurat e përgjithshme administrative. Megjithatë, politizimi i vazhdueshëm i administratës publike mbetet një shqetësim serioz. Organizimi i administratës së shtetit është fragmentuar dhe nuk siguron linja efektive të llogaridhënies dhe poashtu duhet të adresohet shkelja e përgjegjësive të agjencive të qeverisë. Mbikqyrja parlamentare e aktiviteteve të qeverisë duhet të rritet. Rekomandimet e institucioneve mbikqyrëse duhet të ndiqen për të siguruar qeverisje dhe llogaridhënie të përmirësuar.

Sistemi gjyqësor i Kosovës ndodhet në fazë të hershme. Hapa të rëndësishëm janë bërë gjatë periudhës së raportimit me miratimin e amandamenteve të kushtetutës dhe legjisllacionit dytësor për zbatimin e ligjeve të pakos së drejtësisë për vitin 2015.

---

<sup>1</sup> Ky raport mbulon periudhën nga muaji tetor 2015 deri në shtator 2016. Ai është i bazuar në të dhëna nga burime të ndryshme, duke përfshirë kontributin e qeverisë së Kosovës, shteteve anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informacionet nga organizatatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare. Si rregull, legjisllacioni dhe masat të cilat janë në përgatitje e sipër në pritje për miratim nga parlamenti nuk janë marrë parasysh.

Kosova poashtu ka emëruar shumicën e anëtarëve të institucioneve kryesore dhe ka vazhduar të rrisë **normën e përfundimit të rasteve**. Megjithatë, administrimi i drejtësisë është i ngadalshëm dhe joefikas dhe nuk ka llogaridhënie të mjaftueshme nga ana e zyrtarëve gjyqësor. Gjyqësori është ende i cenueshëm ndaj ndikimeve politike dhe institucionet e sundimit të ligjit vuajnë nga mungesa e fondeve dhe burimeve njerëzore.

Kosova është në fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjes në luftimin e korrupsionit. Kosova ka forcuar kapacitetet institucionale për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar me themelimin e ekipeve multi-disiplinare hetimore, krijimin e mekanizmit përcjellës për nivelin e lartë të korrupsionit dhe rastet e krimin të organizuar si dhe forcimin e departamentit të krimeve serioze të gjykatave themelore. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të lëndëve të hetuara dhe të ndjekura penalisht. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Vullneti më i fortë politik është i nevojshëm për t'a trajtuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Kosova është në fazë të hershme të luftimit të krimin të organizuar. Numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare mbetet i ulët. Mangësitë e legjislacionit ekzistojnë ende dhe zbatimi duhet të përmirësohet në veçanti rreth çështjes së shpërlarjes së parave, konfiskimit dhe sekuestrimit të aseteve dhe hetimit financiar. Ndikimi i tepruar gjatë hetimeve dhe mungesa e angazhimit strategjik politik pengojnë luftën kundër krimin të organizuar. Kosova ka vazhduar me përpjekjet e saj për të luftuar terrorizmin por ende përballet me sfida në këtë fushë.

Është bërë progres në fushën e të drejtave të njeriut përmes hapave të ndërmarrë në zbatimin e pakos së ligjeve të vitit 2015 mbi të drejtat e njeriut dhe deklaratave për mbështetjen e të drejtave të personave të komunitetit LGBT. Megjithatë, zbatimi vazhdon të pengohet nga mungesa e burimeve dhe angazhimit politik, veçanërisht në nivel lokal. Duhet të punohet më shumë për të garantuar në mënyrë efektive të drejtat për pronësi dhe për të adresuar çështjet e kthimit dhe riintegritimit të personave të zhvendosur, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe dhunën në baza gjinore. Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve dhe personave me aftësi të kufizuara duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme. Kosova është në nivel të përgatitjes në fushën e lirisë së të shprehurit. Ka pasur zhvillime shqetësuese gjatë periudhës së raportimit, duke përfshirë kërcënimet ndaj gazetarëve. Kuvendi ka shprehur angazhim të kufizuar për gjetjen e një zgjidhjeje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë atë të pambrojtur ndaj presioneve politike. Nuk ka pasur zhvillime rreth rregullores mbi pronësinë e medias dhe transparencës.

Në lidhje me **normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova ishte e përkushtuar në zbatimin e marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Progresi është penguar poashtu nga procesi elektoral në Serbi dhe situata e brendshme në Kosovë. Megjithatë, vrulli i punës u rikthye në gusht 2016 me fillimin e punimeve në urën e Mitrovicës dhe lirisë së lëvizjes. Përpjekjet e vazhdueshme janë të nevojshme për zbatimin e marrëveshjeve tashmë të arritura. Hapat e bërë duhet të kenë ndikim pozitiv dhe konkret në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë dhe Serbi.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova është në fazë fillestare të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Është bërë progres veçanërisht në mbështetjen e bizneseve të orientuara nga eksporti, përmirësimin e zbatimit të kontratave, veçanërisht në sektorin financiar dhe qasjen në financa. Megjithatë, vendimet fiskale të paqëndrueshme lidhur me përfitimet e veteranëve të luftës mund të kenë efekte negative në stabilitetin makroekonomik të Kosovës dhe marrëdhëniet e saj me institucionet financiare ndërkombëtare. Deficiti i vazhdueshëm tregtar reflekton një bazë të dobët të prodhimit dhe konkurrencës së dobët ndërkombëtare. Mbështetja në remitanca dhe përhapja e ekonomisë joformale gjithashtu ulin nxitjen e punësimit, në këtë mënyrë duke rezultuar në pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore, veçanërisht në mesin e grave dhe shkallë të lartë të papunësisë, në veçanti në mesin e punëtoreve të rinj dhe të pakualifikuar.

Kosova është në fazë fillestarë të ndërtimit të kapaciteteve për t'u përballur me presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. Nuk është bërë progress në përmirësimin e cilësisë së edukimit, i cili është udhëheqës kryesor për përmirësimin e rritjes dhe konkurrencës afatgjatë.

Kosova është në fazë fillestare të përafrimit me **standardet evropiane**. Përafrimi legjislativ ka vazhduar në disa fusha por zbatimi është i dobët. Është bërë progres në fushën e doganës, veçanërisht në luftimin e korrupsionit, mbledhjes së të ardhurave dhe uljen e shpenzimeve administrative të eksporteve por Kosova duhet të rrisë luftën kundër ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal. Sektori energjik vazhdon të përballlet me probleme, ku asnjë përparim nuk është bërë në mbylljen e termocentralit Kosova A ose në renovimin e Kosova B ndërsa shumë pak progres është arritur në fushën e energjisë së ripërtëritshme.

## **2. KRITERET POLITIKE**

### **2.1 Demokracia**

Që nga viti 2008, Kosova ka konsoliduar funksionimin e institucioneve demokratike. Megjithatë, viti i kaluar solli sfida serioze për shkak të polarizmit të thellë në mes të qeverisë dhe opozitës. Ndarjet mbi çështjet siç është marrëveshja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe dialogu me Serbinë, ka dominuar agjendën politike të Kosovës duke çuar në ngërç të zgjatur politik. Përpyetje më të mëdha duhen bërë nga të gjithë aktorët për të arritur koncensus në të gjithë spektrin politik, në mënyrë që Kosova të avancojë në çështjet kryesore që kanë të bëjnë me BE-në.

Përkundër rrethanave të vështira, marrëdhëniet BE-Kosovë janë forcuar. Marrëveshja për Stabilizim Asociim hyri në fuqi më 1 prill 2016, duke u bërë marrëdhënia e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës. Kosova ka zbatuar reforma për sundimin e gjerë të ligjit, duke duke ia mundur Komisionit në këtë mënyrë të propozojë në maj 2016 vendosjen e Kosovës në listën e shteteve të zonës Shengen.

Situata në veri të Kosovës mbetet e qetë dhe komunikimi në mes të kryetarëve në veri dhe institucioneve qendrore është përmirësuar. Punët e ndërtimit në urën e Mitrovicës, një çështje tejet simbolike, filluan gjatë verës me qëllim të hapjes së urës për të gjithë trafikun në janar 2017. Kosova ka përmbushur detyrimet e mbetura në lidhje me themelimin e Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale për të hetuar krimet e kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Mandati i EULEX-it është zgjatur deri në qershor 2018.

### **Zgjedhjet**

Kuadri zgjedhor i Kosovës është në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithatë reforma zgjedhore, e udhëhequr nga Komisioni i Venecias, mbetet e nevojshme. Auditimet e pavarura të financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore të partive, siç parashihet në ligjin për financimin e partive politike nuk janë kryer në tri vitet e fundit. Kjo duhet të bëhet më së voni para zgjedhjeve të ardhshme. Kuvendi duhet të fillojë një debat institucional, duke përfshirë të gjitha partitë politike me qëllim të sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies mbi financat e partive politike dhe kontributeve të fushatës.

### **Parlamenti**

Kuvendi duhet të luajë rol kyç në garantimin e kontrollave të duhura dhe balancit të nevojshëm në një demokraci parlamentare. Është përgjegjësi e të gjithë deputetëve të sigurojnë që kuvendi mund t'a përmbushë këtë rol. Bojkotet dhe pengesat e vazhdueshme të dhunshme kanë ndikuar negativisht në aktivitetet parlamentare gjatë një pjese të periudhës së raportimit. Shkelja e procedurave parlamentare vazhdon të mbetet shqetësim.

Funksionimi normal i parlamentit u pengua gjatë një pjese të periudhës së raportimit, me anë të disa mjeteve të dhunshme duke përfshirë gazin lotësjellës, nga ana e disa anëtarëve të opozitës. Kjo ka çuar në tensionime dhe arrestime të një numri të deputetëve opozitarë në ambientet e Kuvendit. Të gjitha partitë politike duhet të tregojnë përgjegjësi dhe të riangazhohen për dialog konstruktiv me kuvendin si forumi kryesor për debate politike. Kthimi i anëtarëve të opozitës në aktivitetet e parlamentit kohëve të fundit, është një hap shumë i mirëpritur.

Përkundër polarizmit serioz politik, agjenda evropiane mbeti një element unifikues në të gjithë spektrin politik. Në nëntor, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) me BE-në. Në maj 2016, u mbajt takimi i parë i komitetit parlamentar të Stabilizim Asociimit në mes të BE-së dhe Kosovës, në të cilin morrën pjesë anëtarët e opozitës. Kuvendi zgjodhi dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese në nëntor 2015 dhe caktoi Auditorin e Përgjithshëm në mars 2016.

Gjatë periudhës së raportimit, Kuvendi ka përfunduar shumicën e emërimeve në institucionet dhe agjencitë e pavarura. Megjithatë, emërimet u diskutuan si të ndikuara politikisht. Emërimet duhen bërë në bazë të procedurave të përzgjedhjes të bazuara në merita dhe transparente për të siguruar funksionimin e pavarur dhe menaxhimin efektiv të këtyre organeve. Kuvendi ka dështuar në mbikqyrjen e duhur të institucioneve të pavarura, autoriteteve rregullatore apo agjencive, raportet e të cilave shpesh janë miratuar pa ose pa marrë plotësisht parasysh rezultatet e debateve. Mungesa e mandateve të qarta, raportimit të përshtatshëm dhe mekanizmave të llogaridhënies si dhe fragmentimi institucional vazhdojnë të paraqesin problem për reforma mbikqyrëse dhe efektive.

Disa ligje të rëndësishme janë miratuar përmes procedurave të përshpejtuara. Shkeljet e rregullave të procedurave kanë ndodhur shpesh. Mungesa e deputetëve shpesh ka çuar në mungesë të kuorumit dhe seanca të parregullta të komisionit dhe atyre plenare. Seancat e mbajtura kishin agjendë të stërngarkuar. Praktikrat e tilla nuk janë të dobishme për raportin gjithëpërfshirës parlamentar dhe rrezikojnë dobësimin e rolit mbikqyrës të kuvendit.

Kuadri rregullator për Kuvendin duhet të përmirësohet. Kontrollat parlamentare, balancet dhe kontrollat buxhetore duhet të forcohen dhe ende nuk ka një mekanizëm që siguron se rekomandimet e komitetit për mbikqyrjen e financave publike janë zbatuar. Kuvendi duhet të forcojë konsultimet me shoqërinë civile, veçanërisht në lidhje me ligjet e rëndësishme. Kuvendi duhet të marrë rol më të fortë në ofrimin e sigurisë që raportet dhe rekomandimet e zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Avokatit të Popullit të ndiqen nga Qeveria.

Komitetet e Kuvendit vazhduan punën e tyre në monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe kanë mbajtur seance shqyrtimi të rregullta me ministrat. Kapaciteti i Komitetit për Integritet Evropian duhet të rritet për të pasqyruar rolin e tij kryesor në avancimin e reformave që lidhen me BE-në. Ekzaminimi më i mirë i projekt-legjislacionit është i nevojshëm për të siguruar përafrimin me *acquis*.

Në mars 2016, Kryesia e Kuvendit ka miratuar një plan strategjik për vitin 2016-2020 i cili përmban objektiva konkrete për të rritur aftësinë e Kuvendit për të përmbushur rolin e vet kushtetues.

## Qeverisja

Polarizimi i vazhdueshëm në mes të qeverisë<sup>2</sup> dhe opozitës<sup>3</sup> ka tensionuar qeverisjen në Kosovë. Ka pasur poashtu tensione të ngritura brenda koalicionit qeverisës. Sfidat mbi planifikimin strategjik në qendër të qeverisë kanë penguar zbatimin e reformave që lidhen me BE-në dhe fushat kryesore të qeverisjes. Prioritizimi më i madh, veçanërisht në kontekstin e implementimit të MSA-së, duhet të në përqendrimin e përpjekjeve të reformave.

Politarizimi i spektrit politik në Kosovë ka shfaqur sfida serioze për qeverisjen. Pas zgjedhjes së Hashim Thaçit si President më 25 shkurt, ka pasur ndërrime edhe në qeveri me emërimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm dhe atij të Drejtësisë.

Në dhjetor të vitit 2015, **qeveria** miratoi një agjendë ambicioze legislative dhe planin vjetor të punës për vitin 2016. Ajo poashtu ka përgatitur Strategjinë për Zhvillim Kombëtar 2016-2021 dhe Programin për Reforma Ekonomike. Në dhjetor 2015, qeveria miratoi Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, në të cilin u përcaktuan prioritetet afatmesme dhe të shkurtëra. Miratimi i këtyre dokumenteve është një hap i mirëpritur dhe këto dokumente duhet t'a udhëheqin Kosovën në reformat e saj socio-ekonomike strukturale. Megjithatë, fokusi i dobët politik dhe mungesa e bashkëpunimit në mes të partive në pushtet mbeten pengesat e të bërit progres në reformat mëse të nevojshme. Qeveria vazhdon të përballlet me vështirësi në përmbushjen e afateve të përcaktuara në strategjitë dhe planet e punës. Vendimet ad hoc me ndikim të dukshëm buxhetor kanë dëmtuar qëndrueshmërinë financiare dhe kanë dobësuar aftësitë e Qeverisë për t'u fokusuar në prioritetet reale. Fokusi i veçantë në prioritetet kryesore, veçanërisht në Agjendën për Reforma Evropiane dhe koordinimi i fortë ndërministror janë vendimtarë në këtë drejtim.

Përzgjedhjet e mëhershme të kandidatëve për emërimë në borde të ndryshme të qeverisë dhe nominimet për agjencitë e pavarura janë shpesh të bazuara në përkatësinë politike dhe jo sa duhet në kriteret profesionale. Përzgjedhja dhe procedurat e emërimit duhet të jenë të rregulluar në mënyrë të qartë dhe të bëhen më transparente. Akuzat e fundit për ndërhyrje politike në rekrutim dhe procese vendimmarrëse në institucionet publike, të bazuara në përgjimet e telefonave, ngrenë shqetësim dhe duhet të hetohen. Mospjesëmarrja e ministrave në seancat plenare dhe dështimi për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare pengon transparencën, llogaridhënien dhe komunikimin me kuvendin, në veçanti me opozitën. Qeveria duhet vazhdimisht të ndjekë rekomandimet e përfshira në raportet e kuvendit.

Duhet treguar kujdes për të siguruar që ligjet janë në përputhje me standardet evropiane dhe i përmbushin detyrimet e MSA-së. Ministrat duhet t'i përmbahen çdo pjese të legjisllacionit derisa ai të miratohet dhe duhet të japin shpjegime me kohë në Kuvend. Agjenda legislative mbetet subjekt i ndryshimeve të shpeshta. Praktikrat e ndryshimit të përsëritur të ligjeve dëmton stabilitetin e legjisllacionit dhe tregon mangësi në planifikimin dhe koordinimin në zemër të qeverisë, e cila dobëson mbikqyrjen parlamentare.

Progres është bërë **në qeverisjen lokale**, veçanërisht në marrëdhëniet mes pushtetit qendror dhe lokal, duke përfshirë komunat me shumicë serbe në veri. Ka pasur përmirësime të mëtejshme në përputhjen komunale me ligjin për vetëqeverisjen lokale. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka udhëhequr hartimin dhe zbatimin e planeve komunale në lidhje me detyrimet e lidhura me BE-në për 38 komuna. Miratimi i ligjit për regjistrimin e popullsisë për komunat me shumicë serbe në veri është shtyrë për shkak të mungesës së mbështetjes në nivel qendror dhe lokal.

Organet legislative dhe ekzekutive të komunave duhet të vazhdojnë të rrisin transparencën dhe llogaridhënien e tyre publike ndërsa kuvendet komunale duhet të forcojnë rolin e tyre mbikqyrës. Me 38 komuna, një numër i madh duke pasur parasysht madhësinë e Kosovës, duhet të ndërmerren hapa për të racionalizuar qeverisjes lokale, me qëllim të inkurajimit të shpërndarjes efikase dhe demokratike të shërbimit dhe forcimin e qeverisjes përgjegjshme.

---

<sup>2</sup> Serb Citizen's Initiative 'Srpska' and non-Serb minority group '6+'. Koalicioni qeverisës: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Iniciativa Qytetare Serbe 'Srpska' dhe grupi i pakicës jo-serbe "6+"

<sup>3</sup> Partitë opozitare: Vetëvendosje (VV), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma për Kosovën (NISMA).

Gjatë vitit 2015, gjashtë komuna, duke përfshirë edhe katër komunat veriore, nuk arritën të miratojnë buxhetet e tyre 2016 brenda limiteve të përcaktuara nga Ministria e Financave. Në vend të kësaj, komunat në veri miratuan buxhetet e tyre në përputhje me kuadrin ligjor vetëm në shkurt të vitit 2016, kur ata morën garanci për një rritje gjatë rishikimit të buxhetit në mes të vitit 2016.

**Avokati i Popullit** ka filluar zbatimin e ligjit të vitit 2015 për Avokatin e Popullit, me raportimin të rritur dhe të përmirësuar, në këtë mënyrë duke forcuar institucionin. Legjislacioni sekondar ende duhet të miratohet. Në vitin 2015, Avokati i Popullit pranuar 1 995 raste, 10% më pak se në vitin 2014. Përderisa ndjekja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit është rritur, institucionet e nivelit qendror dhe lokal duhet të bëjnë më shumë në vazhdimësi. Qeveria ofroi premise adekuate për Institucionin e Avokatit të Popullit në gusht 2016. Kuvendi dhe qeveria duhet të sigurojnë pavarësinë financiare, funksionale dhe organizative të Institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me standardet ndërkombëtare për institucionet kombëtare të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit ende ka nevojë të emërojë zëvendës.

### **Shoqëria civile**

Janë bërë disa përparime në përmirësimin e bashkëpunimit midis qeverisë dhe shoqërisë civile. Standardet minimale për konsultime publike janë miratuar dhe tani duhet të zbatohen në të gjitha nivelet e qeverisjes. Mungesa e vullnetit politik nënkupton që pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin e politikave mbetet e pabarabartë. Mungesa e transparencës në financimin publik për shoqërinë civile mbetet një shqetësim.

Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponent i rëndësishëm i çdo sistemi demokratik dhe duhet të njihet dhe të trajtohet si e tillë nga institucionet në Kosovë. Shoqëria civile duhet të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në debatin demokratik dhe të merr pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave publike.

Nën kornizën e tanishme ligjore, mundësia e ndërhyrje të pajustificuar në qeverisje dhe aktivitetet e OJQ-ve, duke përfshirë pezullimet e brendshme, mbetet një çështje. Duhet treguar kujdes për të siguruar që në rast vendimi për pezullim nga një organ administrativ mund të bëhet ankesë në gjykatë në kohën e duhur dhe në mënyrë transparente. Qeveria dhe Kuvendi nuk konsultohen në mënyrë adekuate me shoqërinë civile me qëllim për të siguruar që respektimi i dispozitave kufizuese që ndikojnë në shpërlarjen e parave dhe legjislacionin kundër terrorizmit nuk e pengojnë së tepërmi aftësinë efektive të OJQ-ve për të vepruar.

Progres është bërë në prill me miratimin e standardeve minimale për konsultime me publikun, të cilat janë projektuar në mënyrë përfshirëse dhe transparente. Mungesa e angazhimit nga shumë ministri dhe burimet e pamjaftueshme të kapaciteteve dhe ato buxhetore pengojë përpjekjet për zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe vazhdojnë të hedhin dyshime mbi vullnetin themelor politik. Kapaciteti i shoqërisë civile në Kosovë për t'u angazhuar në mënyrë efektive mbetet i pabarabartë. Është identifikuar një model i rregulluar për të siguruar mekanizma transparente për shpërndarjen e financimeve publike për organizatat e shoqërisë civile. Informacionet mbi të gjitha fondet publike të shpërndara për organizatat e shoqërisë civile duhet të bëhen lehtësisht të qasshme për publikun. Legjislacioni dhe udhëzimet administrative që mbulojnë të gjitha nivelet përkatëse të qeverisë duhet të miratohen. Kuadri ligjor për zbritje tatimore për donacionet mbetet i paqartë.

### **Mbikqyrja civile e forcave të sigurisë**

Për shkak të ngërcit politik dhe bojkoteve në parlament, ka pasur progres të kufizuar në punën e



komisionit parlamentar për punë të brendshme, siguri dhe mbikqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të komisionit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Komisioni parlamentar ka organizuar seanca dëgjimore për ligjet që kanë të bëjnë me policinë dhe regjistrin civil por nuk ka ushtruar mbikqyrje të shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Lidhja e ngushtë në mes të parlamentarëve të komisioneve përkatëse dhe udhëheqësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës ka penguar mbikqyrjen e pavarur. Procesi i verifikimit ka vazhduar të përmirësohet por ky proces më tepër kryhet nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë sesa nga një organ i pavarur. Në qershor 2016, Forca e Sigurisë publikoi planet e integritetit.

Këshilli i Sigurisë i Kosovës mbajti takime më të rregullta. Sekretariati i tij koordinon zbatimin e strategjisë së Kosovës mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm për vitin 2015-2020.

## 2.2 Reforma e administratës publike

Kosova është në nivel të përgatitjeve për reformën e administratës së saj publike. Është bërë progres me miratimin e strategjisë gjithëpërfshirëse për menaxhimin publik financiar dhe të ligjit mbi procedurat e përgjithshme administrative. Megjithatë, Kosova nuk i ka adresuar rekomandimet e Komisionit në fushën e përgjegjësisë. Rekrutimi i pabazuar në merita vazhdon të ndikojnë negativisht në efektivitetin, efikasitetin dhe pavarësinë e administratës publike. Raportet e para të monitorimit mbi zbatimin e pakos së reformave të administratës publike kanë treguar vonesa të konsiderueshme. Poashtu ka pasur shqetësime serioze rreth qëndrueshmërisë financiare të reformave. Duke pasur parasysh agjendën ambicioze të reformave të Kosovës, angazhimi i vazhdueshëm politik është vendimtar për të siguruar zbatimin e saj. Gjatë vitit të ardhshëm Kosova duhet në vecanti:

→ t'i rishikojë të gjitha organet e pavarura dhe të fillojë zbatimin e rekomandimeve të rishikimit në mënyrë që të përmirësojë llogaridhënien, eliminojë shkeljen e kompetencave dhe të sigurojë një administratë më të strukturuar;

→ të sigurojë që pakoja e planifikuar legjislative e cila mbulon shërbimin publik, pagat dhe organizimin e administratës së shtetit të jetë e përgatitur në mënyrë të koordinuar në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi në bazë të nocioneve të miratuara në nivel qeverisës;

→ të adresojë çështjen e rritjes së grumbullimit të rasteve administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës, duke siguruar fonde për rritjen e numrit të gjykatësve dhe duke përmirësuar kushtet e punës në Gjykatë (p.sh. duke lehtësuar zbatimin e sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve).

### Zhvillimi i politikave dhe koordinimi

Ekzistojnë baza ligjore dhe strukturat institucionale për një sistem të krijimit të politikave koherent dhe të koordinuar, duke përfshirë integrimin evropian. Kosova ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së por ky i fundit është vetëm pjesërisht në përputhje me planin vjetor të punës së qeverisë. Planifikimi i politikave është i paqëndrueshëm dhe nuk i është dhënë prioritet në nivelin qëndror. Strategjive sektoriale u mungon cilësia e kontrollit dhe janë të përafuara shumë rrallë me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në këtë mënyrë janë financiarisht të paqëndrueshme. Edh pse të gjitha strategjitë dhe politikat duhet të përmbajnë analiza të ndikimit buxhetor ato nuk kryhen gjithnjë. Qëllimi i tyre është i kufizuar për të vlerësuar nëse shpenzimet janë brenda buxhetit, jo nëse propozimet janë me kosto efektive.

Disa aspekte të politikave gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi dhe atyre të zhvillimit

**legjislativ** janë në rregull. Vlerësimet e ndikimit rregullativ dhe buxhetor ndryshojnë për nga cilësia dhe nuk përdoren në mënyrë të vazhdueshme. Konsultimet e brendshme dhe të jashtme janë të rregulluara dhe është arritur progres në miratimin e standardeve minimale për **konsultime publike** në prill 2016. Zbatimi efektiv dhe sistematik është i nevojshëm, vecanërisht për shkak se afatet e shkurtëra kohore për konsultime publike pengojnë kontributin efektiv të shoqërisë civile. Konsultimet e kufizuara mbi ligjet dhe strategjitë me interes të vecantë politik apo ekonomik mbeten një shqetësim (*shih shoqëria civile*).

Mungesa e raportimit të detajuar mbi zbatimin e planit vjetor të punës së qeverisë dhe strategjive sektoriale pengon **shqyrtimin efektiv të punës së qeverisë**. Shqyrtimi parlamentar i qeverisë është poashtu i pamjaftueshëm.

#### Menaxhimi i financave publike

Në qershor 2016, Kosova miratoi **strategjinë e reformave për menaxhimin e financave publike (MFP)** për vitin 2016-2020. Kjo është një nga katër strategjitë që formojnë “pakon strategjike” për reforma të administratës publike. Ajo është plotësuar poashtu nga strategjitë për kontroll të brendshëm financiar dhe prokurimit publik. Sistemi i MFP mbështet disiplinën fiskale mirëpo parashikimi makroekonomik dhe i të ardhurave duhet të përmirësohet. Borxhi publik është mesatarisht i ulët edhe pse huamarrja e brendshme dhe ndërkombëtare është rritur dhe angazhimet buxhetore duhet të kontrollohen për të kufizuar detyrimet e prapambetura. Një nga sfidat kryesore për reformimin e MFP-së do të jetë shkrirja e administratës tatimore dhe doganore. Përmirësimeve në cilësinë e buxhetimit afatmesëm, përgatitjes së buxhetit dhe informacioneve mbi investimet kapitale u është dhënë prioritet për të rritur kredibilitetin e buxhetit (*shih kontrollin financiar*).

**Transparenca buxhetore** është e kufizuar mirëpo është duke u përmirësuar. Informacionet rreth buxhetit (dokumenti i buxhetit, deklaratat mujore, raportet e tremujorit, raporti i mesit të vitit dhe raporti vjetor financiar) janë në dispozicion për publikun në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Dokumenti i buxhetit për vitin 2015 ishte i vështirë për tu kuptuar nga publiku i gjerë. Informacionet rreth buxhetit duhen të jenë më lehtë të qasshme dhe më të plota për të siguruar përgjegjshmëri. Dokumentet e buxhetit shpesh nuk janë të krahasueshme pasi që detajimi i buxhetit nuk është konsistent. Shqyrtimi i financave publike është përgjegjësi e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Raportet e kësaj zyreje janë publikuar rregullisht dhe ekziston një mekanizëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të auditimit, por ky nuk funksionon si duhet. Një dobësi kyçe e transparencës është se ka ndryshime të shpeshta të buxhetit gjatë vitit kalendarik pa deklarime transparente apo shpjegime të këtyre variacioneve.

#### Shërbimi publik dhe menaxhimi i resurseve njerëzore

Ligji mbi shërbimin civil përcakton një sistem të vetëm dhe unitar të shërbimit publik në nivel të pushtetit komunal dhe qendror. Ligji aktual zyrtarisht parashikon **rekrutime, ngritje në detyrë dhe shkarkime të bazuara në merita**, në bazë të kriterëve objektive mirëpo zbrastësitat e ligjit lejojnë praktika kontradiktore, kryesisht në konvertimin e personelit të përkohshëm në shërbyes civil të përhershëm pa konkurs publik. Ministria e Administratës Publike nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për t’i mbikqyrur në mënyrë aktive procedurat e rekrutimit, të cilat janë bërë në mënyrë të decentralizuar. Ndikimi politik rreth emërimeve dhe shkarkimeve vazhdon të jetë një shqetësim serioz, sidomos në zgjedhjen e menaxhmentit të lartë. Komunitetet jo-shumicë ende nuk përfaqësohen në mënyrë adekuate në institucionet publike qendrore.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës nuk është përdorur në mënyrë të mjaftueshme për të monitoruar zbatimin e ligjit mbi shërbimin civil dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme. Rreth 75% e rekomandimeve dhe vendimeve të saj janë zbatuar. Gjyqtarët administrativë janë të mbingarkuar, gjë që

shpesh çon në vendime të vonuara.

Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për koordinimin qendror **të menaxhimit të burimeve njerëzore**, por burimet e saj janë shumë të kufizuara. Është duke u punuar në një sistem të klasifikimit që nga janari 2016 dhe pritet që ky sistem të çojë në një aplikim më të njëtrajtshëm të legjislacionit dhe parimeve. Progres është bërë në shtrirjen e sistemit të informacionit të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha institucionet, por sistemi nuk është azhurnuar dhe nuk kryen të gjitha detyrat e obligueshme të përcaktuara në legjislacion. Ekziston një mungesë e menaxhimit profesional të burimeve njerëzore për shkak të politizimit dhe kapacitetit të kufizuar.

**Sistemi i pagave** nuk ofron pagesa të barabarta për punë të barabarta. Koeficientë të ndryshëm të pagave aplikohen për pozita të njejtë. Kjo minimizon barazinë dhe nuk ofron stimulim për mbajtjen dhe rekrutimin e stafit profesional. Megjithatë, heqja e sistemit të pagesave me para të gatshme është një hap drejt pagesave të drejta dhe transparente. Zhvillimi profesional i shërbyesve civil ka përparuar mirëpo jo të gjithëve u ofrohet trajnim. Vlerësimet e performancës nuk zbatohen ende në mënyrë sistematike dhe ato kanë pak ndikim në zhvillimin e karrierës.

Kosova ka miratuar masa dhe mekanizme për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e **integritetit në shërbimin publik**. Pak progres është bërë në krijimin e një sistemi të informacioneve rreth masave disiplinore dhe monitorimit të zbatimit të kodit të etikës.

#### Llogaridhënia e administratës

Administrata shtetërore është e organizuar në mënyrë të fragmentuar, e cila nuk siguron **linja efektive të llogaridhënies**. Ligji mbi administratën shtetërore ka lejuar formimin e 46 agjencive qeveritare, përgjegjësitë e të cilave shpesh përputhen. Për më tepër, mbi 30 institucione jo-kushtetuese i raportojnë drejtpërdrejt kuvendit, i cili ka mungesë të fuqisë dhe kapacitetit për t'i mbikëqyrur ato. Shumë prej këtyre institucioneve dhe agjencive qeveritare nuk janë në përputhje me ligjin mbi shërbimin civil, duke kontribuar kështu në fragmentimin e mëtejshëm të administratës. Linjat e llogaridhënies brenda shumë institucioneve janë të dobëta dhe nuk ka delegim të qartë të përgjegjësive të menaxhimit të mesëm (*shih kontrollin financiar*). Qeveria është angazhuar për zhvillimin e ligjit për organizimin e administratës shtetërore në përputhje me ligjin për shërbimin civil dhe ligjit për pagat, për të siguruar një administratë publike më të përgjegjshme dhe të depolitizuar.

**E drejta e qytetarëve për administratë të mirë** është duke u adresuar nga institucionet mbikqyrëse siç është Auditori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit. Rekomandimet e tyre nuk janë zbatuar sistematikisht nga të gjitha institucionet edhe pse ka pasur disa përmirësime gjatë periudhës së raportimit. **E drejta për qasje në informata publike** është e rregulluar me ligjin mbi qasjen në dokumente publike. Gjatë dy viteve të fundit numri i kërkesave pa përgjigje ose të refuzuara ishte i ulët. Ligji i ri për procedurat e përgjithshme administrative, i miratuar në maj të vitit 2016, synon të përmirësojë **të drejtën për drejtësi administrative**, së bashku me ligjin e ri të planifikuar për mosmarrëveshjet administrative. Rritja e numrit të punëve të papërfunduara në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative është duke e dëmtuar besimin publik ndaj sistemit gjyqësor. Numri i rasteve të papërfunduara arriti në 5 380 deri në fund të vitit 2015, një rritje prej 1 341 nga viti 2014. **E drejta për të kërkuar kompensim** nuk është ende e sigurt sepse legjislacioni është i fragmentuar dhe nuk ka ligj të veçantë mbi përgjegjësinë publike.

## Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset

Qeveria është e angazhuar për një **administratë të orientuar drejt përdoruesit**. Megjithatë, politikbërja koherente shpesh është dëmtuar nga mungesa e koordinimit dhe vizionit të përbashkët midis ministrive përgjegjëse. Zhvillimi i shërbimeve elektronike është i ngadalshëm për shkak të mungesës së një kornize të përshtatshme të ndërveprimit. Legjislacioni mbi qasjen e barabartë në shërbime ekziston mirëpo aplikimi i tij mbetet një sfidë, sidomos për personat me nevoja të veçanta. Progres i mirë është arritur me thjeshtimin e **procedurave administrative** në saje të miratimit të ligjit të ri mbi procedurat e përgjithshme administrative. Megjithatë zbatimi i ligjit kërkon një inventar paralel të procedurave speciale administrative, të cilat duhet ose të hiqen ose të vihen në përputhje me ligjin.

## Korniza strategjike për reformën e administratës publike

**Korniza strategjike për reformën e administratës publike**, nën ombrellën e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2015-2020, përbëhet nga strategji për rregullim më të mirë, planifikim dhe koordinim të politikave, modernizimin e administratës dhe menaxhimin e financave publike. Raporet vjetore të raportimit për vitin 2015 në tri strategjitë e para tregojnë ose objektiva tejet ambicioze ose mungesa të indikatorëve të duhur, të cilat shpjegojnë vonesat në zbatim. Qeveria ka rënë dakord për të adresuar këto mangësi deri në fund të vitit 2016. **Mbështetja politike** për reformën e administratës publike dhe drejtimi efektiv nga ana e Këshillit të Ministrave vazhdojnë të mbeten të nevojshëm për të siguruar një zbatim efektiv. **Qëndrueshmëria financiare** e reformave duhet të sigurohet në buxhetin e vitit 2017 dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

### **2.3 Sundimi i ligjit**

#### **Funksionimi i gjyqësorit**

Kosova gjendet në **fazë të hershme** të zhvillimit të një sistemi gjyqësor funksional. **Progres** është arritur gjatë vitit të fundit në miratimin e amandamenteve të kushtetutës dhe legjislacionit sekondar të nevojshëm për zbatimin e pakos së ligjeve për drejtësi. Kosova poashtu ka emëruar shumicën e anëtarëve të institucioneve kryesore dhe ka vazhduar të rrisë normën e përfundimit të rasteve, në këtë mënyrë duke përmbushur dy nga rekomandimet e vitit 2015. Megjithatë, administratë e drejtësisë është e ngadalshme dhe joefikase dhe nuk ka llogaridhënie të mjaftueshme nga zyrtarët gjyqësor. Gjyqësori është ende i rrezikuar nga influenza politike dhe institucionet e sundimit të ligjit vuajnë nga mungesa e fondeve dhe burimeve njerëzore. Për të adresuar mangësitë e përshkruara më poshtë, Kosova duhet që në vitin e ardhshëm:

- të vazhdojë zbatimin e pakos së drejtësisë, duke përfshirë edhe miratimin e legjislacionit sekondar të mbetur;
- të forcojë burimet financiare për sektorin gjyqësor dhe të vazhdojë forcimin e kapaciteteve të gjykatësve, prokurorëve dhe stafit mbështetës, për të siguruar funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe administrimit të gjykatave ;
- të zëvendësojë dispozitat aktuale të përfshira në ligjet mbi Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial duke miratuar ligjin mbi Zyrën e Prokurorit Disiplinor për të forcuar përgjegjshmërinë;
- të shtojë përpjekjet për të ulur numrin e rasteve të grumbullura, duke përfshirë përdorimin e mjeteve alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

## Dokumentet strategjike

Zbatimi i **planit strategjik për vitin 2014-2019** për gjyqësorin e Kosovës, strategjisë së komunikimit për vitin 2014-2019 dhe strategjisë për uljen e numrit të rasteve të grumbulluara vazhdon me qëllim të përmirësimit të funksionimit të përgjithshëm të gjyqësorit.

## Organet menaxhuese

Sipas kushtetutës, **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)** dhe **Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)** janë përgjegjës për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Në shkurt, pas rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe Komisionit Evropian, Kuvendi miratoi një ndryshim kushtetues mbi përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku shumica e anëtarëve të tij janë zgjedhur nga kolegët e tyre – 7 nga 13 anëtarët janë duke u emëruar nga gjyqtarët dhe gjashtë të tjerë nga Kuvendi. Amandamenti forcon pavarësinë e gjyqësorit nga ndikimi politik, i cili është një hap i mirëpritur. Dy nga gjashtë anëtarët e emëruar duhet të jenë të komunitetit kosovar/serb dhe dy nga komunitetet e tjera pakicë. Një nga gjashtë anëtarët jo gjyqësor pritet të emërohet. Pas ndryshimeve të ligjit mbi Këshillin Prokurorial në dhjetor 2015, 10 nga 13 anëtarët e Këshillit Prokurorial u emëruan nga prokurori, ndërsa 3 të tjerët pritet të emërohen nga Kuvendi. Që nga janari, Këshilli Prokurorial kontrollon burimet e veta buxhetore. Këshilli Gjyqësor paraqet buxhetin e vet drejtpërdrejt tek Kuvendi. Takimet e të dy këshillave vazhdojnë të jenë të hapur për median dhe publikun. Të dy këshillat hartojnë dhe miratojnë raportet vjetore dhe i publikojnë në internet mirëpo mekanizmi i tyre i raportimit duhet të përmirësohet. KGJK lëshoi raportin me një vonesë të konsiderueshme, ndërkohë që raporti i KPK nuk është prezantuar ende.

Në përputhje me marrëveshjen në mes të Beogradit dhe Prishtinës, KGJK DHE KPK publikuan konkursin e dytë në mars 2016 dhe janë duke rekrutuar 14 gjyqtar serb nga Kosova, 115 pjesëtarë të stafit mbështetës, 6 prokurorë dhe 34 pjesëtarë të stafit mbështetës të prokurorisë. Ky është një hap i madh përpara.

Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial vazhdojnë të miratojnë dokumente strategjike, rregullore, vendime dhe akte të tjera me vonesa të konsiderueshme. Ata duhet ende të miratojnë 9 nga 35 rregulloret dhe udhëzimet e kërkuara nga pakoja e ligjeve për drejtësi e korrikut të vitit 2015. Këshillat ende nuk kanë kapacitet për të hartuar rregullore dhe për të marrë vendime në përputhje me hierarkinë e akteve normative. Ata poashtu nuk kanë kapacitet për të monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre.

Mandati i gjyqtarëve aktual ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese mbetet i pandryshuar në kuadër të mandatit të EULEX-it.

## Pavarësia dhe paanshmëria

Masat ligjore **mbrojtëse** mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të përfshira në kushtetutën, ligjin mbi gjykatat dhe legjislacionin që rregullon Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial. Ekzistojnë shqetësime të mëdha në lidhje me komentet e zyrtarëve të nivelit të lartë në lidhje me procedurat e vazhdueshme gjyqësore të cilat janë të barazvlefshme me ndërhyrjen në gjyqësorin. Ka shumë vepra në lidhje me korrupsionin që përfshijnë anëtarët e shërbimit gjyqësor dhe prokurorisë.

Kryetarët e gjykatave janë përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e gjykatave të tyre. Sipas ndryshimeve të ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës në mars 2016 **gjyqtarët mund të transferohen** në gjykatat e tjera nga KGJK me aprovimin e kryetarit të gjykatës, për një periudhë të arsyeshme, në mënyrë që të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave edhe në rrethana të tjera të jashtëzakonshme. Ata

mund të kërkojnë transfer para Gjykatës Supreme. Kjo mundëson përforcimin e departamenteve të krimeve të rënda të cilat nuk kanë staf të mjaftueshëm. Gjyqtarët e transferuar marrin rritje të pagës. Duhet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme duke caktuar numrin e duhur të gjyqtarëve në çdo gjykatë.

**Caktimi i lëndëve** menaxhohet me short. Rastet urgjente caktohen nga kryetarët e gjykatave. Rastet e ndjeshme janë të ndara mirëpo jo gjithmonë trajtohen.

KGJK dhe KPK janë përgjegjës për ndërmarrjen e aksioneve nëse gjyqtarët ose prokurorët janë të kërcënuar. Ata duhet të vazhdojnë të rrisin ndërgjegjësimin rreth mekanizmave dhe procedurave ekzistuese të mbrojtjes, në bashkëpunim të ngushtë me policinë.

### Përgjegjësia

Zbatimi i **kodeve të etikës** për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i dobët. **Procedurat disiplinore** janë në rregull. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial janë përgjegjës për këto procedura, përderisa Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) kryen procedurat paraprake disiplinore dhe dorëzon propozimet e duhura tek Këshillat. Aspekte të caktuara procedurale të statusit dhe funksionimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor duhet të sqarohen. Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga Kryetari me propozim të KGJK/KPK për një numër të veprave penale dhe disiplinore dhe kanë të drejtë ankese.

Ligji mbi Zyrën e Prokurorit Disiplinor, i cili zëvendëson dispozitat e përfshira në ligjet mbi Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial, mbetet për tu miratuar. Performanca e ZDP-së duhet të përmirësohet. Nga shtatori i vitit 2015 deri në prill të vitit 2016, kjo zyrë ka arritur të shqyrtojë dhe paraqesë vetëm pesë raste kundër gjyqtarëve dhe dhjetë raste kundër prokurorëve tek Komisionet përkatëse të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial. Deri më tani, nga të gjitha këto raste asnjë nga gjyqtarët dhe prokurorët apo zyrtarët e tyre gjyqësor nuk është shkarkuar. Asnjë gjyqtarë dhe 2 nga 4 prokurorë janë suspenduar nga Këshillat për shkak të akuzave për mitëmarrje. Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve nën hetim nga ZDP-ja në vitin 2015 ishte i lartë, më tepër se 250. Këshilli Prokurorial ka ndërprerë shtatë raste ndërsa Këshilli Gjyqësor ka ndërprerë gjashtë raste bazuar në skadimin e kufizimeve të përcaktuara me ligj. Gjyqtarët dhe prokurorët janë të obliguar me ligj të **deklarojnë pasurinë** dhe dhuratat e marra, si dhe të raportojnë çdo konflikt të mundshëm të interesave tek Agjencia Kundër Korrupsionit. Në vitin 2015, të gjithë gjyqtarët e Kosovës dhe prokurorët dorëzuan në kohë deklaratimet e pasurisë.

### Profesionalizmi dhe kompetenca

Presidenti i Kosovës **emëron** gjyqtarët dhe prokurorët për një mandat fillestar tre vjeçar pas një propozimi ng KGJK apo KPK respektivisht. Procesi i rekrutimit dhe provimet e hyrjes për gjyqtarët dhe prokurorët organizohen nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial respektivisht dhe bazohen në merita. Autoriteti i cili merr vendim për **përzgjedhjen e gjyqtarëve** duhet të jetë i pavarur nga fuqitë ekzekutive dhe legjislative.

Këshillit Prokurorial i kërkohet të kryej **vlerësime të performancës** së prokurorëve të cilët kanë mandat të përhershëm çdo të tretin vit mirëpo kjo prapë ka hasur në vonesa të konsiderueshme. Këshilli Gjyqësor nuk arriti ta miratojë rregulloren mbi vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Ata vazhdojnë të vlerësohen nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve. Deri më sot shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve e kanë kaluar vlerësimin ndërsa vetëm njëri nga gjyqtarët nuk është propozuar për emërim të përhershëm. Kriteret për performancë të bazuar në merita dhe një sistem vlerësimi brenda afatit fillestar të emërimit, duke përfshirë në fund të trajnimit fillestar, ekzistojnë që nga viti 2015 për të siguruar profesionalizëm. Niveli i **profesionalizmit dhe kompetencës**, posaçërisht i

prokurorëve, mbetet një çështje shqetësuese. Disa nga ta nuk janë të trajnuar në mënyrë të duhur dhe disa nuk janë të gatshëm të përdorin trajnimin e fituar dhe të marrin përgjegjësi të plotë për rastet e tyre. Nevojat për trajnim duhet të vlerësohen si pjesë e një vlerësimi vjetor të thellë të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### Cilësia e drejtësisë

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) është përgjegjës për ofrimin e **trajnit** fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në kurrikulën vjetore të trajnimit të përgatitur bashkërisht nga KGJK, KPK dhe IGJK pas vlerësimeve gjithëpërfshirëse të nevojave. Trajnimet financohen nga buxheti i Institutit Gjyqësor dhe nga donatorët ndërkombëtarë. Pakoja e re e ligjeve për drejtësi ofron trajnim fillestar të obliguar për një periudhë prej 12 muajsh për gjyqtarët dhe prokurorët pasi ata të jenë emëruar. Të dy Këshillat ende nuk kanë kryer trajnime të tilla.

Kurrikulat, të cila janë të ndara në module të trajnimit në bazë të përgjegjësive të departamenteve të gjykatave dhe zyreve të prokurorëve, përcaktojnë fushat të cilat duhet të mbulohen nga trajnimi, duke përfshirë trajnimin mbi ligjin e BE-së. Nëse është relevante, IGJK përfshin stafin e ministrive të tjera dhe agjencive në kurse të veçanta trajnimi (p.sh. Ministrinë e Brendshme dhe Doganën në çështjet që kanë me shpërlarjen e parave). IGJK ka përgatitur poashtu një program trajnimi orientues për gjyqtarët dhe prokurorët nga komuniteti serb. Për të forcuar më tej kapacitetin e gjyqtarëve si dhe të prokurorëve dhe stafit mbështetës, trajnimi është i nevojshëm sidomos në fushat e specializuara siç janë krimet ekonomike dhe prokurimi publik.

Kosova për momentin ka 19.5 gjyqtarë për 100 000 banorë. Në total janë 350 gjyqtarë vendor dhe 39 gjyqtarë të EULEX-it.

**Buxheti** për shërbimin prokurorial të Kosovës dhe sistemin e gjykatave për vitin 2016 është rreth 30 milion euro, duke përfshirë shërbimet e tjera siç është ndërmjetësimi dhe ndihma ligjore. Krahasuar me vitin 2015, buxheti i përgjithshëm i ndarë për sistemin e drejtësisë është rritur në 2.38% të buxhetit të përgjithshëm kombëtar. Një pasqyrë e plotë e financave publike të ndara për sistemin gjyqësor është vënë në dispozicion për publikun në dhjetor.

Regjistri i centralizuar i dosjeve penale, i cili është vendimtar për cilësinë e drejtësisë, nuk është në rregull. Nuk ka sistem zyrtar të monitorimit të gjykatave. **Mjetet elektronike të drejtësisë** mbeten të pazhvilluara. Megjithatë, Instituti Gjyqësor ka krijuar një bazë të dhënash online të legjislacionit me komente ligjore dhe të jurisprudencës për të ndihmuar gjyqtarët dhe prokurorët në punën e tyre të përditshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për publikimin e vendimeve të Gjykatës Supreme. Baza e të dhënave ka nevojë për përditësim dhe promovim të vazhdueshëm në mes të praktikuesve ligjorë.

Një sistem **ndërmjetësimi** ka qenë funksional që nga viti 2008, me shtatë qendra rajonale të ndërmjetësimit dhe 163 ndërmjetësues aktivë të licensuar nga Ministria e Drejtësisë. Në prill të vitit 2016, 21 kandidatë për pozitën e ndërmjetësuesit (17 nga komuniteti i serbëve të Kosovës) kaluan trajnimin e nevojshëm dhe janë në pritje të certifikimit. Ndërgjegjësimi i publikut dhe familjarizimi me mjetet alternative për zgjidhjen e konflikteve mbetet i ulët por numri i rasteve është i lartë. Që nga viti 2012 deri në korrik 2015, 2 598 raste janë trajtuar me anë të ndërmjetësimit. Përderisa noterët merren me më shumë raste, aftësitë e tyre profesionale duhet të përmirësohen. Ndërmjetësimi dhe sistemi i noterisë kanë nevojë për forcim të mëtejshëm.

## Efikasiteti

Kosova duhet të përmirësojë efikasitetin e saj në trajtimin e **lëndëve të grumbulluara**. Sipas departamentit të statistikave të Këshillit Gjyqësor, në fillim të vitit 2016 numri i rasteve të pazgjidhura në nivel të gjykata ishte 440 627, numri i rasteve të pranuar ishte 400 982 dhe i atyre të zgjidhurave ishte 397 059. Shkalla e zgjidhjeve të rasteve është duke u rritur dhe gjykatat e Kosovës tani kanë një shkallë të zgjidhjes prej 99.02% të rasteve të pranuar dhe të zgjidhura brenda një viti.

Nuk ka të dhëna mbi **kohën e marrjes së vendimit** (d.m.th koha mesatare nga paraqitja e aktakuzës deri tek vendimi) në gjykatat e Kosovës.

Koha e përcaktuar me ligj për të hetuar rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit është shumë e shkurtër, duke rezultuar në informata të pamjaftueshme për gjykatat për të nxjerrë një vendim të informuar. Nuk ekziston një sistem funksional i menaxhimit elektronik të rasteve. Një përjashtim pozitiv është mekanizmi përcjellës për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar të krijuar së fundmi (*shih luftën kundër korrupsionit*).

Efikasiteti i gjyqësorit pengohet shumë nga mangësitë e legjislacionit penal. Shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale janë shumë të pavolitshme dhe formale për të lejuar hetimin dhe ndjekjen penale të fuqishme dhe të suksesshme. Për shkak të kapaciteteve dhe stafit të pamjaftueshëm dhe burimeve të kufizuara financiare, si dhe numrit të madh të rasteve të grumbulluara, sistemi gjyqësor është i ngadalshëm në prurjen e drejtësisë. Madhësia e Kosovës dhe struktura shoqërore e bëjnë efikasitetin e gjyqësorit të cenueshëm nga ndikimi.

## **Lufta kundër korrupsionit**

Kosova gjendet në **fazë fillestare/në nivel të përgaditjeve** në luftën kundër korrupsionit. Progres është arritur gjatë vitit të kaluar. Me themelimin e ekipeve multi-disiplinare hetimore, krijimin e mekanizmit të gjurmimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar, Kosova ka përmbushur dy rekomandimet e vitit të kaluar. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë të cilat janë hetuar dhe ndjekur penalisht. Megjithatë, Kosova duhet të vazhdojë forcimin e gjurmimit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Vullneti politik për të trajtuar këtë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike duhet të përmirësohet. Efikasiteti i hetimeve vazhdon të pengohet nga ndikimi politik. Gjatë vitit të ardhshëm, Kosova duhet në veçanti:

→ të ndryshojë kuadrin ligjor mbi konfliktin e interesave duke e çuar atë në përputhje me standardet evropiane, përfshirë përkufizimet e qarta të kategorive të zyrtarëve dhe rregullimin e pajtueshmërisë së funksioneve gjatë dhe pas zyrës ;

→ të rishikojë dhe miratojë legjislacionin në lidhje me zyrtarët e akuzuar për krime serioze apo të lidhura me korrupsionin ;

→ të kryej auditime të pavarura të financave të partive politike për vitin 2013-2016 dhe të sigurojë që raportet financiare të jenë të publikuara siç parashihet me ligj;

→ të rris numrin e prokurorëve në Zyrën e Prokurorisë Speciale të cilët hetojnë dhe ndjekin penalisht rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe të ofrojë trajnim për forcimin e kapaciteteve të tyre për kryerjen e hetimeve financiare, konfiskimin e pasurive dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, me qëllim të arritjes së rezultateve në të dhënat e gjurmimit.



## Të dhënat e gjurmimit

Në dhjetor të vitit 2015, Kosova themeloi një mekanizëm të TI të gjurmimit të avancuar për të gjitha fazat e procedurës penale për **rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe të krimit të organizuar të profilit të lartë**, përfshirë rastet e konfiskimit të pasurisë. Është themeluar ekipi multi-disiplinar për të koordinuar në mënyrë efektive përpjekjet për t'u marrë me këto raste. Nga 33 rastet e nivelit të lartë të cilat gjenden aktualisht në sistem, ka pasur 21 padi (17 për korrupsion dhe 4 për krim të organizuar) duke përfshirë 150 të pandehur (përfshirë një numër të zyrtarëve politik dhe publik). Ka pasur dënime në tri raste për vepra penale që lidhen me korrupsionin, duke përfshirë një rast ndaj një prokurori. **Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)** ka vazhduar të jetë aktive në kryerjen e hetimeve administrative, kontrollimin e deklarimeve të pasurisë, monitorimin e konflikteve të interesit dhe aktiviteteve të prokurimit publik dhe rritjen e vetëdijes. Që nga themelimi, Agjencia ka dërguar 677 raste në prokurori. Zyrat e prokurorisë kanë ngritur aktakuza për 87 raste, bazuar në referime të AKK. Cilësia e raporteve që AKK i dorëzon në prokurori duhet të përmirësohet, ashtu si edhe kapaciteti dhe vullneti i prokurorëve për të ndjekur rastet. AKK nuk ka mjete për të kontrolluar deklaratimet e pasurisë. Këto kontrole kërkojnë bashkëpunim më të ngushtë me policinë, administratën tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare, regjistrin e tokës dhe autoritetet komunale.

Ndikimi i tepruar dhe kapaciteti i kufizuar ende pengojnë kryerjen efektive të **hetimeve financiare**. Hetimet financiare nuk kanë nisur ende në mënyrë sistematike ndaj rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ka shumë pak prokurorë të specializuar, veçanërisht në Prokurorinë Speciale, në nivelin e duhur të trajnimit dhe kompetencave për tu marrë me rastet financiare, duke përfshirë rastet e prokurimit. **Ngrirja dhe konfiskimi i pasurisë** është rritur por konfiskimet finale mbeten të ulëta. Në vitin 2015, vlera totale e pasurisë të ngrirë, sequestruara dhe të konfiskuara ishte 20.6 milion euro. Vlera e konfiskimeve të përhershme është rritur nga 130 000 euro sa ishte në vitin 2014 në 450 000 euro në vitin 2015. Nga janari deri në qershor të vitit 2016 vlera e përgjithshme e pasurisë së sequestruar përkohësisht ishte 1 milion euro, përderisa vlera e përgjithshme e konfiskimeve të përhershme ishte 236 000 euro (në total 1.2 milion euro). Ka edhe kërkesa në pritje për konfiskim të formës së prerë në vlerë prej 25 744 eurosh.

Kosova nuk ka një mekanizëm për suspendimin apo shkarkimin automatik të zyrtarëve të cilët janë të akuzuar dhe të dënuar për korrupsion, me përjashtim të ligjit të sapo ndryshuar mbi prokurimin publik dhe ligjin mbi shërbimin civil.

Mungesa e besimit pengon zbatimin efektiv të **mekanizmave për mbrojtjen e dëshmitarëve**, ku përveç kësaj bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar ka nevojë të përmirësohet. Ligji aktual mbi informatorët nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare pasi që ai nuk i plotëson mekanizmat minimale të **zbulimit të informacioneve** apo kërkesave për mbrojtje.

Auditimet e pavarura të financave të partive politike, nuk janë kryer që nga viti 2013. Në vitin 2016, kuvendi dështoi përsëri në kryerjen e **auditimit të financimit të partive politike** dhe shumica e partive politike nuk i publikojnë raportet e tyre financiare siç kërkohet me ligj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve poashtu nuk ka siguruar publikimin në kohë të raporteve mbi financat e partive politike. Transparenca dhe llogaridhënia e financimit të partive politike dhe financimit të fushatës mbetet për t'u siguruar.

Kosova duhet të marrë në konsideratë masat të cilat lejojnë hetim efektiv të **pasurisë së pashjegueshme**, d.m.th duke lejuar barrën e provës të kthehet në konfiskim të pasurisë, duke bërë ndarjen e veprës së shpërlarjes së parave nga vepra penale, duke ndaluar transferimin e aseteve kriminale tek personi i tretë dhe duke i dhënë Agjencisë Kundër Korrupsionit më shumë fuqi efektive të inspektimit për auditimin e deklarimeve të pasurisë.

Zyrtarët nga veriu i Kosovës nuk i përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me dorëzimin e deklarimeve të

pasurisë në AKK. **Korrupsioni në veri të Kosovës** nuk është duke u trajtuar si duhet nga agjencitë e zbatimit të ligjit.

Në vitin 2015, nga 4 200 zyrtarëve të detyruar të paraqesin **deklarimet e aseteve** vjetore, 57 nuk arritën ta bëjnë këtë, e cila paraqet vetëm 1.4%. 26 raste kundër 184 personave janë dërguar për ndjekje penale nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Më shqetësuese janë jo-raportimi ose raportimi i rremë i pasurive, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar ose mitëmarrja. Në vitin 2015, Agjencia trajtoi 306 raste të konfliktit të interesit, nga të cilat 4 janë dorëzuar për procedurë të kundërvajtjes dhe 3 u dërguan tek shërbimet e prokurorisë për hetim penal. Në 160 raste, konflikti i interesit u parandalua dhe në 49 raste Agjencia ka dhënë një opinion për institucionet përgjegjëse. Shumica e rasteve kishin të bëjnë me zyrtarët e pushtetit lokal. Agjencia Kundër Korrupsionit ka gjetur 1 552 zyrtarë që mbajnë dy ose më shumë poste, duke krijuar kështu situatën e një konflikt të mundshëm interesi. Në vitin 2015, Agjencia trajtoi 112 raste mbi parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe lëshoi 81 opinione, nga të cilat vetëm 7 nuk janë marrë parasysh.

### Kuadri institucional

Anti-korrupsioni në Kosovë është i fragmentuar ndërsa organet kryesore kundër korrupsionit nuk janë të integruara mirë, kompetencat e tyre janë të shkelura dhe ndarja e detyrave është e paqartë. Kosova ka nevojë të forcojë koordinimin ndër-institucional të mekanizmave dhe organeve.

Në **anën parandaluese**, organi kryesor mbetet Agjencia e pavarur dhe e specializuar Kundër Korrupsionit. Organet e tjera që kanë kompetenca të kontrollimit dhe auditimit janë: Auditori i Përgjithshëm, i cili kryen auditimet financiare të të gjitha institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal, organet tatimore, të cilat mbledhin dhe kontrollojnë informatat financiare nga individë dhe organe të ndryshme të përbashkëta dhe autoritetet doganore, të cilat kontrollojnë procedurat e doganës. Njësia e Inteligjencës Financiare në Ministrinë e Financave mbledh dhe analizon informacionet mbitransaksionet financiare të dyshimta të kryera me qëllim të shpërlarjes së parave apo financimit të terrorizmit. Të gjitha këto organe duket se nuk kanë një rol proaktiv në luftën kundër korrupsionit. Qasja në informacione me karakter publik është e garantuar me ligjin për qasje në dokumente publike, miratuar në vitin 2010. Vlerësimet e rrezikut të korrupsionit në shëndetësi, arsim, gjyqësi, energji dhe sektorët e minierave u publikuan në vitin 2015. Këto zona mbeten veçanërisht të prirura ndaj korrupsionit dhe kryerja e vlerësimeve të rrezikut në një mënyrë më sistematike është hapi i parë pozitiv që duhet të çojë në masa të mëtejshme për të adresuar në mënyrë efektive korrupsionin. Nuk ka një politikë të veçantë publike për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat. Në raste të dyshuara për korrupsion, qytetarët raportojnë në polici pasi që shumica e perceptojnë këtë institucion si reagues të parë.

Në lidhje me **zbatimin e ligjit**, ka organe të specializuara në luftën kundër korrupsionit: koordinatori për anti-korrupsion i emëruar nga Kryeprokurori i shtetit, si dhe Drejtoria e Policisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, e cila ka njësi të anti-korrupsionit në stacionet policore dhe në selinë e policisë. Këto njësi kryejnë hetime paraprake dhe bashkëpunojnë në baza ditore me prokurorët. Çdo zyrë themelore e prokurorisë ka një prokuror të anti-korrupsionit dhe dy prokurorë emërohen nga Prokurori Special për t'u marrë me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Duke pasur parasysh rritjen e vazhdueshme të ngarkesës më punë dhe zvogëlimin të EULEX-it, numri i prokurorëve në Prokurorinë Speciale që mirren çështjet e korrupsionit duhet të rritet. Rastet e korrupsionit të nivelit të lartë trajtohen nga departamentet e krimeve të rënda të Gjykatave Themelore të Kosovës, të cilat kohët e fundit kanë caktuar më shumë gjyqtarë dhe staf mbështetës.

Emërimi i një Koordinatori Kombëtar për luftimin e Krimit Ekonomik në nëntor të vitit 2015 ka ndihmuar përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive për zbatimin të ligjit.

## Kuadri ligjor

Dispozitat e ligjit penal mbi korrupsionin, kryesisht në kodin penal dhe kodin e procedurës penale, janë përgjithësisht në përputhje me standardet përkatëse evropiane. Megjithatë, ka fusha që kërkojnë korrigjim urgjent siç janë dispozitat e konfiskimit, të cilat janë shumë të pavolitshme dhe komplekse për t'u përdorur, si dhe afatet e paarsyeshme të shkurtra për hetime. Kuadri ligjor është në përputhje më tej me *acquis*, me ndryshimet e ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Rregullimi i **financave të partive dhe fushatave politike** pengohet nga mungesa e mbikëqyrjes efektive rregullatore dhe mungesa e vullnetit politik për të zbatuar kuadrin ligjor. Rishikimi i legjislacionit mund të ndihmojë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe auditimit efektiv të **partive politike dhe kontrollit të financave të fushatave**.

**Ligji mbi konfliktin e interesit** duhet të ndryshohet për ta sjellë atë në përputhje me standardet evropiane. Kategoritë e zyrtarëve publikë të mbuluara me ligj për momentin nuk janë të përcaktuara qartë sikurse masat dhe procedurat për parandalimin dhe sanksionimin e situatave të konfliktit të interesit.

Pajtueshmëritë dhe papajtueshmëritë e funksioneve gjatë dhe pas zyrës nuk janë të rregulluara. Suspendimi dhe largimi i zyrtarëve publikë të akuzuar apo të dënuar për krime të rënda apo të lidhura me korrupsionin nuk është i paraparë.

Ligji mbi **prokurimin publik** u ndryshua në mars të vitit 2016, duke u përafuar më tej me *acquis* të BE-së (shih 5.1.6 - *prokurimi publik*).

## Kuadri strategjik

Kosova është duke zbatuar strategjinë e anti-korrupsionit dhe planin e veprimit për vitin 2013-2017, të monitoruar nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Shumica e rezultateve të pritura nuk janë arritur. Një plan i rishikuar i veprimit kundër korrupsionit për shërbimin e prokurorisë dhe rolin e saj në luftën kundër korrupsionit u miratua në dhjetor të vitit 2015. Financimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e treguesve të matjes së ndikimit janë duke e dëmtuar perspektivën e arritjes së rezultateve të pritura.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për vitin 2014-2018 për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare ka filluar pa probleme. Planet e veprimit janë të gatshme për të luftuar korrupsionin në sektorë të rrezikuar siç janë doganat, policia dhe administrata tatimore. Shoqëria civile është duke u përfshirë në hartimin e politikave të anti-korrupsionit. Konsultime të rregullta dhe transparente duhet të mbahen për të monitoruar zbatimin.

## Lufta kundër krimit të organizuar

Kosova është në **fazë të hershme** të luftimit të krimit të organizuar. **Progres i mirë** është bërë në vitin e kaluar, sidomos me forcimin institucional dhe të mekanizmit për gjurmimin e rastet (krh. njejtë si në kutinë e luftës kundër korrupsionit) dhe për shkak të përmirësimit të koordinimit. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të rasteve të nivelit të lartë të hetuara dhe të ndjekura penalisht. Numri i dënimeve të formës së prerë, hetimeve financiare dhe konfiskimeve përfundimtare të aseteve mbetet i ulët, ndërsa ngrirja e aseteve dhe konfiskimet janë rritur. Krimi i organizuar vazhdon të mbetet i ndëshkuar në veri të Kosovës. Në përgjithësi, ka pasur pak progres në përmbushjen e rekomandimeve të identifikuar të vitit të kaluar. Kosova ka rritur përpjekjet për të luftuar terrorizmin, duke përfshirë masat për të trajtuar radikalizimin dhe ndalimin e shkuarjes së luftëtarëve terroristë nga Kosova në luftërat e jashtme. Gjatë vitit të ardhshëm, Kosova duhet veçanërisht:

→ të rishikojë Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, me synimin për t'i bërë ato mjete efektive për luftimin e krimit të organizuar;

→ të rrisë numrin e prokurorëve të Prokurorisë Speciale të cilët hetojnë dhe ndjekin penalisht rastet e krimit të organizuar të profilit të lartë dhe të ju sigurojë atyre trajnime të fuqishme për forcimin e kapaciteteve të tyre për të kryer hetime financiare, konfiskime të pasurisë dhe për të mbrojtur në mënyrë efektive dëshmitarët, me qëllim të arritjes së rezultateve në të dhënat e gjurmimit

→ including through better inter-agency cooperation. të zhvillojë një qasje të policimit të udhëhequr nga policimi dhe të forcojë kapacitetet për mbledhjen, harmonizimin, analizimin dhe përdorimin e statistikave relevante kriminale, duke përfshirë bashkëpunimin më të mire në mes të agjencive.

### Të dhënat e gjurmimit

Krimi i organizuar në Kosovë është kryesisht trafikimi i qenieve njerëzore dhe drogës, krimi financiar dhe shpërlarja e parave, si dhe aktivitete të lidhura me terrorizmin. Faktorët kryesorë që lehtësojnë krimin e organizuar janë kryesisht pozita gjeografike e Kosovës në "rugën ballkanike", papunësia e lartë dhe faktorë të tjerë ekonomikë, si dhe strukturat e veçanta sociale dhe familjare. Mekanizmi i TI për gjurmimin e **rasteve të profilit të lartë**, duke përfshirë krimin e organizuar është në funksion (*shih lufta kundër korrupsionit*). Megjithatë, një mekanizëm gjurmues për të gjitha çështjet penale ende duhet të krijohet për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet të gjithë aktorëve të sundimit të ligjit në Kosovë.

Shkalla e suksesit për hetime, ndjekje penale dhe dënime të formës së prerë në raste të krimit të organizuar, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, trafikut të drogës, terrorizmit, shpërlarjes së parave dhe formave të tjera të krimit financiar mbetet shumë i ulët. Hetimet financiare nuk janë efektive. Përderisa në përgjithësi vlera e aseteve të ngrira dhe të konfiskuara përkohësisht është rritur, normat e konfiskimit dhe sekuestrimit final të pasurive kriminale mbeten të ulëta.

Uzurpimi në shkallë të gjerë i pronave shoqërore është endemik në Kosovë, i cili siguron burim të madh të pasurisë së paligjshme. Në prill 2016, u organizua një operacion i Policisë së Kosovës, ndihmuar nga EULEX-i, gjatë të cilit 47 objektet janë kontrolluar dhe 8 të dyshuar u arrestuan në lidhje me skemën e organizuar të uzurpimit ilegal, duke përfshirë edhe një anëtar të kuvendit.

**Sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve**, ndërkohë që ka kapacitet të duhur, nuk ka aktualisht ndonjë dëshmitar nën mbrojtje, për shkak të mungesës së besimit në sistem. Implementimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të forcohet.

Përfshirja e grupeve të armatosura në aktivitetet e organizuara kriminale, të tilla si kontrabanda e armëve dhe mosndëshkimi i dukshëm me të cilin ata janë në gjendje të veprojnë përtej kufijve është shqetësim serioz. Policia e Kosovës kanë qenë e përfshirë në disa **operacione ndërkufitare** mbështetur nga Europol me kërkesë të shteteve anëtare të cilat kryesojnë hetimet mbi këto grupe. Qeveria, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe sistemi gjyqësor duhet të ndërmarrin veprime të shpejta për të shpërbërë këto grupe.

Që nga shtatori i vitit 2015, nuk ka patur raste të reja të raportuara të kosovarëve të cilët i janë bashkuar luftës në Siri. Gjatë vitit të kaluar, policia ka arrestuar një numër të madh të personave të cilët u janë bashkuar grupeve terroriste në konflikte jashtë vendit apo synonin ta bënin këtë.

### Kuadri institucional

Institucionet kryesore të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar në Kosovë janë koordinatori kombëtar, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave (dogana, Njësia e Inteligjencës Financiare, administrata tatimore), Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, shërbimi prokurorial dhe gjykatat. **Koordinatori Kombëtar kundër Krimit të Organizuar** monitoron zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër krimit të organizuar.

Drejtoria kundër krimit të organizuar në selinë e **policisë** përbëhet nga njësitë e specializuara për të luftuar drogën dhe trafikimin e qenieve njerëzore në nivel rajonal, të ndihmuar nga njësitë e mjekësisë ligjore. Në **shërbimin prokurorial**, roli kryesor në luftën kundër krimit të organizuar i takon Prokurorisë Speciale, e cila si staf ka prokurorë të specializuar në hetimin dhe ndjekjen e këtij lloji të kriminalitetit. Ajo ka nevojë për të trajnime dhe përf forcime të stafit.

**Dogana, Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF-K) dhe administrata tatimore** janë përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e lëvizjes së brendshme dhe ndërkufitare të mallrave, materialeve dhe kapitalit me qëllim të luftimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me të gjitha format e krimit të organizuar. NJIF-K në mënyrë specifike ndihmon me analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve mbi shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, duke shkëmbyer informacione me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit. Ajo gjithashtu ka kompetenca për të ngrirë transaksionet e dyshimta financiare.

**Bashkëpunimi dhe koordinimi** mes të gjitha këtyre institucioneve në trajtimin e përditshëm të korrupsionit dhe rasteve e krimit të organizuar varet më shumë nga kapaciteti individual dhe angazhimi i zyrtarëve përgjegjës sesa nga sistemi si i tillë, ku shërbimi prokurorial mbetet hallka më e dobët.

**Policimi i udhëhequr nga Inteligjenca** është shumë pak i zbatuar. Mjeti i ri analitik që ndihmon në ekspozimin dhe hetimin e krimit të organizuar, Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës, nuk është shfrytëzuar ende plotësisht. Kosova rregullisht shkëmben informacion me Europol dhe Interpol përmes EULEX-it apo UNMIK-ut. Kosova ka aplikuar për t'u bashkuar me Interpol në prill të vitit 2016.

Agjencia e Kosovës për Forenzike dhe laboratorët e saj kanë pajisje teknike të mjaftueshme për kryerjen e analizave përkatëse të mjekësisë ligjore. Stafi i Agjencisë ka nevojë për trajnim rreth shërbimit dhe për ndihmë nga EULEX-i. Aftësia e saj për të ofruar patologjinë e duhur mjeko-ligjore mbetet shumë e dobët. Duhet të sigurohet financimi i vazhdueshëm i Agjencisë.

## Kuadri ligjor

Dispozitat e kodit penal dhe procedurës penale për luftimin e krimit të organizuar janë kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, disa kanë nevojë të rishikohen, siç janë dispozitat mbi konfiskimin dhe afatet e hetimit, dispozitat përgjegjëse për mosbalancim në mes të mbrojtjes dhe prokurorisë gjatë gjyqimit, dispozita për një numër të mundësive të apelit, dispozitat e paqarta mbi pranueshmërinë e provave dhe dispozitat e kërkimit dhe konfiskimit. Ligji i sapo ndryshuar mbi shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit nuk është plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Të metat kryesore janë sistemi i paqartë i NJIF-it dhe mbikëqyrja e sektorit financiar nga banka qendrore, kërkesat e gjera të raportimit për OJQ-të, mungesa e dispozitave që lejojnë prokurorin ose gjykatën që të vazhdojë ngrirjen e një transaksioni të dyshimtë në përputhje me urdhërat e NJIF dhe fusha e ngushtë e përcaktimeve në krahasim me ato që kërkohen nga rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar.

## Kuadri strategjik

Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për vitin 2012-2017 kundër krimit të organizuar është njëri ndër dokumentet kryesore strategjike. Ekzistojnë strategji dhe plane të veprimit shtesë rreth parandalimit dhe luftimit të ekonomisë joformale, shpërlarjes së parave, terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit, financimit të terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, sigurisë kibernetike dhe trafikimit të narkotikëve.

## Lufta kundër terrorizmit

Autoritetet e Kosovës kanë rritur **përpyjekjet për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit**, duke zbatuar ligjin për luftëtarët e huaj terroristë, si dhe strategjinë dhe planin e veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Numri i qytetarëve të Kosovës të angazhuar në konfliktin e Sirisë/Irakut është në rënie. Megjithatë, sfidat mbesin për shkak të mungesës së programeve për deradikalizimin dhe riintegrimin, duke pasur parasysh numrin e lartë të qytetarëve të Kosovës të kthyer nga zonat e konfliktit. Fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë ka nevojë për një qasje të përkushtuar nga komuniteti i inteligjencës dhe ai i zbatimit të ligjit dhe për një politikë koherente gjyqësore për shkelësit së bashku me një reagim të komunitetit social që synon në mënyrë të veçantë të rinjtë e marginalizuar. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve të Inteligjencës, veçanërisht midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, mund të ndihmojë gjithashtu për të luftuar kërcënimin e ekstremizmit dhe radikalizimit.

Trajnimi i specializuar i prokurorëve dhe policisë mbi teknikat e hetimit është i nevojshëm. Agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë poashtu nuk kanë ekspertizë dhe pajisje për të hetuar raste të ndërlikuara të terrorizmit.

## **2.4. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteve**

Kuadri ligjor në përgjithësi garanton mbrojtjen e të drejtave themelore dhe të njeriut në përputhje me standardet evropiane. **Disa përparime** janë bërë në këtë fushë, për shembull në mbrojtjen e të dhënave dhe në mbështetjen politike të nivelit të lartë për të drejtat e personave të komunitetit LGBT. Megjithatë, përparimi i kufizuar në garantimin efektiv të të drejtave të pronësisë dhe kthimin dhe ri-integrimin e personave të zhvendosur mbetet një shqetësim, ashtu si edhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore. Zbatimi i të drejtave të njeriut vazhdon të pengohet nga mungesa e burimeve dhe angazhimit politik, duke përfshirë edhe nivelin lokal. Disa hapa janë ndërmarrë për të zbatuar pakon e ligjeve të të drejtave të njeriut të miratuar vitin e kaluar, por sfida të rëndësishme mbesin ende. Mangësitë veçanërisht ndikojnë në fushat e mëposhtme:

- Dhuna me bazë gjinore dhe qasja e kufizuar e grave në pronësi pengojnë në mënyrë të konsiderueshme gëzimin e plotë të të drejtave të grave. Në mënyrë të ngjashme, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara vazhdojnë të pengohen nga mbështetja dhe shërbimet shëndetësore të pamjaftueshme, dhe qasja e dobët në shërbimet ekzistuese.
- Strategjitë dhe legjislacioni për të drejtat e personave që u përjashtojnë minoritetet dhe mbrojtjes e tyre në tërë Kosovën nuk zbatohen sa duhet.
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe autoriteteve të Kosovës, mbetet një sfidë. Legjislacioni për trajtimin e ndërtimeve pa leje duhet të zbatohet plotësisht.

**Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut** përbëjnë një pjesë integrale të kornizës ligjore të Kosovës dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme, siç parashikohet në kushtetutë. Kosova ka vazhduar të harmonizojë legjislacionin me këto instrumente dhe ka ruajtur praktikën e saj të raportimit ad hoc.

Në lidhje me **promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut**, përparim duhet të bëhet për zbatimin efektiv të legjislacionit të të drejtave të njeriut. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme veçanërisht në krijimin e të dhënave të gjurmuesit për t'i dërguar rastet e diskriminimit në gjykatë. Zyrës për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, i mungojnë burimet njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme për të menaxhuar ngarkesën e punës në mënyrë efektive. Ajo duhet të fokusohet në koordinimin dhe monitorimin e angazhimeve të politikave, ndërsa ministritë përgjegjëse duhet të marrin përgjegjësinë për implementimin e tyre. Krijimi i Grupit Koordinues Ndërminstros për të Drejtat e Njeriut në maj 2016 është hapi i parë në krijimin e koordinimit të nivelit të lartë për të hartuar një strategji gjithëpërfshirëse të drejtave të njeriut dhe të drejtave të zbatimit të tyre në mënyrë efektive. Avokati i Popullit duhet të luajë një rol të rëndësishëm në hartimin, monitorimin dhe këshillimin mbi këtë çështje. Grupi duhet të tregojë lidhshmëri të fortë politik gjatë mandatit të tij. Angazhimi i shtuar financiar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet është i nevojshme, ndërkohë që varësia nga donatorët duhet të reduktohet.

Për sa i përket **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit**, nuk pati raportime për shkelje të standardeve të njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në janar të vitit 2016, në përputhje me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës u krijua mekanizmi parandalues nacional kundër torturës. Ky është një organ i veçantë në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është përgjegjës për inspektimin e të gjitha vendeve në të cilat personat janë të privuar nga liria e tyre e plotë.

Në **sistemin e burgjeve**, respektimi i Rregullave Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të burgosurve dhe Rregullave Evropiane të Burgjeve ka vazhduar. Ekziston një nevojë urgjente për t'u mundësuar të burgosurve aktivitete të rëndësishme dhe mundësi të punës. Çështja e strehimit të të burgosurve në pritje të gjyqimit dhe personave të dënuar për kundërvajtje, së bashku me dënuarit për një kohë më të gjatë mbetet një shqetësim. Ekziston nevoja për të krijuar strehim të veçantë në veri të Kosovës për të siguruar një zgjidhje afatgjatë. Asnjë progres nuk është bërë në lidhje me ngritjen e një kompleksi burgu në veri të Mitrovicës. Rekomandimet që rrjedhin nga inspektimet e objekteve të Shërbimit Korrektues të Kosovës nga ana e Inspektoratit të Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë nuk janë adresuar në mënyrë sistematike. Poashtu ekzistojnë shqetësime serioze mbi privilegjet e të dënuarve të profilit të lartë. Në gusht, të gjitha rastet e pezullimit të dënimit për arsye shëndetësore u anuluan, duke rezultuar në kthimin në burg të tetë të burgosurve, përfshirë edhe tre të profilit të lartë. Niveli i pamjaftueshëm i personelit, veçanërisht në objektet e ndërtuara së fundmi, mbetet një shqetësim.

Autoritetet do të duhet të adresojnë rekomandimet e ardhshme të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor apo Degradues apo Ndëshkimit.

Disa përparime janë bërë **në mbrojtjen e të dhënave**. Ndërgjegjësimi i publikut mbi të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale është përmirësuar, duke rezultuar në një rritje të numrit të ankesave të pranuar nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përveç kësaj, Agjencia ka kryer më shumë inspektime. Agjencia ka nevojë për t'u përgatitur për sfidat në zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave si rezultat i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ajo ka nevojë për më shumë burime financiare dhe kapacitete njerëzore të forcuara, duke përfshirë edhe riemërimin e mbikqyrësit të vet, për t'u marrë me rritjen e numrit të ankesave. Ndryshimet në ligjet mbi mbrojtjen e të dhënave dhe qasjen në informata janë të nevojshme dhe kuadri institucional nuk është sqaruar ende.

Dispozitat ligjore mbi **lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit** janë në rregull dhe ndërveprimi në mes të udhëheqësve fetarë të të gjitha besimeve vazhdon. Megjithatë, projektligji për lirinë e ushtrimit të fesë duhet të miratohet dhe të përfshijë rekomandimet e Komisionit të Venecias. Shkolla fetare ortodokse në Prizren vazhdon të funksionojë mirë. Ministria e Kulturës është duke u angazhuar me Kishën Ortodokse serbe mbi mënyrat për të mbështetur rindërtimin e vendndodhjes së saj e cila është lënë e papërfunduar nga Komisioni për Implementimin e Rindërtimit. Megjithatë, modalitetet duhet të sqarohen për të siguruar që Kisha Ortodokse serbe mund të ushtrojë diskrecion të plotë në menaxhimin e pronave të saj, duke ndjekur procedurat ligjore. Kosova duhet të demonstrojë se ajo respekton këtë të drejtë në praktikë. Në maj 2016, Gjykata Kushtetuese lëshoi një aktgjykim përfundimtar për rastin e mosmarrëveshjeve mbi tokat që përfshin manastirin Visoki në komunën e Deçanit duke konfirmuar pronësinë ligjore të tokës nga ana e manastirit. Përderisa vendimi ka sjellur mbylljen e këtij rasti të tejzgjatur, zbatimi i tij mbetet një sfidë dhe rezistenca lokale, përfshirë kundërshtimin e hapur të shprehur nga zyrtarët komunalë, ngre shqetësime. Nuk pati raportime për incidente të rënda të lidhura me mbrojtjen e objekteve historike dhe fetare nën përgjegjësinë e Policisë së Kosovës. Incidentet e vazhdueshme të vjedhjeve të vogla dhe vandalizmit në vendet e trashëgimisë fetare duhet të ndiqen në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe hetimet e shpejta mbi incidentin që përfshin vendosjen e lëndës shpërthyes në xhaminë e Drenasit dhe djegien e një mauzole në Pejë. Autoritetet komunale në Prishtinë duhet të tregojnë respekt të plotë për të drejtat e komuniteteve fetare të parashikuara me ligj dhe duhet të ndajnë tokën për një varrezë për anëtarët e komunitetit protestant.

### **Liria e të shprehurit**

Kosova është **në nivel të përgatitjes** në fushën e lirisë së shprehjes. **Nuk ka pasur progres** në këtë fushë. Kërcënimet dhe sulmet kundër gazetarëve janë rritur. Kuvendi ka treguar përkushtim të kufizuar në gjetjen e një zgjidhjeje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë atë të pambrojtur ndaj presioneve politike dhe ndikimit. Nuk ka pasur zhvillime legjislative për rregullimin e pronësisë së medias dhe transparencës. Zbatimi i legjislacionit mbetet sfidë, në veçanti në lidhje me ligjin për transmetuesin publik. Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë adresuar.

Gjatë vitit të ardhshëm, Kosova në vecanti duhet:

- të vazhdojë të sigurojë që rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe format e tjera të presionit të hetohen menjëherë dhe të gjykohen;
- të sigurojë një zgjidhje të qëndrueshme financiare për transmetuesin publik;
- të zbatojë masat për të siguruar informacione transparente mbi pronësinë e mediave.

### Frikësimi i gazetarëve

Gjatë periudhës së raportimit, 12 incidente janë raportuar në polici. Incidentet përfshinin sulmin fizik



ndaj një gazetari nga jugu i Mitrovicës, fshirjen e të dhënave të materialit gazetaresk nga policia pa vendim të gjyqtarit dhe përjashtimin e gazetarëve nga seancat gjyqësore, përfshirë rastet e profilit të lartë. Në gusht 2016, një bombë shpërtheu në afërsi të transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës (RTK) dhe një tjetër në shtëpinë e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së. Të dyja sulmet janë dënuar nga qeveria dhe të gjitha partitë politike.

Hetimet në këto raste janë të ngadalta dhe ka pasur shumë pak dënime përfundimtare. Një përgjigje më sistematike, duke përfshirë hetimin e shpejtë dhe gjykimin e duhur është e nevojshme për të forcuar mbrojtjen e gazetarëve.

### Mjedisi legjislativ

Liria e shprehjes dhe e mediave janë të garantuara me Kushtetutë, dhe legjislacioni mbi shpifjen dhe gjuhën e urrejtjes është në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Korniza ligjore dhe institucionale në këtë fushë mbetet e fragmentuar dhe jo efektive. E drejta e gazetarëve për kundërshtim të ndërgjegjshëm dhe e drejta e publikut për t'u përgjigjur dhe për përmirësim mbetet e parregulluar. Policia, prokurorët dhe gjyqtarët kanë nevojë për trajnim të duhur mbi standardet e vendosura nga Këshilli i Evropës dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për trajtimin e burimeve dhe materialeve gazetareske. E drejta e qasjes në informacione me karakter publik është penguar nga qasja e fragmentuar dhe e paqartë e autoriteteve.

### Zbatimi i legjislacionit/institucionet

Zbatimi efektiv i legjislacionit dhe standardeve etike mbetet një sfidë, ku ligji për transmetuesin publik paraqet sfidën më të madhe. Komisioni i Pavarur për Media nuk arriti të bëjë përgatitjet për kalimin digjital. Ai në mënyrë sistematike monitoron përmbajtjen e mediave audiovizive, por ka mbetur prapa në iniciimin e rasteve dhe zbatimin e gjobave për shkeljet ligjore. Si rezultat i shkurtimeve buxhetore, ai po përballet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të veta financiare, duke përfshirë edhe investimet kapitale.

Liria e shprehjes në internet nuk është monitoruar as nga Komisioni i Pavarur për Media dhe as nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. Edhe pse kjo krijon një mjedis të papenguar për median në internet, ajo gjithashtu dëmton jetën private të individëve, duke çuar në shumë raste të rritjes së gjuhës së urrejtjes, shpifjes dhe mashtrimit. Raste të tilla duhet të ndiqen plotësisht (*shih 5.2.6 - shoqëria e informacionit dhe media*).

### Transmetuesi publik

RTK është direkt i financuar nga shteti, gjë që dëmton pavarësinë e tij, dobëson qëndrueshmërinë afatgjate dhe e lë të rrezikuar ndaj ndikimit politik. Kuvendi duhet ende të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme të financimit për RTK-në, ku afati ligjor ka skaduar në prill të vitit 2015. Tendenca e Kuvendit për të bërë financimin nga shteti një zgjidhje të përhershme në kundërshtim me ligjin është një shqetësim. Poashtu duhet gjetur një zgjidhje për hapësirat e transmetuesit publik. Në maj, Agjencia e Privatizimit ka kërkuar nga RTK që të paguaj për shfrytëzimin e hapësirave publike ose përndryshe do të dëbohej. Kërkesa të tilla nuk janë bërë ndaj mediave të tjera që përdorin hapësirat publike në kushte të ngjashme.

Bordi i RTK-së është i plotë, por performanca e tij ka nevojë të përmirësohet, siç u theksua gjatë auditimit të performancës së vitit të kaluar të transmetuesit publik, të kryera nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm me kërkesën e parlamentit.

Emërimi i drejtorit të ri të kanalit të RTK-së në gjuhën serbe në maj të 2016 u anulua më vonë për shkak

se ai ka shkelur dispozitat përkatëse ligjore.

### Faktorët ekonomik

Mediat në përgjithësi nuk janë ekonomikisht të qëndrueshme. Informacionet mbi strukturat e pronësisë së medias, në veçanti për mediat online, mbeten të paqartë dhe shpesh janë fiktive, pasi që shumica e mediave nuk japin informacion mbi financat e tyre ose pronësinë reale. Mungesa e një industrie të fortë private të reklamimit i bën transmetuesit privatë të varur nga burimet e tjera të financimit dhe shumë pak nga ta janë në gjendje të veprojnë pa lidhje të forta me grupet e interesit politik dhe të biznesit.

### Organizatat profesionale/kushtet profesionale

Ekzistojnë disa shoqata dhe sindikata për gazetarët, të ndara në vija etnike. Ato në përgjithësi nuk gëzojnë mbështetje të gjerë në të gjithë spektrin gazetaresk. Gazetarët shpesh punojnë pa kontrata dhe ata janë të pambrojtur ndaj korrupsionit, si dhe të prirur për vetëcensurë. Mbrojtja e standardeve profesionale në gazetari është e rregulluar nga kodet e etikës, por zbatimi është i dobët. As Komisioni i Pavarur për Media dhe as Këshilli i Mediave të Shkruara nuk kanë ngritur asnjë rast kundër mediave për shkelje të kodeve të etikës.

**Liria e tubimit dhe e organizimit** është e garantuar me Kushtetutë dhe qytetarët janë duke i shfrytëzuar të drejtat e tyre në masë të mjaftueshme, duke përfshirë organizimin e demonstratave dhe protestave kundër niveleve të ndryshme të qeverisjes. Autoritetet e zbatimit të ligjit i kanë trajtuar protestat e dhunshme në mënyrë profesionale.

Përgjegjësia për koordinimin e përgjithshëm të të **drejtave pronësore** bie mbi Ministrinë e Drejtësisë. Një strategji për të drejtat e pronësisë është duke u zhvilluar. Ligji për themelimin e Agjencisë për Krahasimin dhe Verifikim e Pronës së Kosovës, pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Pronës, i miratuar në qershor tani është duke u sfiduar në Gjykatën Kushtetuese. Mungesa e fondeve vazhdon të pengojë zbatimin e vendimit të Agjencisë Pronës së për rrënimin e ndërtimeve pa leje në pronën private. Aktualisht janë 29 lëndë të pazgjidhura dhe kostoja totale është rreth 50 000 euro. Kjo gjithashtu ndikon rëndë në të drejtat e personave të zhvendosur. Pas identifikimit të mbi 350 000 ndërtimeve pa leje, qeveria po rishikon politikën e saj dhe ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Riokupimi ilegal i pronave, të cilat tashmë Agjencia e Pronës i kishtë nën administrim, vazhdon të shfaqë shqetësim. Strategjia për legalizimin e vendbanimeve joformale nuk është miratuar ende. Qeveria nuk ka ndarë fonde për të ngritur një skemë kompensimi në lidhje me pronën shoqërore rezidenciale. Ka pasur progres të kufizuar në miratimin e një plani tre vjeçar mbi strehimin social nga ana e autoriteteve komunale, i cili tani pengon autoritetet qendrore nga përfundimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për Kosovën në lidhje me strehimin social.

Për sa i përket **mosdiskriminimit**, legjislacioni për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen nga diskriminimi nuk është miratuar. Gjatë periudhës së raportimit, Institucioni i Avokatit të Popullit pranoi ankesa në numër të ngjashëm me vitet e mëparshme dhe numër të dyfishuar të hetimeve për shkak të detyrës mbi baza të diskriminimit. Mekanizmi gjurmues i Këshillit Prokurorial të Kosovës ende duhet të zgjerohet për të mbuluar rastet e të gjitha llojeve të diskriminimit, jo vetëm ato në bazë të përkatësisë etnike. Performanca e institucioneve në përpunimin dhe hetimin e rasteve të diskriminimit mbetet e dobët. Duke ndjekur shembullin e Akademisë së Policisë, e cila tashmë ka një modul të veçantë të trajnimit në lidhje me anti-diskriminimin për oficerët e policisë të rekrutuar rishtazi, qeveria duhet ta çojë para programin për trajnimin e trajnuesve dhe të përfshijë trajnerë të licencuar të anti-diskriminimit nga institucionet kryesore të tilla si gjyqësori, shërbimi prokurorial, policia, administrata publike dhe ministria e arsimit.

Korniza ligjore e Kosovës për **barazi mes grave dhe burrave** është në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përpjekjet për të përfuar legjislacionin ekzistues duke hartuar një kod të unifikuar civil janë një mundësi e mirë për të sjellë atë plotësisht në përputhje me standardet evropiane. Zbatimi i ligjit për barazinë gjinore është i ngadalshëm dhe legjislacioni sekondar ende nuk është miratuar. Fakti se pozita për shefin e Agjencisë për Barazi Gjinore nuk është plotësuar e ka penguar zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë si dhe roli i Agjencisë në bërjen e politikave duhet të forcohet më tej.

Dhuna me baza gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, është një sfidë me kufizime të rënda në sistemet e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, e cila theksohet nga vdekja tragjike e një gruaje në Suharekë në tetor të vitit 2015. Një zhvillim pozitiv është linja telefonike për anti-trafikim dhe dhunë familjare e cila tani është duke ofruar ndihmë për folësit serbë në veri. Strategjia dhe plani i ri i veprimit për vitin 2016-2020 mbi mbrojtjen nga dhuna në familje duhet të miratohet. Mungesa e një sistemi të mbledhjes së rregullt të të dhënave në të gjitha institucionet e dobëson aftësinë për të përcjellur dhe monitoruar raste procedura të hetimit dhe gjyqësore. Njësitë për dhunën me bazë gjinore duhet të themelohen në komunat veriore. Autoritetet duhet të përmirësojnë programet e riintegritimit për të mbijetuarit e dhunës në familje. Komisioni i cili ka të bëjë me të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës duhet të fillojë verifikimin e statusit të të mbijetuarve për të mundësuar dhe për të siguruar qasje në përfitime individuale. Në mars të vitit 2016, u miratuan masa për të rregulluar regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve, duke forcuar mbrojtjen ligjore të të drejtës së grave për trashëgimi. Në praktikë, zbatimi mbetet i kufizuar, gjë që drejtpërsëdrejti cenon fuqizimin ekonomik të grave.

Në lidhje me të **drejtat e fëmijëve**, korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhje me kërkesat ndërkombëtare, por zbatimi mbetet një sfidë. Autoritetet duhet të sigurojnë një buxhet adekuat për projektligjin e ri mbi mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë që ai të jetë efektiv sapo të miratohet. Të dhënat dhe mekanizmat e monitorimit për të vlerësuar progresin në zbatimin e të drejtave të fëmijëve duhet të përmirësohen. Përdersia zyrtarët për të drejtat e fëmijëve janë emëruar në shumicën e komunave, ndikimi i tyre është i kufizuar. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të sigurojë financim adekuat për strehimoret e fëmijëve të cilët janë viktimat e dhunës dhe trafikimit. Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të angazhohet edhe më tej në promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur udhëhiqet nga parimi i "interetit më të lartë të fëmijës" mishëruar në Konventën e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës. Themelet e sistemit të drejtësisë për fëmijët janë në rregull dhe departamentet për të miturit janë ngritur në të gjitha gjykatat themelore dhe prokuroritë. Për sa i përket qasjes së fëmijëve në drejtësi, pak progres është arritur në zhvillimin ligjor dhe të kapaciteteve për zbatimin e duhur të procedurave miqësore për fëmijët në rastet civile dhe administrative. Progres i mirë është bërë me anë të një protokollit të referimit për të siguruar shërbime ligjore dhe profesionale falas për fëmijët viktimat dhe dëshmitarët. Ndërsa dispozitat aktuale në Kodin e Drejtësisë për të Mitur nuk janë në përputhje me Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me parburgimin (12 muaj në vend të 6), në praktikë në 2 vitet e fundit asnjë i mitur nuk është ndaluar për më shumë se 6 muaj. Si rezultat i kësaj, heqja e lirisë së plotë është bërë një masë e fundit dhe është përdorur për kohën më të shkurtër të përshtatshme.

Mbi të **drejtat e personave me aftësi të kufizuara**, zbatimi i strategjisë për vitin 2013-2023 mbetet i kufizuar dhe qeveria tani duhet të hartojë një plan të ri veprimi për vitin 2017-2019. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ende nevojë për të gjetur një zgjidhje për të adresuar situatën e më shumë se 1 000 anëtarëve të komunitetit të të shurdhërve të cilët janë larguar nga skema e pensionit për personat me aftësi të kufizuara në vitin 2013. Ligji për personat paraplegjik dhe tetraplegjik u miratua në maj 2016. Këshilli Kombëtar për Aftësisë e Kufizuar emëroi kryetarin e Forumit të Aftësisë së Kufizuar në Kosovë si bashkëkryetar të tij, duke e bërë Këshillin më gjithëpërfshirës dhe transparent. Ai duhet të

mbajë takime të rregullta dhe të marrë një rol më proaktiv për të përmirësuar mirëqenien dhe për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Autoritetet duhet të përmirësojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor duke rritur numrin e stafit profesional dhe asistentëve personal. Qasja në ndërtesat publike dhe transporti publik mbeten problematike.

Ka pasur pak progres mbi të drejtat e komunitetit të **lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjiorëve dhe interseksualëve (LGBTI)**. Më 17 maj, për të tretin vit me radhë, në Prishtinë u organizua marshim paqësor për të shënuar ditën ndërkombëtare kundër homofobisë, transfobisë dhe bifobisë me praninë e politikanëve të nivelit të lartë, përfshirë edhe Presidentin. Rastet e sulmeve verbale dhe fizike ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI duhet të hetohen. Grupi këshillues dhe koordinues për të drejtat e personave LGBTI duhet të marrë një rol më proaktiv, duke ofruar këshilla dhe rekomandime konkrete për institucionet përkatëse.

**Çështjet e të drejtave të punës dhe sindikatave** janë të mbuluara në seksionin 4.1.8.

Lidhur me **të drejtat procedurale**, personat e dyshuar apo të akuzuar apo viktimat e krimit kanë të drejtë për mbrojtje solide në bazë të Kodit të Procedurës Penale, ligjit për policinë, ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, ligjin për kompensimin e viktimave të krimit dhe ligjin mbi ndihmën juridike falas. Ata kanë të drejtën e interpretimit dhe përkthimit, të drejtën për informim në lidhje me të drejtat e tyre, të drejtën për këshilla ligjore para dhe gjatë gjykimeve dhe për ndihmë juridike, si dhe të drejtën për të komunikuar me anëtarët e familjes, punëdhënësit dhe autoritet konsullorë. Ekziston vullnet i fortë politik për t'i zbatuar këto rregulla, por burimet financiare dhe trajnimi më i madh është i nevojshëm. Në prill, policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial dhe Gjyqësor Prokurorial dhe Oda e Avokatëve të Kosovës e nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për të krijuar një mekanizëm koordinues për sigurimin e mbrojtjes falas.

Zbatimi i kuadrit ligjor për **minoritetet** vazhdon të jetë i sfiduar. Struktura institucionale dhe mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve pakicë janë në rregull në nivel qendror dhe lokal. Në veri, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionet e Komunitetit janë themeluar dhe kanë filluar të punojnë. Këshillat Komunale për Siguri, të themeluara në vitin 2009 për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin e komunitetit, gjithashtu duhet të jenë të vendosura në veri për të forcuar më tej mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Institucionet e Kosovës duhet të marrin pronësinë dhe të përqëndrohen më shumë në zbatimin duke rritur ndërveprimin mes institucioneve qendrore dhe lokale të Kosovës dhe komuniteteve pakicë. Zyra për Çështje të Komuniteteve duhet të jetë plotësisht e përfshirë në zhvillimin dhe përparimin e krijimit të politikave për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Në maj 2016, një grup pune teknik publikoi një raport mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Komitetit Këshillimor të Evropës mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Raporti nuk është i plotë, të dhënat janë të kufizuara dhe treguesit për monitorimin e progresit mungojnë.

Në mars 2016 u realizua raundi i dytë i një programi për punë praktike për komunitetet pakicë në institucionet publike. Megjithatë, punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në shërbimin civil dhe ndërmarrje publike mbetet shumë sfidues. Progres është bërë me rregulloren e cila u mundëson të diplomuarve të Universitetit të Mitrovicës t'i certifikojnë diplomat e tyre për qëllime punësimi, licencimi profesional dhe pranimi në provimet profesionale në institucionet e Kosovës. Si rezultat i masave dhe kuotave mbështetëse, një numër më i madh i studentëve nga komunitetet pakicë ishin në gjendje të regjistrohen në universitetet publike. Kjo paraqet një hap pozitiv në drejtim të përfshirjes efektive të komuniteteve pakicë në Kosovë.

Angazhim më i fortë dhe mbështetje nga institucionet qeveritare në integrimin e politikave gjuhësore janë të nevojshëm. Zbatimi i ligjit për gjuhët zyrtare mbetet i ulët. Përkthimi apo interpretimi në gjuhën

shqipe apo serbe, duke përfshirë përkthimin e ligjeve është shpesh i rëndomtë. Zyra e Komisionerit për Gjuhët vazhdon të punojë në mënyrë të kënaqshme dhe tani është gjithashtu duke filluar punën edhe në komunat veriore. Megjithatë, ajo ka nevojë për mbështetje politike dhe financiare.

Këshilli Konsultativ për Komunitete ka forcuar më tej rolin e vet dhe ka vërejtur rritje të interesit për pjesëmarrje nga komuniteti serb. Për t'i dhënë këtij organi një bazë të fortë, rritja e buxhetit është e nevojshme dhe rekomandimet e tij duhet të merren parasysh nga ministritë.

Situata e përgjithshme e sigurisë për komunitetet pakicë mbetet relativisht e qëndrueshme dhe kryesisht e pandryshuar. Megjithatë, ka incidente të përsëritura të vjedhjes së pronës, dëmtimit dhe krimeve të lidhura ndaj personave të kthyer serbë të Kosovës dhe anëtarëve të tjerë të komuniteteve pakicë. Incidente të tilla rrisin ndjenjën e pasigurisë, ndikojnë negativisht në jetesën dhe shoqërinë e tyre në tërësi dhe largojnë të kthyerit e tjerë të mundshëm. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore duhet të bëjnë çdo përpjekje për të sjellë autorët para drejtësisë dhe për të kundërshtuar perceptimin e mosndëshkimit në mënyrë për të rivendosur besimin midis viktimave dhe shoqërisë si tërësi. Krimet e urrejtjes të cilat i kanë si synim komunitetet pakicë duhet të trajtohen më me vendosmëri. Gjatë punës së mëtejshme është e nevojshme të mirret parasysh neni 147 dhe 74 § 2.12 i Kodit Penal. Rekrutimi shtesë i oficerëve të policisë nga komunitetet pakicë në zonat e prekura, në mënyrë të veçantë në pjesën perëndimore të Kosovës, është i nevojshëm.

Gjendja e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian<sup>4</sup> mbetet sfiduese. Duke u mbështetur në strategjinë e vitit 2009-2015, qeveria synon përfundimin e angazhimeve të reja të politikave, duke u fokusuar në përfshirjen e këtyre komuniteteve në shoqëri, para fundit të vitit 2016. Ndërkohë që procesi i konsultimeve ishte gjithëpërfshirës, vetëm disa rekomandime nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare janë marrë parasysh. Komunat janë të inkurajuara për të ripërtërirë, miratuar dhe zbatuar Plane Lokale të Veprimit. Rekomandimet e seminarit të mbajtur në nëntor rreth komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian duhet të zbatohen.

Qendrat e mësimin vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e numrit të lartë të braktisjes së shkollës dhe në integrimin e mëtejshëm të bashkësive romë, ashkali dhe egjiptiane në sistemin arsimor. Qeveria vazhdon të ofrojë libra falas në gjuhën romë. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të gëzojnë të njëjtën qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor si qytetarët e tjerë. Buxheti për strehim duhet të alokohet. Disa komuna kanë vazhduar të japin tokë për këto komunitete. Kosova ka vazhduar të marrë masa mbështetëse me Malin e Zi dhe me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për të siguruar qasje në regjistrimin civil për komunitetet e zhvendosura romë, ashkali dhe egjiptian. Masat aktive për përfshirjen e këtyre komunitete janë të nevojshme për luftimin e përjashtimit nga tregu i punës. Martesat e fëmijëve dhe puna e fëmijëve vazhdojnë të jenë të përhapura. Kosova duhet të marrë pronësinë e plotë të masave të nevojshme për të mbështetur komunitetin romë, ashkali dhe egjiptian me qëllim të reduktimit të varësisë nga donatorët.

Ritmi i kthimit dhe riintegrimin të **refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit (PZhBV)** është i ngadalshëm dhe shkalla e kthimit po bie nga viti në vit. Shifrat e kthimit për këtë vit janë shifrat më të ulët deri tani. Përpjekjet e vazhdueshme janë të nevojshme për të mbledhur dhe ruajtur të dhënat për numrat dhe lokacionet e personave të zhvendosur dhe të të kthyerve. Uzurpimi i pronave që i takojnë popullatës së zhvendosur, së bashku me ndërtimin e paligjshëm në tokën e tyre dhe mosekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese i muajit prill 2014 lidhur me këto çështje, po pengon procesin e kthimit. Në mungesë të një përgjigjeje efektive nga autoritetet komunale për këtë çështje, mbikëqyrja më e fortë e nivelit qendror dhe bashkëpunimi ndërministror më i fortë janë të nevojshëm.

---

<sup>4</sup> Të gjitha këto grupe konsiderohen nën termin më të gjerë "romë" në kuadër të kornizës së BE-së për strategjitë e integritit kombëtar të romëve

Në lidhje me **të drejtat kulturore**, marrëdhëniet në mes të autoriteteve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe kanë qenë të tensionuara gjatë periudhës së raportimit, sidomos për shkak të dështimit të Kosovës për tu anëtarësuar në UNESCO. Kisha u tërhoq nga bashkëpunimi i rregullt me Këshillin për Zbatim dhe Monitorim (KZM). Në disa raste, autoritetet bënë thirrje që bashkëpunimi të rifillojë dhe, pas një periudhe 10 mujore të pasivitetit u mbajt një takim në prill. Është e rëndësishme që KZM-ja përdoret për të zgjidhur vështirësitë që hasen në bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Kishës Ortodokse Serbe. Qeveria duhet të rrisë përpjekjet e saj për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të sekretariatit të KZM-së. Njësia e trashëgimisë fetare dhe kulturore e policisë së Kosovës përmbush mandatin e saj në katër rajone, për të mbrojtur objektet e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe me 205 oficerë. Përmirësimi i komunikimit me klerin ortodoks serb mbetet një sfidë.

Autoritetet e Kosovës kanë filluar të ndërmarrin hapa për miratimin e legjislacionit për të rivendosur të gjitha dispozitat thelbësore të përfshira në Aneksin V të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit (PGJS), në lidhje me menaxhimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë.

Qeveria në mënyrë proaktive ka bashkëpunuar me BE-në në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore dhe i njëjti pritjet për hartimin e ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për trashëgiminë kulturore, i cili duhet të bëhet pa vonesë dhe të pasqyrojë me saktësi të gjitha angazhimet e Kosovës në bazë të Aneksit V të PGJS-së.

Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe është duke funksionuar në përputhje me ligjin. Këshilli për Trashëgimi Kulturore në Prizren është integruar në strukturat komunale dhe funksionon në përputhje me ligjin për qendrën historike të Prizrenit. Qeveria rriti bashkëpunimin me shoqërinë civile në menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Në qershor të vitit 2016 Komuna e Prizrenit caktoi dy inspektorë shtesë për Qendrën Historike të Prizrenit. Incidentet e dëmtimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar dhe sanksionet kundër kryesve të veprës nuk janë zbatuar. Degradimi sistematik i trashëgimisë, veçanërisht në Prizren, është një shqetësim i madh dhe përbën një rrezik në rritje për sigurinë publike. Grupi i punës i formuar në vitin 2014 për t'u marrë me ndërtimet pa leje në Prizren ka pasur ndikim minimal. Përpjekjet e intensifikuara për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin e duhur të trashëgimisë kulturore në tërë Kosovën janë të nevojshme.

## 2.5 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Kosova vazhdoi punën për të përmbushur detyrimet e mbetura lidhur me ndjekjen e akuzave të **krimeve ndërkombëtare**, të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, të paraqitura në raportin e vitit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ndryshimet kushtetuese dhe legjislative të nevojshme për krijimin e kushteve për ngritjen e Dhomave dhe Prokurorisë Speciale janë miratuar. Dhomat janë subjekt i ligjeve të Kosovës, por janë të vendosura jashtë Kosovës. Në shkurt, presidenti përfundoi procedurat në lidhje me marrëveshjen dypalëshe që të cilat lejojnë që vendndodhja e Dhomave Speciale të jetë në Holandë, duke përfunduar kështu obligimet e Kosovës.

Kosova ka ngritur një departament **të krimeve të luftës** brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale të saj. Megjithatë, departamenti ka vetëm dy prokurorë lokalë për një ngarkesë e cila do të rritet më tej, kur më shumë raste të EULEX-it të jenë dorëzuar. Njësia hetimet për krime lufte e policisë së Kosovës ka pranuar staf shtesë, automjete dhe kompjutera. Megjithatë, përvoja e kufizuar dhe mungesa e hetuesve me prejardhje etnike serbe, stafit për analiza të inteligjencës kriminale dhe gjuhës dhe kapaciteteve të përkthimit, ka një ndikim në punën e njësies. EULEX-i është duke mbështetur Kosovën në ngritjen e kapaciteteve për tu marrë në mënyrë efektive me hetimet e krimeve të luftës dhe prokurorisë. Në rastet kur të dyshuarit janë serbë që jetojnë kryesisht në Serbi, bashkëpunimi i ndërsjellë juridik me Serbinë nuk ekziston në mënyrë efektive. Ekziston një shqetësim i përgjithshëm në lidhje me kapacitetet dhe

gatihmërinë për të trajtuar rastet e krimeve të luftës që përfshijnë ish-anëtarë të UÇK-së.

Fati i **personave të pagjetur** nga konflikti i viteve të 90-ta mbetet një shqetësim humanitar, zgjidhja e të cilit është jetike për pajtim dhe stabilitet në rajon. Që nga korriku, një total prej 10 593 persona janë ende të zhdukur sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK). Nga këto, 1 665 kanë të bëjnë me konfliktin e vitit 1999. Emërimi i shefit të delegacionit të Prishtinës në grupin e punës të drejtuar nga ICRC për personat e zhdukur është një hap pozitiv. Grupi punues u përball me sfida serioze, duke rezultuar në vetëm katër lëndë të zgjidhura në vitin 2015, numri më i ulët që nga fundi i konfliktit. Qeveria duhet të emërojë një mbajtës të skedarëve për çështjen e personave të zhdukur dhe të tregojë angazhim më të madh politik dhe përpjekje të reja. Mungesa e informacionit mbi varrezat të cilat ende mbeten për t'u zbuluar mbetet një pengesë për zgjidhjen e çështjes. Kosova duhet të angazhohet më shumë në mënyrë proaktive dhe të sigurojë informacion nga burimet e veta. Politizimi i procesit, përfshirë edhe deklaratat të panevojshme në media dhe një dobësimi i mëtejshëm i procesit për shkak të mosmarrëveshjeve ndër-institucionale duhet të shmanget.

Instituti i Mjekësisë Ligjore të Kosovës vazhdon të ketë kapacitete të pamjaftueshme për të përmbushur standardet e kërkuara për praktikë të qëndrueshme të mjekësisë ligjore, duke përfshirë antropologjinë e mjekësisë ligjore dhe arkeologjisë. Autoritetet kanë nevojë për të adresuar këtë çështje urgjentisht. Koordinimi dhe bashkëpunimi me komisionin qeveritar për personat e zhdukur mbetet i kufizuar. Të dy kanë nevojë për alokimin e burimeve dhe të rifillojnë futjen e të dhënave në regjistrin qendror të personave të zhdukur, e cila u ndal në gusht të vitit 2014. Mungesa e progresit në këtë çështje pengon qeverinë nga marrja e detyrimit të saj për të krijuar dhe menaxhuar listën e personave të zhdukur. Autoritetet duhet të miratojnë aktet nënligjore për krijimin e një regjistri qendror, dhe mbylljen e rasteve, për të mbështetur zbatimin e ligjit për personat e zhdukur. Asnjë progres nuk është bërë në lidhje me mbetjet e paidentifikuara të njeriut të ruajtura në morgun e Prishtinës, për të cilin veprimi i mjekësisë ligjore ka qenë i dobët. Gjatë zhvillimit të një strategjie për ballafaqimin me të kaluarën, grupi ndërministror i punës për ballafaqimin me të kaluarën ka nevojë për të kryer një proces transparent të konsultimit të drejtësisë tranzicionale i cili do të jetë senzitiv në aspektin gjinor dhe atë të viktimave dhe cili do të përfshinte të gjitha komunitet dhe grupet e marginalizuara. Procesi kërkon angazhimin aktiv të shtuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe një kontribut financiar nga qeveria.

**Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë** janë një pjesë thelbësore e procesit të Kosovës drejt BE-së. Këto kontribuojnë në stabilitet, pajtim dhe një klimë të favorshme për trajtimin e çështjeve të hapura dypalëshe dhe trashëgiminë e së kaluarës. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Interpol dhe aplikuar për anëtarësimin në UNESCO, mirëpo nuk arriti ta bëjë këtë. Kosova morri një rol më aktiv në disa organizata rajonale, sidomos në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal. Kosova ende nuk është e përfaqësuar në të gjitha organizatat rajonale që janë në kuadër të marrëveshjes për marrëveshjet mbi përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal, siç është rënë dakord me Beogradin në vitin 2012. Shtysa dhënë nëpërmjet **procesit të Berlinit** dhe Iniciativës për gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor, sidomos në lidhje me agjendën lidhëse, ka vazhduar te nxisë rritjen e bashkëpunimit rajonal. Duke u bazuar në rezultatet e samiteve të mëparshme, Samiti i Parisit i mbajtur në qershor 2016 ka vërtur përparime të mëtejshme në agjendën lidhëse, por edhe hapi bashkëpunimin në fusha të reja, sidomos nëpërmjet themelimit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) në Tiranë. Kosova ka marrë pjesë në mënyrë aktive. Masat e mbetura në fushën e transportit përfshijnë përmirësimin e zbatimit të udhëzimeve të IBM dhe pranimin reciprok të licencave për shofer treni ndër të tjera. Në lidhje me energjinë, Kosova duhet të ndërpresë rregullimet e çmimeve, të finalizojë diskutimet me Shqipërinë për tu lidhur me shkëmbimin e saj të energjisë, të finalizojë procedurat teknike për të krijuar një treg funksional dhe të balansuar dhe të miratojë një ligj të përshtatshëm të energjisë, e cila do të lejojë përparim në një numër masash të tjera. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji nuk është në gjendje të përfitojë nga tregu rajonal i energjisë elektrike siç është rënë dakord në Paris.

Kosova ka qenë e angazhuar në mënyrë konstruktive në lidhje me **marrëdhëniet bilaterale me vendet e tjera të zgjerimit dhe shtetet fqinje anëtare të BE.**

Kosova ka vazhduar të thellojë marrëdhëniet e saj me **Shqipërinë**. Në maj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nënshkroi një marrëveshje dypalëshe me homologun nga Shqipëria për rritjen dhe mbrojtjen e investimeve, që të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik dhe krijojnë kushte të favorshme për investime. Në qershor 2016, dy qeveritë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në lidhje me mjedisin, energjinë, transportin, reformën e administratës publike, doganat, tatimet dhe trajnimet e përbashkëta.

Nuk ka marrëdhënie zyrtare mes Kosovës dhe **Bosnjës dhe Hercegovinës**, pasi që kjo e fundit nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Regjimi reciprok i vizave vazhdon të ekzistojë.

Marrëdhëniet me **ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë** kanë vazhduar të zhvillohen. Në shkurt 2016, u nënshkrua një marrëveshje partneriteti për menaxhimin e asistencës teknike, sikurse marrëveshja për bashkëpunim mbi integrimin në BE. Një marrëveshje mbi përdorimin e dokumenteve të identifikimit personal për qytetarët që kalojnë kufirin e përbashkët ka hyrë në fuqi në prill 2016. Disa tensione rezultuan nga deklaratat e politikanëve në lidhje me pjesëmarrjen e njerëzve nga Kosova në incidentin Kumanovë në vitin 2015.

Marrëdhëniet mes **Malit të Zi** dhe Kosovës mbeten të mirë. Në shtator 2015, ka hyrë në fuqi marrëveshja për bashkëpunim policor. Marrëveshja për bashkëpunim mes komisioneve për personat e zhdukur u nënshkrua në tetor. Nuk pati zhvillime në lidhje me njohjen kushtetuese të pakicës malazeze në Kosovë. Marrëveshja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi u ratifikua nga Podgorica në dhjetor të vitit 2015, por po përballlet me rezistencë në Kuvendin e Kosovës.

Kosova ka ruajtur marrëdhëniet miqësore me Turqinë. Marrëveshja e ripranimit u nënshkrua në dhjetor të vitit 2015, në kuadër të liberalizimit të vizave për Kosovën.

### **3. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE MES KOSOVËS DHE SERBISË**

Puna në dialogun e lehtësuar nga BE-ja ka vazhduar gjatë gjithë periudhës së raportimit. Progresi i përgjithshëm në zbatimin e marrëveshjes së 25 gushtit 2015 ka qenë i ngadalshëm. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të rrethanave të caktuara të brendshme, me zgjedhjet parlamentare të ndjekura nga një proces i gjatë i formimit të qeverisë në Serbi dhe situata e brendshme në Kosovë. Gjatë dialogut të fundit të nivelit të lartë në janar 2016, të dyja palët kishin kërkuar hapësirë politike për të vepruar në trajtimin e këtyre sfidave të brendshme dhe konsolidimin e qeverië dhe qeverisjes. Kontaktet dhe diskutimet e shpeshta dypalëshe me BE- e ndihmojnë ruajtjen e angazhimit politik në nivel më të lartë dhe riangazhimin e të dyja palëve për të rifilluar punën në zbatimin e marrëveshjeve të kaluara.

Që nga formimi i qeverisë serbe në gusht, të dyja palët e angazhuan në përsheptimin e zbatimit të **marrëveshjeve të 25 gushtit 2015**. Zbatimi i marrëveshjes për Urën e Mitrovicës ka filluar në gusht dhe punët në dhe afër urës, duke përfshirë edhe kthimin e rrugës kryesore të Komunës së Mitrovicës së Veriut (rr. Mbreti Petar) në një zonë për këmbësorë, do të përfundojnë në janar 2017. Proges është bërë për tejkalimin e pikëpamjeve të ndryshme mbi marrëveshjen për **telekomin**, ndërsa zbatimi i fundit nuk është bërë ende. Pak progres është bërë rreth **Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe në Kosovë**. Pas emërimit zyrtar të ekipit menaxhues, duhet të jepet mandat nga Kosova për hartimin e statutit të Asociacionit/Bashkësisë. Serbia duhet të regjistrojë dhe të licencojë dy kompanitë e energjisë serbe për t'u vendosur në Kosovë për të mundësuar përparim në fushën e **energjisë**.

Progres i mëtejshëm është bërë në zbatimin e **“Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë**



**normalizimin e marrëdhënieve” të prillit 2013.** Personeli i policisë dhe mbrojtjes civile të serbëve të Kosovës tani janë plotësisht të integruar në sistemin e Kosovës. Shpërbërja e strukturave serbe në **drejtësi** vazhdon ashtu siç është planifikuar dhe i gjithë ish-personeli gjyqësor serbë pritet të jenë në sistemin e Kosovës deri në vjeshtë të vitit 2016. Në kuadër të **marrëveshjeve ndërlidhëse**, vizita zyrtare janë rregulluar drejtpërdrejt nga oficerët ndërlidhës në përputhje me marrëveshjet relevante.

Shumica e marrëveshjeve nga **Dialogu Teknik (2011-2012)** janë zbatuar dhe tani funksionojnë. Në fushën e **kadastrit**, skanimi i dokumenteve që kanë të bëjnë në Kosovën përfundoi në qershor, siç ishte planifikuar, por dokumentet nuk janë dorëzuar tek përfaqësuesi i posaçëm i BE-së në Kosovë, në përputhje me marrëveshjen mbi kadastrin. Të dyja palët ranë dakord për modalitetet e reja për zbatimin e marrëveshjes mbi **diplomat e Universitetit** në prill. Një marrëveshje u arrit në shtator në zbatimin elementeve të mbetura mbi lëvizjen e lirë në lidhje me targarat. Kërkesat për **ndihmën e ndërsjellë juridike** janë duke u përpunuar. Serbia duhet të mbetet e përkushtuar në zbatimin e vazhdueshëm të marrëveshjes për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në **forumet rajonale**. Deklaratat e zyrtareve serbë më disa raste kanë ndërhyrë në procesin gjyqësor të udhëhequr nga **EULEX-i**. Serbia ende nuk e ka adresuar çështjen e strukturave serbe **doganore** administrative të rivendosura me emërtim të Kosovës që veprojnë brenda Serbisë, dhe të ndërpresë lëshimin e dokumentacionit apo fiksimit e pullave me emërtim cili bie në kundërshtim me marrëveshjen e përmendur. Sa i përket **IBM**, përderisa pikat e ndërmjetme të kalimit janë plotësisht operative, nuk ka pasur progres në krijimin e tri pikave të përhershme kufitare të organizuara nga Serbia. Rugët e kalimit të paligjshëm/rugët anësore, në veçanti në veri të Kosovës, vazhdojnë të përdoren rregullisht për të kontrabanduar sasi të konsiderueshme të mallrave. Masa të tjera duhet të merren nga Serbia për të mbyllur kalimet e paligjshme.

Në përgjithësi, Kosova ka qenë e angazhuar në dialog dhe në zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Megjithatë, Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme dhe të kontribuojë në krijimin e rrethanave të favorshme për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Progresi i mëtejshëm në këtë fushë mbetet thelbësor për avancimin e të ardhmes evropiane të Kosovës.

#### 4. KRITERET EKONOMIKE

Shifrat kryesore ekonomike	2014	2015
Produkti i brendshëm bruto për frymë (% e EU28 në PPS)	N/A	N/A
Rritja e PBB (%)	1.2	4.0*
Shkalla e papunësisë (femra; meshkuj) (%)	35.3 (41.6; 33.1)	32.9 (36.6; 31.8)
Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshës 20-64: përqindja e popullsisë së moshës 20-64 vjeç që është ekonomikisht aktive (femra; meshkuj) (%)	47.7 (24.2; 71.4)	42.8 (20.4; 65.1)
Bilanci aktual i llogarisë (% e PBB)*	-7.9	-9.3
Investimet e huaja direkte (IHD) (% e PBB)*	2.2	5.1

\* Në bazë të të dhënave të grumbulluara të PBB-së gjatë tre mujorit

Burimi: Eurostat

Në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian në Kopenhagë në qershor të vitit 1993, anëtarësimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe kapacitetin për tu përballuar me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Monitorimi i këtyre kritereve ekonomike duhet të shihet në kontekstin e rëndësisë qendrore të qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit. Çdo vend në zgjerim përgatit Programin Ekonomik të Reformës (ERP) për çdo vit, i cili përcakton një kornizë afatmesme makro-fiskale të politikave dhe një agjendë të reformave strukturore që synon sigurimin e konkurrencës dhe rritjen gjithëpërfshirëse. ERP-të janë bazë për udhëheqjen e politikave të vendit specifik të miratuara bashkërisht nga BE-ja, Ballkani Perëndimor dhe Turqia në nivel ministror në maj të çdo viti.

#### 4.1. Ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregut

Kosova është në një **fazë të hershme** të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Janë bërë **disa përpertime**, sidomos në mbështetjen e bizneseve të orientuara nga eksporti, përmirësimin e zbatimit të kontratave, veçanërisht në sektorin financiar dhe qasjen në financa. Ndjekja e reformave ekonomike është duke vazhduar, por vendimet në lidhje me përfitimet e veteranëve të luftës mund të sfidojnë qëndrueshmërinë fiskale dhe të ndikojnë në marrëdhëniet e Kosovës me institucionet financiare ndërkombëtare. Deficiti i vazhdueshëm tregtar shfaq një bazë të dobët të prodhimit dhe aftësisë konkurruese të dobët ndërkombëtare. Mbështetja në remitancat dhe ekonomia informale e përhapur ul nxitjen për punësim duke rezultuar në pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore, veçanërisht në mesin e grave, si dhe rezulton në norma të larta të papunësisë në veçanti në mesin e punëtorëve të rinj dhe të pakualifikuar.

Në përputhje me udhëzimet e politikave ERP dhe në mënyrë që të mbështetesë rritjen afatgjatë në vitet e ardhshme Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ sigurimit të qëndrueshmërisë fiskale, sidomos duke krijuar një organ të pavarur fiskal dhe duke forcuar planifikimet e pavarura;

→ përmirësimin të efikasitetit të shpenzimeve kapitale, veçanërisht nëpërmjet përmirësimeve në përgatitjen e projekteve dhe kapacitetet menaxhuese në nivel qendror dhe lokal;

→ përmirësimin të procedurave të falimentimit dhe paaftësisë paguese.

#### Qeverisja ekonomike


**Dokumentet strategjike të qeverisë tregojnë një angazhim të përfortuar drejt ndjekjes së reformave ekonomike.** Megjithatë, politika ekonomike e Kosovës karakterizohet nga vendimmarrja ad hoc dhe zbatimi i ngadalshëm. Programi Ekonomik i Reformave (ERP) dhe Strategjia për Zhvillim Ndërkombëtar reflektojnë angazhimin për të ndjekur një politikë të qëndrueshmë fiskale dhe reforma strukturore. Megjithatë, udhëzimi i politikave nga 12 maji 2015 ka qenë pjesërisht i zbatuar. Disbursimi i dytë i Fondit Ndërkombëtar Monetar (FMN) është vonuar për shkak të kostove të nënvlerësuara që rrjedhin nga përfitimet e veteranëve të luftës, e cila paraqet një rrezik të madh për stabilitetin fiskal të Kosovës. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka hyrë në fuqi dhe krijon një marrëveshje të përhershme të tregtisë së lirë me BE-në. Nëse plotësohet me reforma të caktuara, ajo do të lehtësojë zhvillimin ekonomik në Kosovë.

**Udhëzimi i politikave të PRE:** Të përmirësojë saktësinë e parashikimit, të rrisë kapacitetet teknike të shërbimeve për përgatitjen e kuadrit makro-fiskal, forcimi i kapaciteteve parlamentare mbikëqyrëse në vlerësimin e planifikimit dhe ekzekutimit buxhetor si dhe të rreziqeve fiskale dhe për të bërë hapat e parë drejt krijimit të një organi të pavarur fiskal.

#### Stabiliteti makroekonomik

## Rritja ekonomike e Kosovës po tregon shenja të rimëkëmbjes, megjithëse të pamjaftueshme për të mbyllur hendekun e zhvillimit të vendeve të regjionit dhe për të rritur shkallën e punësimit.

Figura 1 Rritja e PBB në Kosovë



Të dhënat parakrake tregojnë që pati rritje ekonomike për 4% të PBB në vitin 2015, e cila është mbi rritjen mesatare vjetore prej 3% gjatë pesë viteve të fundit. Konsumi dhe investimet mbesin kontribuesit më të mëdhenj të rritjes, përderisa eksporti mbetet i dobët. Konsumi më i lartë privat u fuqizua nga remitancat më të larta, kreditimi më i lartë i konsumatorit dhe rritja e pensioneve dhe pagave në sektorin publik.

Rimëkëmbja e investimeve u mbështet nga ndërtimi i vazhdueshëm i autostradës për Shkup dhe flukset hyrëse të dyfishuara të investimeve të huaja direkte (IHD). Modeli i rritjes i Kosovës ende mbështetet kryesisht në konsum dhe investime në infrastrukturë, ndërsa kapacitetet e tjera të prodhimit janë të pazhvilluara. Rritja mbeti e fortë në tremujorin e parë të vitit 2016, për rreth 3.8%.

**Pabarazitë e jashtme janë përkeqësuar në vitin 2015, pavarësisht një përmirësimi të lehtë të deficitit tregtar.** Deficiti i llogarisë aktuale u rrit në 9.1% të PBB-së në vitin 2015, më e larta që nga viti 2011. Një fluks i rritjes së shpejtë të remitancave (13% e PBB-së në vitin 2015) dhe një deficit më i ulët tregtar (30.4% të PBB-së në vitin 2015), nuk ishin të mjaftueshme për të kompensuar rrjedhjen e madhe të fitimeve të IHD-ve dhe vazhdimësisë së rënjes së transfereve të qeverisë. Megjithatë, hyrjet e IHD-ve janë dyfishuar, duke arritur në 5.6% të PBB-së, pas regjistrimit të një ulje historike prej 2.7% në vitin 2014. Pothuajse 60% e të gjitha IHD-ve shkoi në pasuri të patundshme dhe vetëm 7.1% në sektorin e prodhimit. Sektorët e pasurive të patundshme, të ndërmjetësimit financiar dhe të ndërtimit tërheqin më së shumti IHD, duke reflektuar një mjedis të dobët të biznesit dhe të investimeve në bujqësi. Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës ka mbetur relativisht i ulët në 33.4%<sup>5</sup> të PBB-së, dhe nuk është një shkak për shqetësim të menjëhershëm.

Si një ekonomi e vogël e hapur, zhvillimet e çmimeve varen nga çmimet e importit, sidomos ato të ushqimeve dhe çmimeve të energjisë. Inflacioni i çmimeve të konsumit në Kosovë ka qenë në një trend në rënie që nga viti 2011, duke rezultuar në deflacion prej 0.5% në vitin 2015. Inflacioni u stabilizua në gjysmën e parë të vitit 2016 në rreth 0%, pavarësisht nga një rritje e ngadalshme në inflacionin bazë. Çmimet e importit kanë rënë për 1.2% në vitin 2015 dhe më tej për 4.2% në gjysmën e parë të vitit 2016.

### **Situata fiskale u përmirësua në vitin 2015 mirëpo vendimet ad hoc ende ndikojnë negativisht në financat publike.**

Të ardhurat buxhetore u rritën për 8.9% në 2015 drejtuar nga rritja e fortë në të ardhurat tatimore. TVSH dhe tatimi mbi të

ardhurat e korporatave janë rritur për shkak të qarkullimit më të lartë dhe profitabilitetit të dhjetë kompanive më të mëdha në Kosovë.

<sup>5</sup> Të dhënat e Bankës Qendrore në Kosovë

**Udhëzimi i politikave të PRE:** Të përmirësojë saktësinë e parashikimit, të rrisë kapacitetet teknike të shërbimeve për përgatitjen e kuadrit makro-fiskal, forcimi i kapaciteteve parlamentare mbikëqyrëse në vlerësimin e planifikimit dhe ekzekutimit buxhetor si dhe të rreziqeve fiskale dhe për të bërë hapat e parë drejt krijimit të një organi të pavarur fiskal.


Shpenzimet e ngrira dhe shkurimet janë plotësuar me rritjen e TVSH-së në 18% dhe futjen e një norme të re më të ulët prej 8% për disa mallëra thelbësore.

Për më tepër përjashtime nga TVSH për mallrat kapitale të importuara janë zbatuar për të stimuluar prodhimin vendor.

#### Udhëzimi i politikave të PRE:

Identifikimi i masave kompensuese për rritje të kohëve të fundit në përfitime kategorike duke ruajtur pjesën e shpenzimeve kapitale dhe adresimin e vazhdueshme në shpenzimin e buxhetit kapital duke përmirësuar përgatitjen e projekteve dhe kapacitetet menaxhuese në nivel qendror dhe lokal të administratës.

Figura 2 Zhvillimi fiskal i Kosovës



Deficiti i përgjithshëm buxhetor arriti në 2% të PBB-së (ose 1.5% e PBB-së, kur rregullohet nga dispozitat e rregullit fiskal, shumë më poshtë kufirit të 2%). Shpenzimet kapitale janë përdorur në 95% të shumës së planifikuar, por kryesisht për shkak të pagesave të avancuara për ndërtimin e Rrugës 6 të autostradës.

**Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2016 është karakterizuar të jetë më i lartë se të ardhurat e pritshme, por ajo mund të rrezikohet nga një rritje e konsiderueshme në lidhje me shpenzimet për përfitimet e veteranëve të luftës.**

Rritja e fortë ekonomike, efekti i një viti të plotë i TVSH-së, ndryshimi i akcizës dhe mbledhja e përmirësuar e borxheve tatimore ka rritur ndjeshëm të ardhurat e buxhetit. Përderisa shumica e artikujve të shpenzimeve qëndruan në përputhje me pritshmëritë e buxhetit, duke reflektuar rritje për shkak të zbatimit të marrëveshjes kolektive për punonjësit e sektorit publik, rritjes së ndihmës sociale, zbatimit të ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, si dhe ruajtjen e subvencioneve të larta për bujqësinë, rritja e pritshme e konsiderueshme e përfitimeve të luftës është një shkak për shqetësim serioz. Kjo rritje reflekton një planifikim të dobët të buxhetit dhe mungesës së vlerësimit të ndikimit të buxhetit. Buxheti për vitin 2016 synon një deficit fiskal prej 1.6% të PBB-së, dhe brenda rregullit të afatit fiskal.

**Kosova ka një nivel relativisht të ulët të borxhit publik.** Totali i borxhit publik ka vijuar të rritet, duke arritur në 13.5%<sup>6</sup> në vitin 2015, me një rritje të bonove të thesarit të emetuara në vend. Politika e matur fiskale është e rëndësishme duke pasur parasysh mbështetjen e Kosovës në financimin afatshkurtër të brendshëm dhe huave nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe paaftësinë e saj për të nxjerrë borxhin ndërkombëtar në mungesë të një vlerësimi të kredisë.

#### Zbatimi i rregullave fiskale dhe i mekanizmave monitoruese duhet të përforcohen.

Vendimmarrja fiskale ad hoc është rreziku kryesor për financat publike. Procedurat e planifikimit të buxhetit nuk kanë qenë transparente dhe programet e shpenzimeve të buxhetit nuk janë të bashkuara me prioritetet e politikave të identifikuara.

<sup>6</sup>Shifrat mbi borxhi publik nuk përfshijnë pjesën e Kosovës në borxhin e ish-Jugosllavisë në Paris dhe London Clubs.

Rregullat e reja të miratuara mbi pagat të cilat rregullojnë rritjen e pagave në sektorin publik nga 2018 me normën nominale të rritjes së PBB-së do të ofrojnë stabilitet të shpenzimeve aktuale. Një përjashtim i ri nga rregulli fiskal është miratuar duke rritur në këtë mënyrë hapësirën fiskale për projektet e investimeve kapitale të financuara nga institucionet ndërkombëtare.

Për shkak të miratimit të njëanshëm të euros në Kosovë, përzierja e politikës në dispozicion përfshin vetëm politikën fiskale dhe reformat strukturore. Ekonomia e Kosovës ka qenë vazhdimisht në rritje që nga viti 2003, por është e vështirë për të krijuar ndonjë lidhje shkakësore midis rritjes dhe politikës fiskale. Politika fiskale ka qenë e dominuar nga planifikimi afatshkurtër, jotransparent dhe vendimmarrja ad hoc. Kjo ka rezultuar me rritje të vazhdueshme të shpenzimeve aktuale. Megjithatë, deficitit buxhetor dhe borxhi publik mbetet i ulët. Zbatimi i reformave strukturore është aktualisht në një fazë të hershme.

### Funksionimi i tregjeve të produkteve

#### *Mjedisi i biznesit*

**Janë bërë disa përparime në thjeshtimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe të falimentimit.** Krijimi i 29 kompanive të cilat ofrojnë shërbime të shumëfishta ka zvogëluar në tri ditë kohën e nevojshme për të regjistruar një kompani. Megjithatë regjistrimi online i

**Udhëzimi i politikave të PRE:** Zbatimi i planit të veprimit të strategjisë për luftimin e ekonomisë joformale. Në veçanti, të përshpejtojë vlerësimet e rrezikut duke u fokusuar në sektorët dhe degët më të rrezikuara nga informaliteti, për të identifikuar dhe për të aplikuar masat e duhura korrigjuese.

paralajmëruar nuk është zbatuar plotësisht. Pengesat kryesore përfshijnë administratën e dobët dhe të papërgjegjshme, infrastrukturën e pazhvilluar (sidomos furnizimin jo të besueshëm të energjisë elektrike), sundimin e dobët të ligjit, korrupsionin, ekonominë e përhapur joformale dhe rezultatet e dobëta të arsimit. Kishte një rritje prej 4.6% të numrit të ndërmarrjeve të sapoformuara, kryesisht në sektorin e bujqësisë. Një ligj i miratuar së fundmi për falimentimin pritet të përmirësojë daljen në treg dhe të përshejtojë pagesat për kreditorët.

**Pavarësisht përparimit të bërë në rregullat ligjore që rregullojnë bizneset, ato ende nuk zbatohen sa duhet.** Kapaciteti shumë i dobët institucional për të zbatuar ligjin, i kombinuar me korrupsionin e përhapur, vazhdon të ndikojë negativisht në mjedisin e biznesit. Sistemi gjyqësor vuan nga qasja e dobët, joefikasitetit dhe vonesat. Pak progres është shënuar në zgjidhjen e rasteve të grumbulluara në gjykata (400 000 në korrik 2015). Ndryshimet e miratuara në ligjin për procedurat e zbatimit duhet të kontribuojnë në efikasitetin e rasteve komerciale dhe në përmirësimin e zbatimit të kontratave dhe grumbullimeve. Puna e mëtejshme është e nevojshme për rishikimin e kodit civil mbi paditë dhe praktikën e biznesit dhe zhvillimin bazës së të dhënave mbi pronat (kadastrin). Raporti vjetor i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm identifikon shkelje të shumta ligjore në ministri, komuna dhe institucionet të tjera publike, por ata që janë përgjegjës rrallë ndiqen penalisht.

#### *Ndikimi i shtetit në tregjet e produkteve*

Nuk ka pasur progres në zhvillimin e kapaciteteve institucionale për të kontrolluar ndihmën shtetërore dhe subvencionet janë ende duke u dhënë pa një strategji dhe vlerësim të duhur. Në mesin e ndërmarrjeve të menaxhuara nga qendra vetëm dy, Korporata Energjetike e Kosovës dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, kanë vazhduar të operojnë në fitim në vitin 2015. Procedurat e emërimeve të menaxhmentit të ndërmarrjeve publike janë shpesh subjekt i ndikimit politik. Procedurat e bazuara në merita të përzgjedhjes së menaxhmentit dhe mekanizmave anti-korrupsion duhet të forcohen. Qeveria ofroi subvencione dhe grante për investime me vlerë prej 46 milionë euro në sektorin e bujqësisë, por rritja e produktivitetit mbetet e dobët. Përgjithësisht tatimore dhe doganore vazhduan të zbatohen për disa sektorë (lëndëve të para, TI), Megjithatë këto kanë pasur një ndikim të kufizuar në investime dhe eksporte në vitin 2015. Kuvendi ka miratuar një ligj për investimet strategjike me qëllim të lehtësimit të vendimmarrjes në lidhje me projektet e sektorit privat të konsideruara si strategjike nga Qeveria. Mbështetja financiare për zonat ekonomike dhe parqet industriale vazhdoi, por pa një plan të qartë ose analiza transparente të ndikimit apo dhe boshllëkut. Ndikimi i qeverisë mbi kontrollet e çmimeve për shërbimet postare dhe të telekomunikacionit ka vazhduar.

#### *Privatizimi dhe ristrukturimi*

**Në përgjithësi, është arritur progres shumë i kufizuar në privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve e ndërmmarrjeve shoqërore dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve publike.** Edhe pse bordi i Agjencisë së Privatizimit është emëruar në dhjetor 2015, agjenda e privatizimit është vënë në pritje dhe asnjë privatizim i ri nuk ka ndodhur. Me emërimin e bordit të ri të menaxhmentit është bërë pak progres në funksionalizimin e Agjencisë, por ndërhyrja e tepërt ndikon negativisht në kredibilitetin dhe efikasitetin institucional.

Statusi i pazgjidhur i të drejtave pronësore dhe procedurat e zgjatur ligjore që kanë të bëjnë me pretendimet financiare mbi asetet e privatizuara pengojnë procesin e privatizimit dhe vonojnë dhënien e të ardhurave të privatizimit të mbajtura në bankën qendrore.

## Funksionimi I tregut financiar

### *Stabiliteti financiar*

#### **Stabiliteti i sektorit financiar është ruajtur.**

Sektori bankar është i shëndoshë me kapital të fuqishëm dhe mbulesë të likuiditetit. Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik ishte 18.1% në muajin gusht 2016, mbi minimumin rregullator. Rreziqet e kreditit janë të ulëta, ndërsa përqindja e kredive me probleme, të cilat janë të mbuluara plotësisht nga dispozitat bankare, është më e ulëta në rajon dhe ka rënë në 5.1% deri në gusht 2016, pjesërisht për shkak të aktiviteteve të përmbaruesit privat të kredive.

### *Qasja në financa*

**Tregjet financiare të Kosovës mbështeten në kreditë bankare tradicionale, ndërkohë që burimet e tjera të financimit mbeten të pazhvilluara.** Sistemi financiar i Kosovës është i dominuar nga sektori bankar i cili përbën 69.0% të asetëve totale të sektorit financiar. Sektori bankar mbetet kryesisht në pronësi të huaj (89.9%). Totali i asetëve të sistemit financiar u rrit për 8.1%, duke arritur në 86,0% të PBB-së në vitin 2015 dhe aktivitetet e kreditimit u përshpejtuan në krahasim me një vit më parë (një rritje prej 7.3% në totalin e kredive) të. Edhe pse kreditimi i përgjithshëm u rrit, raporti kredi-depozita është rritur vetëm pak në 74.8% nga 74.2% në vitin 2014 duke treguar hapësirë të mjaftueshme për aktivitetin më të fortë bankar. Norma mesatare e interesit në kredi ka rënë në vitin 2015 në 7.7% nga 9.3% në vitin 2014, por mbetet mbi mesataren rajonale.

**Sektori i sigurimeve është i dominuar nga kompanitë e sigurimit të jo-jetës dhe industria vazhdon të gjenerojë humbje.** Kostoja e sigurimit të makinave është artificialisht e lartë, pjesërisht për shkak se Kosova nuk është anëtare e sistemit të "kartonit të gjelbër", por edhe nuk ka cmime plotësisht të liberalizuara të sigurimit të përgjegjësisë për palën e tretë.

Një ligj i ri mbi sigurimet u miratua në dhjetor të vitit 2015, por mbikëqyrja në këtë sektor është ende e dobët. Transparenca duhet të përmirësohet duke publikuar raporte vjetore, duke përmirësuar besueshmërinë e auditimeve të pasqyrave financiare të kualifikuara dhe duke aplikuar standarde të rrepta për licencimin e kompanive të reja.

## Funksionimi i tregut të punës

### **Punësimi është shumë i ulët dhe përpjekjet për t'i përmirësuar kushtet e tregut të punës deri më tani kanë qenë të kufizuara dhe joefektive.**

Rritja e moderuar ekonomike gjatë viteve të fundit nuk është kthyer në performance më të mirë të tregut të punës. Sipas anketës për vitin 2015 mbi fuqinë punëtore, shkalla e pjesëmarrjes në punë mbetet jashtëzakonisht e


ulët

në

**Udhëzimi i politikave të PRE:** Të ngrisë një plan veprimi për trajtimin e papunësisë së të rinjve bazuar në një vlerësim të sfidave dhe duke u fokusuar në përmirësimin e rezultateve të edukimit duke përfshirë edhe trajnimin e përmirësuar të mësuesve dhe duke mbështetur kalimin nga shkolla në vend pune. Të sigurohet që Agjencia e Punësimit ka kapacitet të mjaftueshëm. Të marrë masa për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.


37.6%.

**Figura 3 Papunësia në Kosovë (% e popullatës aktive)**



\* Të dhënat për vitin 2010 dhe 2011

**Figura 4 Shkalla e pjesëmarrjes në Kosove (% e forcës së punës)**



Papunësia ka rënë në 32.9%, dhe mbetet ndër më të lartat në Evropë. Rezultatet e tregut të punës për gratë janë veçanërisht të dobëta (vetëm 18.1% e grave janë aktive dhe 36.6% e tyre janë të papuna). Shkalla e punëtorëve të pakualifikuar në mesin e përgjithshëm të të papunëve (57.1%) dhe papunësia e lartë e të rinjve (57.7%), demonstron nevojën urgjente për politika më aktive të tregut të punës, skema të parakualifikimit dhe programe të formimit profesional. Baza e ngushtë e prodhimit ofron mundësi të kufizuara për punësim, sidomos në kombinim me rezultatet e arsimit të dobëta Mismatched me kërkesat e tregut të punës. Në anën tjetër, Kosova nuk ka problem me legjislacionin për mbrojtjen e punës, tatimet apo punën dekurajuese të sistemit të mirëqenies sociale. Mirëpo, ka dëshmi se mbështetja në remitanca dekurajon punësimin. Financimi për shërbimet e punësimit dhe formimit profesional mbetet i pamjaftueshëm dhe është i ndarë edhe në disa subjekte. Plani i paralajmëruar për ti bashkuar ato nën Agjencinë e re për Punësim duhet ende të zbatohet. Statistikat në lidhje me tregun e punës janë të pamjaftueshme dhe të vjetruara, duke penguar një analizë të shëndoshë të tregut të punës.

#### 4.2 Kapaciteti për tu përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit

Kosova është në **një fazë të hershme** të ndërtimit të kapaciteteve për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. **Nuk ka përparim** në përmirësimin e cilësisë së arsimit, i cili është udhëheqës kyç për përmirësimin e rritjes afatgjatë dhe konkurrencës.

Në përputhje me rekomandimet ERP dhe në mënyrë për të mbështetur rritjes afatgjatë, në vitet e ardhshme Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji, zvoglimin e humbjeve të shpërndarjes dhe përmirësimin të efikasitetit energjetik ;
- mbylljes së hendekut të aftësive në tregun e punës;
- zbatimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare për luftimin e ekonomisë joformale;
- përgatitjen e një planit të veprimit për trajtimin e papunësisë së të rinjve dhe fokusimin në përmirësimin e rezultateve të arsimit.



## Edukimi dhe inovacioni

**Arsimimi, hulumtimi dhe zhvillimi janë penguar nga shpenzimet e pamjaftueshme publike, bashkëpunimi i dobët ndërmjet shkollave profesionale dhe ndërmarrjeve, si dhe vonesa në zbatimin e politikave për të kapërcyer hendekun e aftësive.** Në vitin 2015, shpenzimet totale publike në arsim ranë në 3.9% të PBB-së, nga 4.1% e PBB-së në vitin 2014, e cila është gjerësisht në përputhje me vendet me të ardhura të mesme me profile të ngjashme të moshës. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e madh të nxënësve, Kosova shpenzon dukshëm më pak për nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm se disa vende fqinje. Për më tepër, 75% e shpenzimeve të përgjithshme në arsim janë bërë për rrogat dhe rritja e shpenzimeve në arsim është përdorur pothuajse tërësisht për rritjen e pagave në vend të përmirësimit të cilësisë të arsimit (vetëm 0.2% e shpenzimeve në arsim është ndarë për trajnimin e mësuesve). Normat e frekuentimit në arsimin parashkollor dhe arsimin parashkollor janë ende shumë të ulëta (3.7% dhe 74% respektivisht) duke dobësuar përpjekjet për të krijuar një bazë për fillimin e shkollës fillore. Kosova ka marrë pjesë në vlerësimin PISA<sup>7</sup> për herë të parë në vitin 2015, por rezultatet do të jenë në dispozicion vetëm në fund të vitit 2016. Shpenzimet publike për hulumtime dhe inovacione arritën në vetëm 0.05% të PBB-së, nga të cilat vetëm një e pesta është ndarë për kërkime shkencore dhe grante.

**Përpjekjet për të adresuar mospërputhjen e dukshme të aftësive në tregun e punës deri më tani nuk kanë qenë efektive në dhënjen e rezultateve.** Zbatimi i strategjisë së miratuar për vitin 2016-2020 mbi sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë do të varet nga burimet financiare të qëndrueshme dhe burimet njerëzore të përkushtuara. Rreth 40% e të diplomuarve, me një diplomë profesionale dhe 35% e të diplomuarve, me një diplomë universitare nuk posedojnë aftësitë e nevojshme të kërkuara nga tregu i punës. Arsimi dhe programet e trajnimit profesional janë të koordinuara në mënyrë të dobët, mungojnë strategjitë dhe prioritetet e duhura dhe nuk fuqizojnë strategjitë e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

## Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

**Kosova ka bërë një përparim në përmirësimin e kapitalit të saj fizik, por pengesat në sektorin e energjisë mbeten të patrajtuara.** Në vitin 2015, Kosova ka themeluar Komitetin Kombëtar të Investimeve dhe të përgatitur Listën e Vetme të Projekteve (SPP) për priorizimin e projekteve të ardhshme të mëdha infrastrukturore. SPP

duhet të bëhet një mjet i rëndësishëm i planifikimit të investimeve publike të Kosovës. Në vitin 2015, pjesa e buxhetit për shpenzime në investime vazhdon të ulet, duke arritur në 25.8%, nga 38.2% në vitin 2011. Shpenzimet më të mëdha kapitale u bënë në rrugë, me projektin Route 6 e cila morri 35.1%. Zbatimi i dobët i projekteve të financuara nga donatorët thekson mangësitë e kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe vendor.

**Udhëzimi i politikave të PRE:** Rritja e sigurisë së energjisë duke përfunduar masat e planifikuara të efikasitetit të energjisë përfshin stimuj për sektorin privat dhe familjet dhe duke miratuar një plan për rregullimin gradual të tarifave të energjisë për të reflektuar kostot aktuale.

Furnizimi i pasigurt i Kosovës me energji është pengesa më e madhe për zhvillim. Humbjet e mëdha të shpërndarjes në rrjetin e energjisë elektrike dhe efikasiteti i ulët i energjisë dëmtojnë më tej sigurinë e energjisë.

<sup>7</sup> Programi i OECD për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve

Edhe pse investimet në rrjetin e energjisë elektrike kanë përmirësuar stabilitetin e saj dhe kanë reduktuar humbjet teknike në një farë mase, ato mbeten prapa planeve fillestare. Ndërtimi i ri i linjës së interkonjeksionit 400kV me Shqipërinë u finalizua nga ana e Kosovës. Negociatat për ndërtimin e termocentralit të ri me linjit janë ende në vazhdim e sipër.

Spektori hekurudhor është rrënuar nga kapaciteti i dobët administrativ i institucioneve rregullatore dhe gjendja e keqe e infrastrukturës. Projekti për rehabilitimin e hekurudhës nga Prishtina në Mitrovicë është konfirmuar. Investimet në autostradën për Tiranë dhe Shkup kanë larguar fondet e rrugëve lokale të nevojshme për mirëmbajtjen e duhur dhe përmirësimin e standardeve të sigurisë. Kjo mund të shkaktojë që infrastruktura të përkeqësohet më shpejtë, dhe të gjenerojë kosto më të larta të mirëmbajtjes në të ardhmen. Projekti me vlerë prej 409 milionë euro të planifikuara për investim në Brezovicë ka dështuar për shkak të pamundësisë të konsorciumit të investimeve për të siguruar fondet e nevojshme për investime. Digjitalizimi i ekonomisë është duke përparuar ngadalë: depërtimi i internetit për familje arriti në 75.5% dhe depërtimi i internetit për përdorues u rrit në 12.35% në krahasim me 10.51% në vitin 2014.

### Struktura sektoriale dhe të ndërmarrjeve


Përgatitjet e Kosovës mbetet **në një fazë të hershme. Nuk është bërë asnjë përparim** në këtë fushë gjatë periudhës raportuese.

Kosova nuk është anëtare e OBT-së, dhe ende nuk ka ndërmarrë ndonjë hap formal për t'iu bashkuar kësaj organizate.



## 5.2. Politikat sektoriale

### 5.2.1. *Industria dhe NVM-të*

Kosova **ka nivel të përgatitjes** në politikën e industrisë dhe NVM-ve. Janë bërë disa përpertime në këtë fushë, sidomos me krijimin e një skeme të garantimit të kredive për t'i mbështetur NVM-të. Siç është rekomanduar vitin e kaluar, Kosova duhet që në veçanti:

- të ndjek rekomandimet nga vlerësimi i ' Aktit të bizneseve të vogla' të BE-së.
- t'i paraqes vlerësimet rregulative të ndikimit për të zvogëluar barrën administrative të NVM-vë

Për sa i përket **politikës industriale** dhe NVM-ve, implementimi i strategjisë zhvillimore të sektorit privat në Kosovë 2013-2017 po ecën ngadalë, ndërkohë që strategjia industriale duhet ende të finalizohet. Të dyja këto duhet të jenë një linjë me strategjinë e zhvillimit kombëtar 2016-2020 të miratuar në janar të vitit 2016. Nuk ka pasur asnjë raport pasues për vlerësimin e “Aktit të bizneseve të vogla ' të BE-së që nga raporti i vendit i vitit të kaluar. Rekomandimet siç janë, zgjerimi i mbledhjes së statistikave të NVM-ve, komunikimi dhe koordinimi ndërmjet agjencisë Kosovare për investime dhe mbështetje të ndërmarrjeve (KIESA) dhe ministritë përkatëse, nuk kanë pasur asnjë përmirësim. Në mars të vitit 2016, ministria e tregtisë dhe industrisë, me mbështetjen e disa donatorëve ka krijuar një skemë të garantimit të kredive, e cila do të sigurojë mbulimin e pjesshëm të kërkesave indirekte në portofolet e huave të NVM-ve, të bankave pjesëmarrëse në skemë.

Mungesa e vlerësimit të ndikimit rregullativ, përfshirë testet e NVM-ve, mbeten një faktor kyç në barrën administrative, duke ndikuar tek NVM-të, ndërsa dështimi për t'i monitoruar dhe për t'i bërë me kohë strategjitë kohore dhe planet e veprimit e kufizojnë aftësinë e Kosovës për të arritur progres real. Kapaciteti i KIESA-së duhet të rritet në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë misionin dhe objektivat e saj. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet profesionalizimit të institucionit dhe aplikimit të procedurave të punësimit në bazë të meritave. Prioritet duhet t'i jipet zhvillimit të një strategjie promovuese të eksportit dhe programit përkujdesës për investimet e huaja. Parimi ‘heshtja-është-pajtim’ për regjistrimin e biznesit dhe regjistrimit online të kompanisë ende nuk është futur. Pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve dhe rritje të mëtejshme, mbesin qasja e kufizuar në financa, zbatimi i dobët i kontratave dhe rregullave të biznesit, pengesat administrative, konkurrenca e padrejtë nga sektori joformal, gjyqësori joefikas dhe korrupsioni.

### 5.2.2. *Bujqësia dhe peshkimi*

Kosova **ka një nivel të përgatitjes** në zhvillimin e bujqësisë, zhvillimin rural dhe të sigurisë ushqimore, veterinare dhe politikës fitosanitare. Për sa i përket peshkimit, përgatitja është në një fazë të hershme. Me rritjen e alokimit të buxhetit për sektorin e bujqësisë ka pasur **pak progres**. Megjithatë, shumica e rekomandimeve të viteve të kaluara nuk janë zbatuar, ndërsa në vitin e ardhshëm Kosova në veçanti duhet ta:

- përmirësojë dhe të zgjerojë zonën e mbuluar nga skema e konsolidimit të tokës dhe të përgatisë dhe zbatojë një plan veprimi për t'i trajtuar ndryshimet e paligjshme të shfrytëzimit të tokës bujqësore;
- rrisë kapacitetin dhe stafin e agjencisë së zhvillimit të bujqësisë, t'i vendos pagesat, funksionet e kontabilitetit dhe njësia e saj e auditimit të brendshëm;

→ transferojë përgjegjësitë e inspektimit tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, duke e bërë të mundur një sistem të integruar të kontrollit të ushqimit, siç parashikohet me ligj të ushqimit;  
→ themelojë një inventar peshku.

Në **politikën bujqësore dhe të zhvillimit rural**, qeveria ka vazhduar me rritjen e shpenzimeve për bujqësi. Në vitin 2016, buxheti i ndarë për grante të investimeve bujqësore u rrit nga 20 milionë në 23 milionë euro, ndërsa shuma për pagesat direkte kanë mbetur në nivel të njëjtë (23 milionë euro). Megjithatë, mungesa e stafit vazhdon ta pengojë procesimin e duhur të aplikacioneve dhe monitorimin e granteve, subvencioneve dhe ekzekutimin e pagesave. Përveç kësaj, agjencisë së zhvillimit të bujqësisë ende i mungojnë pagesat, funksionet e kontabilitetit dhe njësia e auditimit të brendshëm. Në përgjithësi, transparenca dhe planifikimi i mbështetjes bujqësore duhet të përmirësohet.

Ndryshimet e paligjshme në përdorimin e tokës bujqësore, mbesin një pengesë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe pengojnë zbatimin efektiv të ligjit për planifikimin hapësinor. Nuk ka asnjë informacion se sa tokë bujqësore humb Kosova në baza vjetore, dhe madje as nuk ka ndonjë strategji apo plan veprimi për t'i adresuar këto ndryshime të paligjshme. Është bërë pak në zbatimin e skemave konsoliduese të tokës për të ndihmuar qëndrueshmërinë ekonomike të pronave bujqësore dhe për të krijuar kushte për edukimin e fermerëve si një nga parakushtet për zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e bujqësisë. Një plan i ujitjes në këtë sektor ende mungon.

Regjistrimi i bujqësisë i vitit 2015 ka konfirmuar problemet e mëparshme të identifikuar strukturore të një numri të madh të fermerëve me kushte të dobëta apo mesatare të ekzistencës. Kosova duhet t'i përdor të dhënat e regjistrimit të bujqësisë për të siguruar zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi. Ekzistojnë mospërputhjet ndërmjet Eurostat dhe statistikave të Kosovës. Kosova duhet t'i shtoj përpjekjet e saj për të krijuar një treg bujqësor plotësisht funksional, në veçanti duke rritur mbështetjen për grupet e prodhuesve dhe marketingun e produkteve bujqësore.

Zbatimi i ligjit për prodhimin organik është i dobët. Është krijuar një autoritet mbikëqyrës dhe një komision mbi prodhimin organik, por ka shumë pak prova të aktivitetit. Në sektorin e pylltarisë, vëllimi i prerjeve ilegale është ende shumë i lartë për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.

Në **sigurinë ushqimore dhe sektorët e veterinarisë** nevojiten përpjekje të mëtejshme për të krijuar kushtet për menaxhimin e duhur të impiantit të shëndrimit dhe sistemin e grumbullimit të kafshëve dhe produkteve të tyre. Rishikimi i ligjeve mbi ushqimin dhe kontrollin veterinar ende nuk është përfunduar. Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë së Kosovës, duhet të sigurojë që planet vjetore dhe shumëvjeçare të kontrollit janë përgatitur dhe zbatuar.

Kosovës i mungojnë standardet minimale dhe masat përmbushëse në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies dhe mjedisit. Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë duhet t'i rris përpjekjet e saj duke identifikuar dhe propozuar masa themelore të përmushjes për tu futur në programin mbështetës të bujqësisë 2017. Bartja e përgjegjësiave për inspektime nga komunat tek agjencia është vonuar për shumë vite, për këtë arsye është i pamundur zbatimi i një sistemi të integruar të kontrollit të ushqimit. Mungesa e vazhdueshme e menaxhimit të besueshëm dhe sistematik të të dhënave për identifikimin, lëvizjen dhe regjistrimin e kafshëve, e dëmton politik-bërjen e bazuar në dëshmi. Pa mbikëqyrje të mjaftueshme të tregjeve të kafshëve dhe therjes, të dhënat

aktuale mbeten të pasigurta. Tregtia e paligjshme, veçanërisht në kafshë nga Serbia, vazhdon të jetë një problem. Procesi i përmirësimit të qendrave për përpunim të ushqimit sipas standardeve të BE-së duhet të vazhdojë. Kapaciteti për t'u marrë me sëmundje ngjitëse të kafshëve është mjaft i dobët.

Programi për mbikëqyrjen e sëmundjeve në **sektorin fitosanitar** ende mungon, siç është sistemi i regjistrimit të të dhënave dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm për sëmundjet karantinë të bimëve. Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural dhe agjencia e ushqimit dhe veterinarisë duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre si dhe të planifikojnë parandalimin e hyrjes dhe / ose përhapjes së dëmtuesve të bimëve dhe sëmundjeve të bimëve.

### 5.2.3. Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Kosova është në **një fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë. **Disa përparime** janë arritur, me planifikimin e projekteve të infrastrukturës në sektorin e mjedisit. Megjithatë, nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të zbatuar legjislacionin në të gjitha fushat e ndryshimit të mjedisit dhe klimës.

Meqenëse shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë zbatuar, në vitin e ardhshëm, Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- që të siguroj matjen dhe raportimin e cilësisë së ajrit në kohë reale
- të sigurojë krijimin e një autoriteti të menaxhimit të pellgut lumor dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore dhe përfundimin e rrjetit të monitorimit të burimeve ujore, duke përfshirë monitorimin e ujërave tokësore
- zbatojë Strategjinë Zhvillimore të përshtatjes së ndryshimeve klimatike dhe emetimeve të ulëta, në përputhje me kornizën e BE-së 2030, për politikën e klimës dhe të energjisë.

## Mjedisi

Sa i përket **legjislacionit horizontal**, strategjia për mjedisin ekziston, por duhet të përmirësohet dhe të zbatohet. Zbatimi i masave prioritare në nivel qendror dhe lokal duhet të sigurohet nëpërmjet fondeve të mjaftueshme dhe aftësive administrative dhe teknike. Zbatimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme, veçanërisht për planet, programet dhe projektet në të gjithë sektorët industrial me efekte të rëndësishme për mjedisin, duke përfshirë involvimin e publikut dhe shoqërisë civile. Për pjesëmarrjen efektive të publikut dhe konsultimeve në procesin e vendimmarrjes nevojitet më shumë punë, veçanërisht në nivel lokal. Nevojitet progres i mëtejshëm për t'u lidhur me dhe për t'i zbatuar udhëzimet e mbetura mjedisore ndërsektoriale.

Strategjia kombëtare për **cilësi të ajrit** dhe ligji për cilësinë e ajrit të ambientit janë miratuar, por duhet të zbatohen. Sidoqoftë, ndotja e pakontrolluar nga trafiku, djegia e mbeturinave dhe materialeve të tjera toksike mbetet një problem serioz. Pajisja e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit ekziston, por ende nuk është plotësisht funksionale. Institucionet e Kosovës duhet të ndër marrin masa të menjëhershme për të përmirësuar vlerësimin e cilësisë së ajrit, veçanërisht në zonat e prekura. Burimet financiare dhe kapaciteti për të mbështetur mirëmbajtjen dhe kalibrimin e pajisjeve duhet të sigurohet, sikurse edhe mbështetja për rrjetin automatik të monitorimit të cilësisë së ajrit. Matja në kohë reale e ndotjes së ajrit duhet të vihet në funksion, në mënyrë që të ndër mirren masat e menjëhershme për reduktimin e emetimeve, nëse limitet janë tejkaluar. Planet e cilësisë së ajrit për zonat ku nivelet e ndotësve tejkalojnë vlerat kufitare në një diferencë të madhe, sidomos në dimër, duhet ende të përgatiten dhe po ashtu të miratohen.

**Për menaxhimin e mbeturinave**, kuadri ligjor është i harmonizuar pjesërisht, por mbeturinat mbesin një nga problemet më të dukshme në Kosovë. Draft plani kryesor është finalizuar, i cili definon konceptin e parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave. Megjithatë, Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor duhet të fillojë zbatimin dhe të rris mundësitë për investime në këtë sektor. Përkufizimet dhe konceptet themelore të menaxhimit të mbeturinave, të tilla si riciklimi dhe rigjenerimi i rrymave të ndryshme të mbeturinave, nuk janë të mbështetur sa duhet nga legjislacioni aktual, duke kufizuar mundësitë për përfshirjen e sektorit privat. Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht. Shumica e deponive ekzistuese janë në fund të kapaciteteve të tyre deponuese dhe përballen me rrezik të konsiderueshëm afatgjatë mjedisor, sidomos në ndotjen e ujërave nëntokësore.

Në fushën e **cilësisë së ujit**, niveli i shtrirjes është i kufizuar. Strategji apo plane të veprimit për mbrojtjen e ujit nuk janë miratuar ende dhe përpjekjet urgjente duhet të bëhet në themelimin e autoritetit të menaxhimit të lumenjëve, në mënyrë që të fillohet puna shumë e nevojshme për përgatitjen e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore. Ujërat e zeza të patrajuara mbeten burimi kryesor i ndotjes dhe një kërcënim serioz i ujërave nëntokësore. Duhet të fillojë puna në identifikimin e burimeve nëntokësore dhe vendosjen e sistemit të monitorimit të ujërave nëntokësore. Sistemi për monitorimin e cilësisë dhe sasisë së ujit sipërfaqësor duhet të rivendoset. Nevojitet identifikimi i aglomerateve dhe përcaktimi i zonave të ndjeshme, në përputhje me direktivën e trajtimit të ujërave të zeza. Disa përmirësime janë vërejtur në mbledhjen e faturave si dhe në reduktimet e humbjes teknike të ujit, por duhet të bëhen më shumë përpjekje.

Harmonizimi me *acquis* për **mbrojtjen e natyrës**, në veçanti direktivat e habitateve dhe zogjëve, vetëm sa ka filluar. Në shkurt të viti 2016, Kuvendi miratoi një ndryshim në tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës. Sidoqoftë, mbrojtja efektive për zonat e caktuara të mbrojtura ende nuk është vendosur. Lufta kundër ndërtimeve të paligjshme në zonat e mbrojtura duhet të zbatohet në mënyrë efektive. Planifikimi i investimeve në infrastrukturë, siç janë hidrocentralet, turizmi dhe sektori i industrisë duhet të të sigurojë që detyrimet për mbrojtje të natyrës të respektohen. Kjo vlen sidomos për zonat e mbrojtura dhe zonat me vlerë të lartë natyrore që potencialisht mund të bëhen vende të mbrojtura sipas Natura 2000.

Sa i përket **ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut**, përafrimi me shumicën e udhëzimeve përkatëse të BE-së dhe rregulloreve (IED, Seveso III) është në një fazë të hershme. Zbatimi i pamjaftueshëm i legjislacionit po e pengon progresin në parandalimin e aksidenteve industriale dhe kimike. Procedurat për të emëruar një operator për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme kanë filluar.

Sa i përket **kimikatëve**, përafrimi me *acquis* është në fazë të hershme.

Hapat e ardhshëm drejt arritjes së transpozimit të plotë dhe plani implementues i direktivës për përdorimin e kafshëve për qëllime shkencore nuk janë ofruar ende. Kosova nuk është pjesë e Konventës së Stokholmit dhe nuk ka progres në drejtim të zbatimit të rregullores së ndotësve të qëndrueshëm organik, duke zhvilluar plane konkrete për krijimin e një kornize ligjore që rregullon ndotësit organik. Kosova nuk është pjesë e Konventës së Roterdamit, por një kornizë rregulluese për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme është përcaktuar nga Udhëzimi Administrativ nr 23/2015, e cila tani duhet të zbatohet.

Ligji i ri për zhurmën ende nuk është miratuar. Hartat strategjike të zhurmës dhe planet e

veprimet duhet ende të zhvillohen, si dhe të bëhen veprime të efektshme për zbatimin e ligjit.

Kosova vazhdon të marrë pjesë në mënyrë aktive në **mekanizmin e mbrojtjes civile të BE-së** dhe në disa projekte rajonale që kanë për qëllim forcimin e bashkëpunimit. Ajo ka lansuar një sistem të menaxhimit të katastrofave dhe ka miratuar rregulloren për vlerësimin e dëmeve pas fatkeqësive. Megjithatë, nevojitet progres i dukshëm në fusha të rëndësishme si: mbrojtja nga përmbytjet.

### **Ndryshimi i klimës**

Niveli i shtrirjes është i kufizuar. Strategjia për ndryshime klimatike ka përfunduar, por mbetet për t'u miratuar. Zbatimi i saj duhet të jetë në përputhje me kornizën e BE-së 2030 për politikën e klimës dhe të energjisë, dhe të jetë e mirë integruar në të gjithë sektorët relevant.

Përveç lehtësimit, duhet të bëhen përpjekje edhe për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike. Këshilli kombëtar për mjedis dhe ndryshim të klimës duhet të marrë masa më konkrete për rrjedhën e veprimeve klimatike. Megjithëse Kosova nuk është nënshkruese e Kornizës së Konventës të OKB-së për ndryshimet klimatike dhe për këtë arsye ajo nuk ka përgatitur ndonjë synim kontribues të vendosur në shkallë kombëtare për Marrëveshjen e Parisit të vitit 2015, zbatimi i plotë i strategjisë së ndryshimeve klimatike do ta ndihmonte Kosovën që të arrijë emetime të ulëta dhe objektiva klimatike të qendrueshme. Sa i përket transparencës së veprimeve të klimës, përgjegjësia për hartimin e raporteve mbi gazrat serrë (GHG), mbetet tek agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Raporti GHG për vitin 2012-2013 i është paraqitur Agjencisë Europiane të Mjedisit. Është arritur përafrim i pjesshëm me rregulloren e mekanizmit monitorues nëpërmjet dy akteve nënligjore. Legjislacioni ende nuk është hartuar dhe miratuar mbi monitorimin, raportimin dhe verifikimin e emetimeve të gazrave serrë në mënyrë për ta përafruar me Sistemin e Tregut të Emetimeve të BE-së. Veprime urgjente duhet të ndërmerren në fushën e standardeve të emetimeve dhe kontrollit të ndotjes nga transporti, për zbatimin e legjislacionit në kontrollimin teknik të automjeteve, në cilësinë e karburantit, si dhe substancave dëmtoese të ozonit dhe gazrave të fluorit. Kapaciteti administrativ dhe aktivitetet e ngritjes së ndergjegjes duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme.

#### *5.2.4. Politika e transportit*

Kosova është në **një fazë të hershme / dhe është në nivel të përgatitjes** së politikës së transportit. **Disa progrese** janë arritur sidomos në fushën e aviacionit dhe hekurudhave gjatë periudhës së raportimit, por nevojitet më shumë punë në forcimin e kapaciteteve administrative në të gjithë sektorët. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për dispozitat e trafikut rrugor, Kosova ka përmbushur pjesërisht një prej rekomandimeve të vitit të kaluar.

Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet që në veçanti t'i:

- implementojë dhe zbatoj legjislacionin e sigurisë në trafik, në mënyrë që të zvogëlohet numri i viktimave;
- forcojë kapacitetet e rregullatorit të hekurudhave dhe të siguroj pavarësinë e saj financiare dhe operationale;
- të bëjë përpjekje të mëtejshme drejt njohjes reciproke të patentëve të shoferëve të trenave dhe të shqyrtoj rregullat teknike dhe të sigurisë në transportin hekurudhor.

Për sa i përket *acquis* të transportit të përgjithshëm, dokumentet kryesore strategjike për sektorin e transportit dhe nën-sektorët e saj janë miratuar, por legjislacioni nuk është në

përputhje me *acquis* për aranzhimet verore ose me detyrimet e shërbimit publik. Ekziston nevoja për forcimin e kapaciteteve administrative për të gjitha llojet e transportit. Është miratuar legjislacioni për hetimet e aksidenteve ajrore dhe hekurudhore, por ende nuk është zbatuar, ndërsa organi për hetimin e aksidenteve ende nuk është plotësuar me staf.

Sa i përket **transportit rrugor**, legjislacioni mbi transportin tokësor (rrugor dhe hekurudhor) të mallrave të rrezikshme është harmonizuar pjesërisht. Qasja në treg për mallra dhe transport të udhëtarëve për operatorët kombëtar dhe ndërkombëtar ka nevojë për harmonizim të mëtejshëm, ashtu sikurse kriteret për qasje në profesion të operatorit të transportit rrugor. Për t'i zvogëluar aksidentet me fatalitetet, Kosova duhet të vazhdojë përafrimin me *acquis* sociale dhe të sigurisë në këtë fushë, dhe të monitorojë zbatimin e kapaciteteve. Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore është ende e pamjaftueshme. Lidhur me zbatimin e legjislacionit social, nevojiten përmirësime në fushën e kontrolleve anëve të rrugëve. Legjislacioni për automjete të transportit rrugor të pastra dhe efektive në energji dhe për shpërndarjen e lëndëve djegëse alternative, duhet që gradualisht të harmonizohet me *acquis*.

Sa i përket **transportit hekurudhor**, Kosova ka arritur progres në implementimin e "masave reformuese të lidhshmërisë". Në mënyrë më specifike, autoriteti rregullativ i hekurudhave të Kosovës në dhjetor të vitit 2015 ka licencuar operatorin e parë privat, por certifikata e sigurisë është në pritje. Legjislacioni i sigurisë hekurudhore është miratuar, por duhet bërë përpjekje për ta zbatuar atë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për sigurinë hekurudhore dhe të ndërveprimit. Kapaciteti i hekurudhave të Kosovës (Infrakos) duhet të forcohet në kuadër të investimeve të ardhshme të rëndësishme për këtë sektor. Duhet të sigurohet pavarësia e rregullatorit në zbatimin e kuadrit rregullator dhe të përkrahet pavarësia e saj financiare. Po ashtu emërimet duhet të bëhen në bazë të meritave, në përputhje me ligjin e bordit rregullator të hekurudhave. Me qëllim të krijimit të kushteve për qasje të drejtë dhe transparente në objekte të shërbimeve hekurudhore, Kosova duhet të vazhdojë ta transpozojë dhe zbatojë udhëzimin 2012/34 mbi një zonë të vetme Europiane hekurudhore. Përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore është në një fazë të hershme të zbatimit.

Sa i përket **aviacionit**, Kosova ka bërë progres të konsiderueshëm në përafrimin me *acquis* të BE-së dhe ka zbatuar pothuajse të gjitha kërkesat sipas fazës së parë kalimtare të marrëveshjes Europiane të aviacionit civil (ECAA), me përjashtim të disa dispozitave në fushën e rregullimit ekonomik. Sipas legjislacionit "single European Sky "(SES), Kosova ka përfunduar harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit SES, dhe ka bërë përparim në SES II. Marrëveshjet e punës me agjencinë Evropiane të sigurisë së aviacionit nuk janë themeluar ende. Disa përparime janë bërë në zbatimin e ligjit për agjencinë e navigacionit të shërbimeve ajrore. Megjithatë zbatimi i legjislacionit duhet ende të kompletohet, përfshirë këtu edhe kriteret për pozita drejtuese. Është çertifikuar edhe ofruesi i shërbimit të navigimit ajror.

Në transportin e kombinuar, ende nuk është bërë *legjislacioni kombëtar*.

### 5.2.5. Energjia

Kosova ka bërë **përparime** në përafrimin legjislativ me miratimin e pakos së tretë të energjisë, por ende mbetet në **fazë fillestare** të zbatimit në shumë fusha. Meqenëse shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë zbatuar, në vitin e ardhshëm, Kosova duhet që veçanërisht të:

→ fillojë me zbatimin e *acquis* mbi sigurinë e furnizimit dhe të marrë një vendim përfundimtar mbi kapaciteteve të reja gjeneruese, mbylljen të termocentralit Kosova A, dhe marrëveshjet e pronësisë për Kosovën B;

→ forcojë kapacitetet institucionale për tregun e energjisë, në veçanti duke siguruar pavarësi të plotë të rregullatorit dhe stabilitet financiar, si dhe të vendosë mekanizma transparente për të rregulluar çmimet e energjisë;

→ përfshijë një grup për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve radioaktive në ndërtesën e depos të financuar nga BE-ja, ndërsa vazhdon puna për të gjetur një vend të përhershëm.

→ implementojë ‘Masat reformuese të lidhshmërisë’ që kanë të bëjnë me energji;

→ të miratojë ligjin dhe aktet nënligjore që transposojnë direktivën mbi performancën energjetike të ndërtesave.

Sektori i energjisë vazhdon të përballë me probleme edhe pse është bërë progres në fusha të caktuara, në veçanti me miratimin e legjislacionit që transponon pakon e Energjisë së tretë. Shkurtimeve të energjisë elektrike janë të shpeshta, megjithëse kjo po ua vështirëson qytetarëve jetën e përditshme dhe operimin e rregullt të bizneseve. Kosova është ende mbrapa në implementimin e zotimeve të bëra në kuadër të agjendës së lidhshmërisë.

Sa i përket **sigurisë së furnizimit**, investimet dhe mirëmbajtjet po vazhdojnë ta përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të transmisionit të energjisë. Në nëntor të vitit 2015, Kosova ka përfunduar ndërtimin e seksionit të linjës së transmetimit 400 kV me Shqipërinë. Përderisa humbjet në distribuim janë në rënie, shpejtësia e investimeve në rrjetin e shpërndarjes nuk është e kënaqshme. Humbjet e kombinuara komerciale dhe teknike në vitin 2015 kanë qenë ende të larta në 31.8%. Nuk ka pasur progres në përafrimin e legjislacionit në fushën e rezervave të domosdoshme të naftës. Rezervat aktuale të naftës janë parashikuar të zgjasin vetëm katër ditë. Nuk ka përparim në procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të komunitetit të energjisë për tarifatat doganore mbi importet e produkteve të naftës. Importi i dy produkteve të naftës (lubrifikante dhe koks naftë) është ende subjekt për detyrimet doganore me 10%.

Kosova nuk e ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit 'Ballkani perëndimor 6' të zhvillimit rajonal të tregut të energjisë elektrike dhe në krijimin e një kuadri për bashkëpunim në të ardhmen, e cila është nënshkruar nga të gjitha palët e tjera në prill të vitit 2016. Menaxhmenti paralel që Serbia ka instaluar në hidrocentralet e Gazivodës / Ujmanit vazhdon të ndërhyjë në funksionimin e tij, me një rrezik për menaxhimin e ujit.

Sa i përket **tregut të brendshëm** të energjisë, katër ligje për energjinë, energji elektrike, rregullatorin e energjisë dhe gazin natyror, që kanë për qëllim përafrimin e legjislacionit të Kosovës me pakon e energjisë së tretë, janë miratua në qershor të vitit 2016. Këto ligje mbeten për t'u implementuar. Negociatat me ofertuesin e vetëm për ndërtimin e termocentralit të ri me linjit janë në vazhdim dhe kontrata nuk është nënshkruar ende. Nuk ka përparim në mbylljen e termocentralit Kosova A ose në renovimin e Kosovës B. Kosova duhet të vendosë urgjentisht rreth masave të pronësisë për këtë të fundit, në mënyrë që ta përgatis planin e investimeve të nevojshme për renovimin e saj. Kosova i ka paraqitur në kohë komunitetit të energjisë planin e saj për reduktimin e emetimeve, por ka

shumë pak gjasa se do t'i përmbush detyrimet e saj të cilësisë së ajrit. Nuk është paraqitur asnjë kërkesë për zgjatje të orëve të operimit as për Kosovën A as për Kosovën B.

Sa i përket çmimeve të energjisë, Kosova mbetet tregu më i rregulluar në rajon. Asnjë progres është bërë në liberalizimin e çmimeve prodhuese apo shkrirjen e ndërsubvencioneve në mes të kategorive të ndryshme të konsumatorëve. Ndërsa hapja e tregut parashikohet në legjislacion, kjo nuk është zbatuar në praktikë dhe konsumatorët nuk kanë mundësi të zgjedhin furnizues të ndryshëm. Tre anëtarët e mbetur në bordin e zyrës së rregullatorit për energji janë emëruar në nëntor 2015, por ka shqetësime serioze rreth pavarësisë dhe ekspertizës së tyre. Vendime të rëndësishme për tregun e energjisë elektrike janë vonuar tashmë e një kohë të gjatë, përfshirë këtu miratimin e licencave për furnizuesit të cilët dëshirojnë të konkurrojnë ose miratimin e komutimit dhe disbalancës së rregullave. Kapaciteti dhe pavarësia e zyrës janë penguar nga ndërhyrjet politike, kapaciteti i ulët administrativ dhe mungesa e burimeve njerëzore.

Ka pasur shumë pak progres në sektorin e **energjisë së ripërtëritshme**. Harmonizimi me direktivën për burimet e rinovueshme të vitit 2009 ka qenë në shënjestër të ndryshimeve në ligjet për energjinë dhe rregullatorin e energjisë, të miratuar në qershor të vitit 2016. Ndërsa plani veprues 2013-2020 për rinovueshmërinë dhe efikasitetin e energjisë në Kosovë, parashikon një pjesë shumë ambicioze të ripërtëritjes me 29.47% deri në vitin 2020, tashmë ka shumë pak gjasa që Kosova të mund ta plotësoj edhe objektivin e detyrueshëm prej 25%. Kjo në veçanti ka ndodhur për shkak të neglizhencës së këtij sektori që i është bërë me vite, për shkak të mos efikasitetit të kuadrit rregullator (veçanërisht procedurat e zgjatura administrative në dhënien e lejeve dhe licencave të ndryshme) dhe kapacitetit të dobët administrativ në menaxhimin e ripërtëritjes. Asnjë progres është bërë në ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit, i cili është i dobishëm në arritjen e objektivit të detyrueshëm të vitit 2020. Çdo zhvillim i mëtejshëm i hidrocentraleve duhet të jetë në përputhje me legjislacionin mjedisor të BE-së. Kapaciteti i dobët i rrjetit për t'i menaxhuar të hyrat nga burimet e ripërtëritshme kontribuon edhe më tej në mundësinë e dështimit për t'i respektuar këto zotime. Nuk ka pasur progres në përmbushjen e kërkesave për përdorimin e biokarburanteve në transport. Ende nuk janë zbatuar kritere e qëndrueshme.

Duhet të ndryshohet **ligji për efikasitetin** e energjisë në mënyrë që të harmonizohet legjislacioni me *acquis*. Kosova ende nuk ka miratuar ligjin për performancën energjetike të ndërtesave. Ndërsa plani i veprimit 2010-2018 mbi efikasitetin e energjisë, parashikon një objektiv kursimi të energjisë prej 9%, Kosova tani është në proces të përgatitjes së planit të saj të tretë të veprimit për efikasitetin e energjisë. Kosova ende nuk e ka themeluar fondin e vet për efikasitetin e energjisë. Është e rëndësishme për ta bërë këtë sa më shpejtë të jetë e mundur, për të siguruar më shumë investime në masat e efijencës së energjisë, të kombinuara në mënyrë ideale me masa të tjera të mjedisit, si në sektorin e banimit po ashtu edhe në atë publik. Agjencia Kosovare për efijencë të energjisë nuk ka personel të mjaftueshëm dhe ka kapacitet të ulët për të monitoruar, vlerësuar dhe verifikuar progresin drejt objektivave.

Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes së kuadrit ligjor dhe rregullator për **sigurinë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi**. Ligji për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore ende nuk është miratuar. Përderisa stafi në agjencinë rregullatore është rritur në vitet e fundit dhe është emëruar CEO i ri në vitin 2015, licencimi i agjencisë dhe kapaciteti i inspektimit mbetet ende i dobët. Agjencia nuk ka fonde të mjaftueshme për ta zbatuar mandatin e saj. Nuk ka monitorim të rrezatimit (për shembull të uraniumit të varfëruar), nuk ka kontroll të mbetjeve radioaktive dhe as plan emergjent radiologjik. Procedurat për



të emëruar një operator për menaxhimin e të gjitha mbetjeve të rrezikshme janë nisur në gusht të këtij viti. Ndërtimi i depos për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme i financuar nga BE-ja, duhet të përfshijë një grup për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve radioaktive, ndërsa përpjekjet për të gjetur një vend të përhershëm duhet të përshpëjtohen.

#### 5.2.6. *Informimi i shoqërisë dhe mediave*

Kosova ka një **nivel të përgatitjes** në këtë fushë. Korniza legislative pothuajse është kompletuar, por ende **nuk ka pasur progres**. Në mënyrë të veçantë, kuvendi ka dështuar për të ofruar pavarësi financiare të transmetuesit publik dhe Komisioni i Pavarur për Media, nuk ka ecur përpara me procesin e kalimit digjital. Janë bërë disa përparime në fushën e komunikimeve elektronike. Megjithatë, nevojiten përpjekje për të plotësuar kuadrin ligjor. Pasi që rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë plotësuar, deri në vitin e ardhshëm Kosova duhet që në mënyrë të veçantë të:

- sigurojë se u janë dhënë kapacitete dhe burime të përshtatshme rregulatorëve të telekomit dhe mediave dhe që ata të gëzojnë pavarësi;
- implementojë urgjentisht kalimin digjital;
- gjejë një zgjidhje për financime të qëndrueshme të transmetuesit të shërbimit publik.

Sa u përket **komunikimeve elektronike dhe teknologjive informative të komunikimit**, kuvendi ka emëruar një bord të ri të autoritetit rregullativ të komunikimeve postare elektronike (ARKEP), por nuk ka pasur përmirësim në pavarësinë e tij financiare dhe organizative. Autoriteti ka alokuar frekuenca shtesë për të dy operatorët ekzistues mobil, PTK dhe IPKO, për shërbime më të mira të cilësisë 4G. Depërtimi i telefonisë mobile ka arritur në 97% të përdoruesve aktiv. Depërtimi i internetit për familje është rritur në 75.5%, ndërsa depërtimi i internetit për përdorues është rritur për 12.35%. Edhe pse në vitin 2014 është themeluar ekipi nacional për reagime emergjente kompjuterike, ky ekip ende nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar. Planet për ta futur numrin evropian të emergjencës 112, të paraqitura në vitet e mëparshme, nuk janë zbatuar.

Plani i veprimit i dakorduar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel në vitin 2013, për zbatimin e marrëveshjeve të telekomit, duke përfshirë edhe marrëveshjet për ndarjen e kodit 3-shifror të thirrjeve për Kosovën nga ana e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, ende nuk është zbatuar.

Në **shoqërinë e informacionit**, strategjia kombëtare kibernetike dhe plani i veprimit për vitet 2016- 2019 është miratuar në janar të vitit 2016, por për ta zbatuar këtë dhe strategjinë elektronike qeveritare, duhet pasur në dispozicion burime të mjaftueshme buxhetore.

Në **politikën audiovizuale**, Komisioni i Pavarur për Media nuk arriti të bëjë ndonjë përparim thelbësor në zbatimin e kalimit digjital, edhe pse afati i Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit përfundoi në qershor të vitit 2015. Komisioni i Pavarur për Media, i financuar nga shteti që nga viti 2009, ende nuk i ka finalizuar nënligjet e nevojshme për procesin e digjitalizimit. Asnjë fond nuk është ndarë ose identifikuar për zbatimin e procesit. Kosova ka nevojë për të përshpejtuar përpjekjet e saj dhe të sigurojë që kalimi digjital është kryer në transparencë të plotë dhe në përputhje me standardet e BE-së.

Transmetuesi publik RTK mbetet i varur nga financimi shtetëror, gjë që e dobëson pavarësinë e tij editoriale. Dështimi i asamblesë për të vepruar mbi varësinë financiare të

RTK-së është veçanërisht shqetësues, pasi kjo e dobëson qëndrueshmërinë afatgjate dhe zvogëlon kapacitetin e tij për të kryer përgjegjësinë e saj të shërbimit publik.

#### 5.2.7. *Kontrolli financiar*

Kosova është në fazë të hershme në këtë fushë. Janë bërë **disa përparime** gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në fushën e auditimit të jashtëm me emërimin e Auditorit Kombëtar dhe miratimin e ligjit për auditimin kombëtar. Megjithatë zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP) ka mbetur prapa. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar për KBFP nuk janë adresuar. Përpjekje të mëdha janë të nevojshme për zbatimin e KBFP në të gjitha nivelet e administratës dhe në ndërmarrjet publike. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

→ të intensifikojë implementimin e aktiviteteve të përcaktuara në strategjinë KBFP 2015-2017;

→ të miratojë ligjin e ri të KBFP dhe legjislacionin përkatës implementues;

→ të sigurojë ndjekje më sistematike të rekomandimeve të auditimit të jashtëm nga ana e kuvendit dhe të të audituarit.

#### Kontrolli i brendshëm financiar publik

Kosova është duke zbatuar strategjinë dhe planin e veprimit të KPFB për vitin 2015-2019. të cilat janë plotësuar nga strategjia dhe plani i veprimit i reformërs së menaxhimit publik financiar. Megjithatë, vetëm gjysma e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2015 janë përfunduar. Kjo është shkaktuar kryesisht nga vonesat në finalizimin e ligjit të ri të KBFP. Përveç kësaj, Këshilli i KBFP, i cila ka për qëllim monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e strategjisë, nuk është formuar. Strategjia parashikon një gamë të gjerë të zotimeve mbi përgjegjshmërinë menaxheriale dhe menaxhimin e riskut.

**Njësia Qendrore e Harmonizimit (NjQH)** vazhdon të organizojë trajnime për zyrtarët financiar dhe auditorët e brendshëm, por udhëzimi metodologjik për kontrollin e brendshëm është ende i dobët. Për herë të parë, raporti vjetor për vitin 2015 mbi zbatimin e KBFP është bazuar në standartet e kontrollit të brendshëm. Raporti është shqyrtuar edhe nga Komiteti i Kuvendit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili i ka dhënë NJQH-së rekomandime. Megjithatë mungonin rekomandimet për përdoruesit individual të buxhetit.

Korniza ligjore që e **rregullon menaxhimin dhe kontrollin financiar** në masë të madhe është në përputhshmëri me modelin e Kornizës së Kontrollit të Brendshëm të Komisionit për Sponsorizimin e Organizatave (COSO) dhe udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Ligji i ri i planifikuar i KBFP synon të sigurojë pajtueshmëri të plotë. Zbatimi brenda përdoruesve të buxhetit vazhdon të mbetet mbrapa. Klasifikimi administrativ i buxhetit dhe vartësia e subjekteve dhe oficerëve e bën zbatimin e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe delegacionit shumë të vështirë. Përdoruesit e buxhetit nuk e kuptojnë plotësisht zbatimin praktik të kontrollit të brendshëm dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale. Fokusi është kryesisht në përputhjen financiare të ekzekutimit të buxhetit vjetor, dhe jo mjaftueshëm në menaxhimin strategjik financiar. Menaxhimi i rrezikut rrallë është aplikuar dhe në përgjithësi nuk përdoret si një mjet i menaxhimit. Shumë rialokime të buxhetit ndodhin edhe jashtë procesit të rishikimit të buxhetit.

Legjislacioni mbi **auditimin e brendshëm** është pjesërisht në përputhje me standartet

ndërkombëtare. Vetëm 72% e organizatave të cilave u është kërkuar me ligj për të krijuar një funksion të auditimit të brendshëm e kanë bërë këtë. Nga këto, 32% kanë vetëm një auditor. Është themeluar një skemë për certifikimin e auditorëve të brendshëm, ku 100 nëpunës civilë do t'i nënshtrohen programit të ri certifikimit në vitin e ardhshëm. Deri më tani 70 nga 115 auditorët kanë certifikim ndërkombëtar. Zbatimi i auditimit të brendshëm ende përballet me sfida, pasi që gjetjet dhe rekomandimet nuk janë zbatuar në mënyrë sistematike

### Auditimi i jashtëm

Ligji i ri për Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) u miratua në maj 2016. Ai përcakton pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare të ZKA në përputhje me standardet INTOSAI. Roli i ZKA është i njohur **me kushtetutë**.

Si Auditor i Përgjithshëm Kombëtar, për herë të parë u emërua një shtetas i Kosovës në prill 2016. Në lidhje me **kapacitetin institucional**, ZKA ka 146 punonjës, prej të cilëve 120 janë auditorë. Trajnimi është dhënë në mënyrë sistematike, si në punë dhe jashtë. Sa i përket **cilësisë së punës së auditimit**, ZKA ka vazhduar të zbatojë programin e certifikimit për auditimin e rregullsisë dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me manualin e auditimit financiar dhe të performancës, të cilët janë të përditësuar rregullisht. Menaxhimi i cilësisë së punës së auditimit është kryer nga departamenti mbështetës i auditimit me një staf të përbërë nga gjashtë persona. Ata kryejnë vlerësime të cilësisë dhe kontrollit të cilësisë, si pjesë e proceseve të auditimit.

**Ndikimi i punës së auditimit** duhet të përmirësohet tutje. Raporti vjetor i aktivitetit diskutohet në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike, porse nuk ka vazhdimësi parlamentare sistematike të raportit të auditimit. ZKA-ja i bënë publike online të gjitha raportet e saja dhe i informon mediet në mënyrë proaktive lidhur me raportet e rëndësishme.

### Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

**Përafrimi** me *acquis* është i dobët.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së kërkon bashkëpunim me autoritetet e Kosovës për çdo rast. Në bazë të Kodit penal të Kosovës, mashtrimi i ndërlidhur me financimin e BE-së paraqet një krim. Ministria e Financave është përgjegjëse për të mbështetur aktivitetet kundër mashtrimit dhe kundër korrupsionit në institucionet e administratës publike dhe ngritjen e ndërgjegjësimit për mashtrimin në përgjithësi. Ekziston rregullorja e posaçme e cila i përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e ministrive në këtë drejtim.

Kosova ende nuk ka **shërbim të koordinimit kundër mashtrimit** apo rrjet të ngjashëm mirëpo Prokuroria Speciale e ka mbështetur Komisionin Evropian gjatë hetimeve. Dokumentet e politikave, siç janë strategjitë dhe planet e veprimit mbi parandalimin dhe luftimin e mashtrimit duhet të zhvillohen ende. **Bashkëpunimi me Komisionin Evropian** është i kufizuar për bashkëpunim ad hoc me hetuesit e Komisionit gjatë misioneve të tyre. Nuk ka ende procedura bazë për vlerësimin e rrezikut, raportimin e parregullsive dhe rasteve të dyshuara për mashtrim. Duhet të formohet një sistem për menaxhimin e parregullsive.

### Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Lidhur me **përafrimin me acquis**, legjislacioni i themelon autoritetet kompetente dhe procedurat për trajtimin e falsifikimit të parasë. Medaljet dhe simbolet e ngjashme me monedhat e euros ende nuk janë rregulluar. **Analiza teknike** e falsifikimit të parasë, përfshirë kartëmonedhat dhe monedhat e euros, kryesisht kryhet nga forenzika në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Analizat kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Banka Qendrore nuk kryen analizë teknike, por ajo ofron udhëzime për institucionet financiare mbi atë se çfarë duhet bërëqë të bëjë me të hollat e dyshuara si të falsifikuara. **Nuk ka marrëveshje formale bashkëpunimi** me Komisionin Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane. Kosova merr pjesë në programin Pericles 2020 dhe Iniciativës së Rrjetit të Ballkanit për mbrojtjen e euros.

#### 5.2.8. *Statistikat*

Kosova është **në fazë të hershme/në nivel të përgatitjes** në fushën e statistikave. Janë bërë **disa përparime**, sidomos me aplikimin e standardeve evropiane në prodhimin dhe publikimin e rezultateve të regjistrimit bujqësor në nëntor të vitit 2015. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) vazhdon, megjithatë të vuaj nga kapaciteti i dobët administrativ i cili shpesh rezulton në vonesa të publikimit dhe mungesë së saktësisë në disa statistika. Përpjekje të mëdha janë të nevojshme sidomos për të siguruar përafrimin e statistikave makro-ekonomike dhe të biznesit me standardet evropiane. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti:

→ të miratojë ndryshimin e ligjit për statistikat;

→ të vë në dispozicion më shumë statistika të sektorëve: p.sh statistikat makroekonomike dhe të biznesit, statistikave të energjisë, statistikave të ardhurave dhe kushteve të jetesës;

→ të sigurojë burime të mjaftueshme humane dhe financiare si dhe kapacitete profesionale të stafit për t'i mundësuar ASK-së përmbushjen e mandatit

Sa i përket infrastrukturës statistikore, korniza ligjore në përgjithësi është në përputhshmëri me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Ligji për statistikave duhet të ndryshohet si prioritet për të përmirësuar më tej pavarësinë profesionale të ASK-së dhe për të siguruar qasje me kohë në të dhënat administrative. Megjithatë, kapaciteti i ASK-së për të kryer anketime dhe analiza të të dhënave në mënyrë të pavarur vazhdon të jetë i kufizuar dhe kapaciteti i vet i dobët administrativ dhe profesionale, si dhe mungesa e burimeve financiare pengojnë prodhimin në kohë të statistikave. Mangësitë janë veçanërisht të dukshme në fushën e llogarive kombëtare. I gjithë stafi i ASK-së kanë nevojë për trajnime shtesë, si në çështjet e cilësisë poashtu dhe në metodat statistikore. Premisat aktuale të ASK-së janë të pamjaftueshme. Bartja e të dhënave tek **Eurostat** është përmirësuar, dhe KAS ka përmirësuar shpërndarjen e bazuar në ueb-faqe duke përmirësuar faqen e internetit për shpërndarjen e statistikave. Klasifikimi evropian i aktiviteteve ekonomike (NACE Rev.2) është aplikuar tashmë në të gjitha fushat relevante statistikore. Regjistri statistikor i biznesit është përmirësuar duke futur një platformë elektronike për përditësimin automatik të regjistrimit ndërsa njësitë vendore janë paraqitur. Grupet e ndërmarrjeve nuk janë futur ende.

**Mbi statistikave makroekonomike**, përafrimi i mëtejshëm me Sistemin Evropian të Llogarive 2010 është duke vazhduar në vitin 2016. ASK aktualisht harton llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore. Megjithatë, shkurtimi i periudhës së prodhimit të llogarive kombëtare dhe përmirësimeve në llogaritë tremujore janë sfidat e mbetura. Një kornizë për furnizimin e prodhimit dhe përdorimit është në fuqi, por të dhënat për vitin

2013 dhe 2014 nuk janë publikuar ende. Derisa përgatitjet për prodhimin e llogarive të sektorit vjetore kanë filluar, njoftimet fiskale nuk janë ende në dispozicion. Statistikat e tregtisë mujore të mallrave dorëzohen në Eurostat. Bilanci i të dhënave të pagesave është përpiluar nga Banka Qendrore dhe është përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Të dhënat vjetore dhe tremujore janë dorëzuar në Eurostat. Statistikat financiare të qeverisë janë publikuar çdo vit. Në janar të vitit 2016 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është botuar në bazë të Klasifikimit të Konsumit Individual Evropian, me vitin 2015 si vit bazë.

**Statistikat strukturore të bizneseve** dhe disa statistika afatshkurta janë pjesërisht në përputhshmëri me *acquis* të BE-së, mirëpo disponueshmëria e statistikave afatshkurta është e kufizuar. Statistikat e industrisë dhe ndërtimitarisë në përgjithësi janë në përputhshmëri me rregulloren relevante derisa duhet të zhvillohen statistikat për sektorin e shërbimeve. Nuk ka statistika afatshkurtra mbi aktivitetet e ndërtimit, pasi që Agjencia nuk ka akses në informacionin mbi lejet e ndërtimit. Statistikat PRODCOM (lista e produkteve të Bashkimit Evropian) u prezantuan në vitin 2015. Statistikat e turizmit dhe statistikat e transportit nuk janë ende në përputhje me *acquis* të BE-së. Statistika mbi kërkimin dhe zhvillimin, inovacionin, dhe përdorimin e statistikave të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit nuk prodhohen në mënyrë të rregullt.

Në fushën e **statistikave sociale**, vetëm statistikat demografike janë përgjithësisht në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së. Regjistrimi i popullsisë në katër komunat veriore, i planifikuar për vitin 2016, nuk është kryer. Një studim i rregullt mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës ishte nisur në vitin 2016. Disa statistika të mbrojtjes sociale janë prodhuar, por ato mbi skemën e papunësisë ende duhen shtuar dhe cilësia e të dhënave duhet të përmirësohet. Në korrik 2016, ASK-ja dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së bashku publikuan statistikat e arsimit në bazë të standardeve ndërkombëtare të klasifikimit të arsimit (ISCED), por ende jo sipas ISCED 2011. Një Ankëtë vjetore e Forcave të Punës (AFP) kryhet çdoherë, por rezultatet e vitit 2015 janë publikuar me vonesë. Përgatitjet për një AFP tremujorëshe ka filluar në vitin 2015. Për më tepër, statistikat e indeksit të kostos së punës, strukturës së të dhënave mbi të ardhurat dhe statistikat mbi vendet e lira të punës ende nuk janë prodhuar. Statistikat e shëndetit publik dhe krimin ende nuk janë në përputhje me *acquis* të BE-së. Ekziston nevoja për të koordinuar dhe harmonizuar statistikat sociale në mes të ASK-së, ministrive përkatëse dhe komunave. Përveç kësaj, ASK duhet të marrë parasysh intervistues të përhershëm për anketat kryesore në këtë sektor, siç është AFP.

Në lidhje me **statistikat bujqësore**, rezultatet e regjistrimit të bujqësisë janë publikuar në nëntor të vitit 2015, edhe pse pa pjesëmarrjen e katër komunave veriore. Indekset e çmimeve bujqësore dhe llogaritë ekonomike për bujqësi janë prodhuar në mënyrë të rregullt. Statistikat e pilot studimeve mbi qumështin, prodhimet e qumështit dhe thertoret janë nisur në vitin 2016. Rezultatet e anketës mbi të korrurat dhe bagëtinë të kryer në dhjetor të vitit 2015 ende nuk janë publikuar. Ende nuk prodhohen bilance për furnizim dhe indeks të punës në bujqësi.

**Statistikat mbi energjinë dhe mjedisin** janë pjesërisht në përputhje me *acquis*. Disa të dhëna vjetore mbi energjinë dhe çmimet e energjisë i dërgohen Eurostat mirëpo nevojiten përmirësime të mëtejshme. Të dhënat mujore dhe pjesa mujore e burimeve të ripërtëritshme nuk i dërgohen Eurostat. Mungesa e statistikave për eficiencën e energjisë vazhdon të jetë pengesë për raportim lidhur me kursimin e energjisë. Statistikat për mbeturinat dhe ujin tashmë mblidhen, ndërsa statistikat e emetimit të gazit u prezantuan në vitin 2016, por ende nuk janë publikuar. Të dhënat mbi mjedisin nuk prodhohen.

### 5.3. Drejtësia, liria dhe siguria

Kosova është në fazë të hershme / ka arritur në një shkallë të caktuar të përgatitjes në këtë fushë, por ka bërë progres të mirë gjatë periudhës raportuese. Hetimet për shpërlajen e parave, drogën dhe trafikimin me qenie njerëzore, terrorizmin dhe krimin kibernetik kanë filluar, megjithatë duke rezultuar në pak dënime përfundimtare dhe sasi të kufizuara të konfiskimit të aseteve. Shërbimet e prokurorisë kanë mungesë të stafit dhe të trajnimit. Kapacitetet hetimore të policisë në përgjithësi janë mirë, por përdorimi i policimit të udhëhequr nga inteligjenca në hetime të përbashkëta mbetet i kufizuar. Kosova në mënyrë aktive është duke bashkëpunuar në hetime policore ndërkombëtare dhe rajonale, edhe pse bashkëpunimi i saj formal është i kufizuar, për arsye që ndërlidhen me statusin e Kosovës. Legjislacioni në fushën e migracionit, azilit dhe menaxhimit të kufirit është kryesisht në harmoni me *acquis* të BE-së, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatim. Gjatë vitit të ardhshëm Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ Zbatimit të plotë të qasjes së policimit të udhëhequr nga inteligjenca, duke shfrytëzuar plotësisht potencialin e QKMK-së;

→ rishikimit të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, me synimin për të bërë ato mjete efektive për të luftuar krim të organizuar;

→ forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duke rritur kapacitetin e sistemit ekzistues të IT për të gjitha rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit drejt ndërtimit të të dhënave të gjurmimit të hetimeve proaktive, ndjekjen penale, dënimet përfundimtare dhe konfiskimit të aseteve kriminale me qëllim të arritjes së rezultateve në të dhënat e gjurmimit.

#### 5.3.1. Vizat, menaxhimi i kufirit, azili dhe migrimi

### Migrimi legal dhe ilegal

#### Organizimi institucional dhe përafrimi ligjor

**Kuadri ligjor** është kryesisht në përputhje me *acquis*. Ndryshimet në ligjin për të huajt, me qëllim të përafrimit me direktivat e fundit të BE-së për punësimin e shtetasve të vendeve të treta dhe bashkimin familjar janë në pritje.

**Strategjia** kombëtare dhe plani i veprimit mbi migrimin për vitin 2013-2018 janë duke u zbatuar pa problem. Në janar 2016, qeveria ka emëruar koordinatoren kombëtar mbi migracionin, përgjegjës për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e saj. Roli dhe burimet e tij duhet të forcohen. Profili i vendit mbi migrimin për vitin 2014 u finalizua në dhjetor të vitit 2015. Ajo përmban një analizë të gjerë të të dhënave të migracionit dhe të faktorëve shtytës dhe ndalues së bashku me rekomandimet dhe udhëzimet e politikave të cilat kanë nevojë tani për tu marrë në konsideratë në praktikë. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) në Ministrinë e Brendshme është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të politikës së migracionit. Drejtoria për Migrim dhe të Huajt në policinë kufitare merret me migrantët e parregullt.

#### Kapacitetet e zbatimit dhe përforcimit

Ka disa boshllëqe në zbatim, veçanërisht për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet agjencive qeveritare. Niveli i **stafit** të DSHAM mbetet i pamjaftueshëm në veçanti për divizionet dhe qendrat të cilat përballet një ngarkesë më të madhe. Gjatë periudhës raportuese, specializimi i stafit është forcuar përmes trajnimeve mbi menaxhimin e migracionit, procedurat dhe standardet për trajtimin e të miturve të pashoqëruar, teknikat speciale të intervistimit, identifikimin dhe referimin e azilkërkuesve me nevoja të veçanta, dhe të drejtat e aplikantëve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Kosova ka hapësirë për pritjen e migrantëve të parregullt në Vranidol, për 70 persona, duke përfshirë akomodimin e duhur të grupeve të cënueshme. Ekzistojnë dispozitat ligjore që sigurojnë të drejtat themelore të migrantëve të parregullt ose të të huajve që arrijnë në këtë qendër. Megjithatë, burimet e mjaftueshme dhe të specializuara mbikqyrëse mungojnë për të siguruar të drejtat dhe nevojat themelore. Ekzistojnë masa për të parandaluar depërtimin e **trafikantëve të njerëzve** në qendër dhe nuk ka raste të raportuara të përpjekjeve. Në vitin 2015, 12 persona u arrestuan me akuzën e kontrabandimit të emigrantëve dhe emigrantët e parregullt janë zbuluar, kryesisht nga Shqipëria. Numri i përgjithshëm i migrantëve të parregullt të ndaluar në qendrën e pritjes në mes të shtatorit 2015 dhe gushtit 2016 është 99. Nga 99, 83 **u kthyen** në vendin e tyre të origjinës (78 me forcë, 5 vullnetarisht, 15 persona kanë aplikuar për azil, 1 është në proces të kthimit). Shumica e emigrantëve të parregullt të ndaluar në qendrën e pritjes janë kthyer brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Në dhjetor të vitit 2015, Kosova ka nënshkruar një marrëveshje ripranimi me Turqinë, duke e çuar numrin e marrëveshjeve të tilla në 23. Një marrëveshje me ish-Republikën e Maqedonisë është nën finalizimin. Marrëveshjet e **ripranimit** me shtetet anëtare të BE dhe vendet e Shengenit janë duke u zbatuar pa probleme. Numri i përgjithshëm i shtetasve të Kosovës të ripranuar nga shtatori 2015 deri në fund të korrikut 2016 është 13671 (6747 të detyruar dhe 6924 vullnetarisht të kthyer).

Numri i kërkesave për azil nga qytetarët e Kosovës në vendet e BE-së dhe të Shengenit ka rënë nga 73 215 në vitin 2015, në 6 655 në gjysmën e parë të vitit 2016. Rregullorja për **riintegrim** është ndryshuar në mars 2016, duke u lejuar të gjithë qytetarëve të kthyer në Kosovë për të përfituar nga ndihma për vetëpunësim, financim të planeve të biznesit dhe banim. Gjatë periudhës shtator 2015-26 gusht 2016, 1 506 persona kanë përfituar nga shërbimet e asistencës së qëndrueshme të ofruara nga fondi për riintegrim. Kjo është një rritje të konsiderueshme në krahasim me 336 persona në vitin 2015 dhe 628 persona në vitin 2014.

## **Azili**

### Organizimi institucional dhe përafrimi ligjor

**Kuadri ligjor** për azilin është kryesisht në përputhje me *acquis*. Ligji mbi azilin është duke u rishikuar për tu përafruar më tej me *acquis* mbi procedurat e azilit dhe kushtet e pritjes. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim është organi i shkallës së parë në Ministrinë e Brendshme. Komisioni Kombëtar për Refugjatët shqyrton ankesat. Një apel gjyqësor final mund të paraqitet në Gjykatën e Lartë. Pas refuzimit të kërkesës për azil ose ndërprerjes së procedurës, Divizioni i Departamentit për Kthimin dhe Ripranim është përgjegjëse për zbatimin e vendimit. Synimi për të aplikuar për azil mund të kërkohet në kufi.

### Kapacitetet e zbatimit dhe përforcimit

Për sa i përket **procedurave të azilit**, kapaciteti i autoriteteve kompetente për të vlerësuar

kërkesat për azil duke u bazuar në meritat e aplikimit është ende i dobët dhe trajnimi është i nevojshëm. Niveli i personelit është i pamjaftueshëm duke pasur parasysh rritjen e numrit të kërkesave për azil. Në vitin 2015, 70 persona kanë paraqitur kërkesë për azil, ndërsa nga janari deri në gusht të vitit 2016, 154 persona kanë paraqitur kërkesa për azil. Kosova është ende një vend tranzit. Shumica e aplikantëve zhduken pa përfunduar procedurën. Qendra për Azilkërkuesit përgjegjëse për **prirjen, regjistrimin, akomodimin, dhe lëvizjen e azilkërkuesve brenda dhe jashtë qendrës**, nuk ka staf të mjaftueshëm. Autoritetet kompetente, me ndihmën e organizatave përkatëse ndërkombëtare, kanë hartuar një plan emergjent në rast të një fluksi të emigrantëve/refugjatëve në Kosovë.

Nuk ka pasur raste të raportuara të *dëbimit* në kufi. Edhe pse i paraparë nga nënligji për pranimin dhe trajtimin fillestar të azilkërkuesve, nuk ekziston një sistem referimi në kufi, duke përfshirë qasjen për ndihmë ligjore,

### **Politika e vizave**

Kosova ende nuk e ka të përafuar legjislacionin e saj me listat pozitive dhe negative për viza të BE-së. Numri i konsullatave të Kosovës për lëshimin e vizave u rrit në 14, duke çuar në një rënie të numrit të vizave të lëshuara në kufi (vetëm gjashtë gjatë gjysmës së parë të vitit 2016).

### **Shengeni dhe kufinj**

#### Organizimi institucional dhe përafrimi ligjor

Kuadri ligjor për menaxhimin e kufijve/kufirit të Kosovës është kryesisht në përputhje me *acquis* dhe standardet ndërkombëtare. Projekt amandamentet legjislative mbi ligjin për kontrollin shtetëror dhe mbikqyrjen me qëllim të përafrimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor me *acquis* të BE-së, në veçanti Rregulloren 2016/399, janë në përgatitje e sipër. Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit ka një njësi të përbashkët të rrezikut të inteligjencës dhe analizës së riskut, përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe informatave nga agjencitë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (IBM) (policisë, doganëse dhe agjencisë së veterinarisë dhe ushqimit). Strategjia dhe plani i veprimit i IBM për vitin 2013-2018 është në përputhje me konceptin e BE-së për IBM të vitit 2006 dhe zbatimi rifilloi me emërimin e koordinatorit të ri për çështjet e IBM-it.

#### Kapaciteti i zbatimit dhe përforcimit

Infrastruktura e pikave të kalimit kufitar mbetet e dobët. Megjithatë pajisjet dhe qasja në bazën e të dhënave është relativisht e mirë. Departamenti i Kufirit i Policisë së Kosovës ka staf të mjaftueshëm, me një numër total prej 1 318 oficerëve dhe merr trajnime të vazhdueshme. Policia kufitare trajnohet mbi shërbimin për menaxhimin e kufijve. **Bashkëpunimi ndërmjet agjencive** është i mirë, por duhet të përmirësohet më tej në nivel lokal. Një strategji e policisë kufitare kundër korrupsionit është në fuqi, por asnjë rast i korrupsionit në kufi deri më tani nuk është zbuluar.

Sa i përket **bashkëpunimit në rajon**, Kosova ka lidhur 23 marrëveshje mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Ratifikimi i marrëveshjes kufitare me Malin e Zi është në pritje në Parlamentin e Kosovës. Infrastrukturat e qendrës të përbashkët trepalëshe mes Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës janë përfunduar, megjithatë, protokollin operativ është në pritje për nënshkrim. Në maj 2016, Kosova nënshkroi një marrëveshje pune për ngritjen e bashkëpunimit operacional me Frontex, i cili gjithashtu mbulon migracionin e parregullt.



Kontrollet e daljes janë riparaçitur në kufirin me Shqipërinë, ku të dyja vendet ranë dakord për të ndërmarrë kontrolla të përbashkëta kufitare, duke pasur të dy shtetet nga një polic në të njëjtën kabinë.

Pikat e përkohshme të kalimit të IBM me Serbinë vazhdojnë të jenë plotësisht funksionale. Megjithatë, nuk ka pasur progres në vendosjen e pikave të përhershme të kalimit IBM me Serbinë, dhe në vendosjen e pikave shtesë të përkohshme të përbashkët të kalimit në Kapi dhe Izvor.

### 5.3.2. Shpërlarja e parave

Plani i veprimit për vitin 2014-2018 mbi vlerësimin e rrezikut kombëtar për shpërlarjen e parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit vazhdon të zbatohet pa problem. **Ligji mbi shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit** ekziston dhe është ndryshuar në vitin 2016, por ende nuk është plotësisht në përputhje me *acquis* të BE-së ose rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar (*shih seksionin 4.1.3 - lëvizja e lirë e kapitalit*). Ekzistojnë disa boshllëqe në sistem, duke përfshirë mungesën e kontrollit të duhur të deklarimeve të pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë, sistemet e dobëta dhe të fragmentuara të raportimit mbi subjektet që mbulohen nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), mekanizmat joefikas për sekuestrim dhe konfiskim, sistemin e paqarta të mbikëqyrjes së sektorit financiar, mungesën e dispozitave në lidhje me hapat që do të ndërmerren në rast të ngrirjes së transaksioneve financiare nga NJIF, rregullimin e pamjaftueshëm për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kompetencat e tepruara sanksionuese të NJIF. **Bashkëpunimi** ndërmjet NJIF dhe organeve për zbatimin të ligjit duhet të përmirësohet më tej, veçanërisht në fushën e trajtimit të transaksioneve të dyshimta financiare. Numri i prokurorëve në Prokurorinë Speciale që merren me krime ekonomike, duke përfshirë shpërlarjen e parave, duhet të rritet. Përveç kësaj, duhet të ofrohet trajnim në lidhje me shërbimin, sidomos në pikëpamje të zvogëlimit të EULEX-it. Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta nga subjektet kontrolluese dhe raportuese mbetet i ulët. Në vitin 2015, ka pasur 39 raste (ndaj 110 të pandehurve) të regjistruara për shpërlarje të parave (9 raste të reja në 2015 dhe 30 raste të mëparshme për vitin 2015). Këto raste kanë rezultuar në 6 aktakuza, në krahasim me 18 në vitin 2014. Në vitin 2015, një person është dënuar për shpërlarje parash në krahasim me zero në vitin 2014.

### 5.3.3. Narkotikët

Drejtoria e policisë për hetimin e trafikimit të narkotikëve vazhdon të përqëndrohet në parandalimin dhe reduktimin e furnizimit. Strategjia dhe plani i veprimit për vitin 2012-2017 dhe lufta kundër narkotikëve të paligjshëm ka vazhduar të zbatohet dhe disa grupe kriminale janë shkatërruar. Zbatimi i mëtejshëm i policimit të udhëhequr nga intelijenca mbetet i nevojshëm. Krahasuar me shërbimet e policisë, prokuroria ka mungesë të stafit dhe nuk ka staf të trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për të ndjekur në mënyrë efektive veprat penale të lidhura me drogën. Mungesa e magazinimit të sigurtë të narkotikëve dhe prekursorëve para shkatërrimit është një çështje shqetësuese. Ende nuk është ngritur një proces i përshtatshëm për trajtimin, magazinimin dhe shkatërrimin e prekursorëve.

Kosova bashkëpunon me Qendrën Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Varësisë nga Droga. Është nominuar një pikë fokale ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rritjes së vetëdijes rreth pasojave të abuzimit me drogën. Trajnimi për oficerët e policisë mbi sigurinë e komunitetit dhe mësuesit e përzgjedhur mbi rreziqet e abuzimit me drogën vazhdon. Trajtimi i varësisë dhe terapia me metadon ofrohet, duke forcuar strategjitë për parandalimin dhe reduktimin e abuzimit të drogës. Kosova vazhdon të jetë

vend magazinimi dhe kalimi tranzit për heroinën dhe kanabisin, por konfiskimet mbeten të ulëta. Kosova duhet të intensifikojë luftën kundër kultivimit të drogës dhe trafikimit.

#### *5.3.4. Policia*

Policia e Kosovës është perceptuar si institucioni më i besuar i zbatimit të ligjit. Ky institucion ka rritur numrin në 9 500 në vitin 2016, 84% e të cilëve janë kosovarë dhe 15% janë serbë të Kosovës ndërsa pjesa e mbetur vjen nga komunitetet e tjera. Për 100 000 banorë janë 530 oficerë të policisë, një raport i ngjashëm me vendet e tjera.

Policët janë të trajnuar dhe të pajisur mirë. Forca policore ka disa njësi të specializuara në nivel qendror (p.sh. task forca kundër korrupsionit) dhe regjional (p.sh. njësia kundër drogës dhe trafikimit me njerëz).

Shtigjet e karrierës të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe sistemi i vlerësimit për anëtarët e vet ekzistojnë. Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka ofuar nivel të mirë të **trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme** të policisë dhe organeve të sigurisë publike të tilla si shërbimet korrektuese apo doganore.

Në nëntor 2015, **kodi i vet i etikës** është përmirësuar. Megjithatë, policia është ende subjekt i korrupsionit dhe presionit politik i cili pengon hetimet mbi krimin e organizuar. Bashkëpunimi ndërmjet Inspektoratit të Pavarur Policor (IPK) dhe Policia e Kosovës është i mirë. Megjithatë, bashkëpunimi me prokurorinë është penguar nga ngurrimi i prokurorisë për të hapur raste kundër zyrtarëve të lartë të policisë. Në vitin 2015, IPK-ja ka hapur tre zyra regjionale për ankesa dhe ka marrë një numër të madh të ankesave, 1237 në total, 161 prej të cilave u janë dërguar shërbimeve të prokurorisë dhe rezultuan në 108 akuza dhe 4 vendime.

Përkundër stafit dhe financimit të mjaftueshëm, nuk ka dëshmitarë në kuadrin e programit për mbrojtjen e dëshmitarit, pasi që qytetarët kanë shumë pak besim në sistemit e mbrojtjes të drejtuar nga vendi. Bashkëpunimi në mes të policisë dhe Europol është duke u lehtësuar nga EULEX. Policia tashmë ka kontribuar në hetime të përbashkëta të suksesshme të mbështetura nga EULEX, duke përfshirë edhe shkatërrimin e rrjetit të gjerë të kontrabandimit të emigrantëve në fillim të vitit 2016. Strategjisë dhe planit të veprimit për vitin 2012-2016 i policimit të komunitetit dhe strategjisë dhe planit të veprimit për vitin 2011-2016 mbi sigurinë e komunitetit po u vie fundi me rezultate të suksesshme. Policia duhet ende të bëjë progress në lidhjen e policimit të drejtuar nga intelijenca me konceptimin e policimit të komunitetit dhe poashtu duhet të përmirësojnë komunikimin dhe të formojnë forume për siguri zyrtare të komunave në veri.

#### *5.3.5. Lufta kundër krimit të organizuar*

##### Organizimi institucional dhe përafrimi ligjor

Disa përparime janë bërë dhe Kosova ka krijuar komponentet kryesore të kuadrit ligjor të nevojshëm për luftën kundër krimit të organizuar. Kodi penal dhe kodi i procedurës penale janë kryesisht në përputhje me standardet përkatëse evropiane. Megjithatë, një numër i dispozitave të kodit të procedurës penale dhe ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë seriozisht pengojnë hetimin efektiv dhe ndjekjen penale, të tilla si dispozitat komplekse dhe të pavolitshme mbi konfiskimin, afatet e shkurtëra të hetimit, numri i lartë i mundësive të apelit, dhe dispozitat e paqarta mbi pranueshmërinë e provave dhe për kërkimin dhe bllokimin. Ligji për përgjimin e telekomunikimeve u miratua në maj 2015.

Një strategji e re kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2014-2019) u miratua në maj 2015, por plani i veprimit ende nuk është zhvilluar dhe koordinimi ndërinstucional ende nuk është forcuar.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për vitin 2012-2017 kundër krimit të organizuar vazhdon. 79% e aktiviteteve janë raportuar sit ë zbatuara plotësisht, 13% si të zbatuara pjesërisht dhe 8% si jo të zbatuara. Në janar 2016, Ministria e Punëve të Brendshme prezantoi strategjinë dhe planin e veprimit për vitin 2016-2019 mbi sigurinë kibernetike, duke adresuar shumë çështje siç është mbrojtja e infrastrukturës së TI, zhvillimi institucional dhe ndërtimi i kapaciteteve, partneriteti publiko-privat, përgjigja ndaj incidenteve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Bazuar në ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, departamenti i policisë për hetimin e krimit të organizuar ka themeluar sektorin për hetime të krimeve kibernetike dhe stafi ka marrë trajnim dhe pajisje të specializuara. Policia e Kosovës poashtu ka hartuar strategjinë për vitin 2016-2020 mbi burimet njerëzore për të pasur një përgjigje efikase dhe efektive ndaj tendencave kriminale. Duhet të emërohet një koordinator kundër trafikimit me narkotikë.

#### Kapacitetet e zbatimit dhe përforcimit

Shërbimi i prokurorisë i Kosovës ka ngritur 17 raste të krimit të organizuar kundër 170 të pandehurve që nga fillimi i 2015 deri në shtator 2016. Këto hetime nuk kanë rezultuar ende në dënime. Kosova ka bërë progres në sekuestrimin e pasurive, por kjo ka rezultuar në vetëm disa konfiskimeve përfundimtare të aseteve. Numri i hetimeve financiare është rritur dhe nëntë ekspertë financiarë kundër krimit të organizuar janë trajnuar dhe certifikuar për të rritur më tej kapacitetet në kryerjen e hetimeve. Gjatë vitit 2015, 9.3 kg heroinë, 21.1 kg kokainë dhe 722.8 kg marihuanë janë sekuestruar, ndërsa janë identifikuar 17 banda kriminale dhe pasi veprimet e tyre të paligjshme ndërprerë. Shkalla e dënimeve në rastet kundër trafikimit të qenieve njerëzore mbetet e ulët, pavarësisht se Kosova është burim, transit dhe destinacion për gratë dhe fëmijët e trafikuar.

Kosova ka vendosur një mekanizëm gjurmues të TI të avancuar në operacionet mbi krimin e organizuar të profilit të lartë dhe rasteve të korrupsionit, duke përfshirë konfiskimin dhe sekuestrimin e aseteve dhe vendimeve të formës së prerë për autorët (*shih 2.3-lufta kundër korrupsionit*). Kapaciteti i policisë për luftimin e krimit të organizuar është i mirë, përderisa kapaciteti prokurorial mbetet i dobët. Trajnimi mbi teknikat e hetimit ka vazhduar. Kosova duhet të rrisë nivelin e ekspertizës për trajtimin e hetimeve komplekse kriminale, siç është krimi financiar dhe mashtrimi i prokurimit, e cila është thelbësore për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në mënyrë efektive. Trajnimi i specializuar dhe bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të rritet.

Ekzistenca e grupeve të armatosura dhe përfshirja e tyre në aktivitete të organizuara kriminale të tilla si kontrabanda e armëve dhe mosndëshkimi i dukshëm me të cilin ata janë në gjendje të veprojnë përtej kufijve është shqetësim serioz. Policia e Kosovës ka qenë e përfshirë në disa operacione ndërkufitare mbështetur nga Europol, me kërkesë të shteteve anëtare të BE-së të cilat kryesojnë hetimet kundër këtyre grupeve. Qeveria, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe sistemi gjyqësor duhet të ndërmarrë veprim të shpejtë për të shpërbërë këto rrjete.

Institucionet e Kosovës duhet të kenë zero tolerancë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në praktikë dhe në proceset e vendimmarrjes. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet thelbësore për luftën kundër infiltrimit kriminal të sistemeve

politike, juridike dhe ekonomike.

### 5.3.6. Lufta kundër terrorizmit

Kosova ka qenë e prekur nga radikalizimi dhe luftëtarët e huaj terroristë me rreth 300 shtetas të raportuar si luftëtarë aktivë në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme. Megjithatë, numrat janë në rënie dhe që nga shtatori 2015 nuk ka patur raste të reja të raportuara

#### Organizimi institucional dhe përafrimi ligjor

**Korniza ligjore** e Kosovës është në përputhje me *acquis* të BE-së dhe instrumentet ndërkombëtare të anti-terrorizmit. Kosova ka legjislacion që penalizon fenomenin e luftëtarëve të huaj terroriste në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 2178 (2014). Vepra e financimit të terrorizmit është përfshirë në ligjin për luftimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Kornizës ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive i mungojnë dispozita të veçanta mbi financimin e terrorizmit, por këto asete janë konfiskuar si çdo aset tjetër kriminal sipas rregullave të përgjithshme të konfiskimit. Nuk ka mekanizëm për sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve apo pasurive të tjera që lidhen me terrorizmin në bazë të rezolutave përkatëse të OKB-së. Përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të identifikuar, parandaluar dhe shkatërruar rrjetin e luftëtarëve terroristë të huaj që udhëtojnë në zonat e konfliktit si Irak dhe Siri.

**Strategjia** dhe plani i veprimit i Kosovës kundër terrorizmit ende nuk është në përputhje me strategjinë e BE-së kundër terrorizmit, pasi që nuk i ofrojnë fokus të mjaftueshëm parandalimit. Deri më sot, 57% e aktiviteteve të planit të veprimit janë zbatuar plotësisht, 33% janë zbatuar pjesërisht dhe 10% nuk janë zbatuar fare.

Institucionet kryesore të përfshira në luftën kundër terrorizmit janë Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, shërbimet e inteligjencës, policia dhe shërbimi i prokurorisë. Koordinator i anti-terrorizmit është emëruar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe është përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe strategjive për të luftuar terrorizmin, vlerësimin e inteligjencës strategjike dhe sigurimin e koordinimit. Që nga viti 2010, organi koordinues ndërministror mbi luftimin e terrorizmit ka mbikqyrur aktivitetet e luftimit të terrorizmit.

#### Kapacitetet e zbatimit dhe përforcimit

Në shtator 2015, është miratur strategjia për vitin 2015-2020 dhe plani i veprimit mbi parandalimin e **ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit**. Strategjia është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet fetare, punonjësit social, autoritetet arsimore dhe organizatat e të rinjëve. Sfidat ekzistojnë ende për shkak të mungesës së programeve mbi parandalimin, deredikalizimin dhe riintegrimin, duke marrë parasysh numrin e lartë të **luftëtarëve të huaj të kthyer** nga zonat e konfliktit.

Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve të inteligjencës, veçanërisht midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, mund të ndihmojë në përballimin e kërcënimeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Europol, Interpol dhe Frontex dhe duhet të përdoren më shumë si ndërmjetësues për këtë bashkëpunim. Institucionet për zbatimin e ligjit dhe ato gjyqësore të Kosovës duhet të vazhdojnë të forcojnë përgjigjen e tyre ndaj terrorizmit. Policia ka arrestuar një numër të konsiderueshëm të personave që u janë

bashkuar grupeve terroriste në konfliktet jashtë vendit osë kanë synuar t'i bashkohen. Në vitin 2015-2016, janë nisur hetimet paraprake kundër 78 të dyshuarve, janë kryer hetimet zyrtare kundër 50 të pandehurve, vendimet janë lëshuar kundër 36 të pandehurve dhe 33 të pandehur janë duke u gjykuar. Në maj, një imam u dënua me 10 vjet burg për rekrutimin për një organizatë terroriste (ISIS) dhe nxitje të urrejtjes fetare. Në korrik, 5 të pandehur u dënuan për planifikimin për të xhiruar një video që deklaroi besnikërinë e tyre ndaj ISIS. Ata u dënuan në mes 4 dhe 13 vjet burg.

Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) është një element i rëndësishëm i sistemit të luftimit të financimit të terrorizmit. Megjithatë, ajo nuk ka stafin dhe burimet për të trajtuar në mënyrë efektive këtë fenomen. Ekspertiza e Kosovës në trajtimin e hetimeve komplekse financiare është ende e kufizuar dhe nevojitet më shumë koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit të përfshirë në trajtimin ditor të rasteve. NJIF ka mungesë të stafit për të trajtuar në mënyrë efektive financimin e terrorizmit. Më shumë trajnim është i nevojshme për prokurorët dhe policinë mbi metodat specifike të hetimit (duke përfshirë analizën financiare) në lidhje me grupet ekstremiste fetare.

Kosova ka mungesë të ekspertizës dhe teknologjisë së fundit për të bërë hetime dhe ekspertiza të TI, të cilat janë thelbësore për luftimin e terrorizmit.

#### *5.3.7. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale*

Edhe pse Kosova nuk është palë në shumicën e traktateve shumëpalëshe që rregullojnë bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe civile, ajo zbaton në mënyrë të njëanshme standardet e njohura ndërkombëtare të traktateve. Duke u bazuar në Konventën e Hagës të vitit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, rastet përkatëse trajtohen nga Ministria e Drejtësisë. Në qershor të vitit 2016, Kosova ka aderuar në Konventën e Hagës së vitit 1961 mbi Heqjen e Kërkesës për Legalizmin e Dokumenteve Publike të Jashtme.

Bashkëpunimi gjyqësor mbi çështjet penale rregullohet nga ligji i vitit 2013 për bashkëpunim ndërkombëtar juridik në çështjet penale, si dhe 19 marrëveshje bilaterale me vendet e tjera. Në mars, Kosova ka lidhur një marrëveshje dypalëshe ekstradimi me SHBA-në. Një kornizë ligjore për bashkëpunim gjyqësor mbi çështjet civile do të ndihmojë në sqarimin e rregullave dhe procedurave. Bashkëpunimi është i bazuar në parimin e reciprocitetit me vendet me të cilat Kosova nuk ka një marrëveshje dypalëshe. Në 2015 procedurat për bashkëpunim juridik të ndërsjellë të vendosura në mes Beogradit dhe Prishtinës formojnë bazën për bashkëpunimin gjyqësor ndërmjet autoriteteve gjyqësore në Kosovë dhe Serbi. Vende të tjera të cilat nuk e kanë kanë njohur shtetin kanë pranuar vullnetarisht rolin lehtësues të BE-së.

## **SHTOJCA I –MARRËDHËNIET NË MES TË BE-SË**

Më 1 prill 2016 hyri në fuqi **Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA)** në mes të BE-së dhe Kosovës. MSA-ja është marrëveshja e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës. Kjo është një marrëveshje gjithëpërfshirëse që ofron një kornizë për dialog politik dhe mbulon bashkëpunimin në një shumëllojshmëri të gjerë të sektorëve, duke përfshirë drejtësinë dhe punët e brendshme, tregtinë, arsimin, punësimin, energjinë, mjedisin dhe një sërë fushash të tjera të politikave. Mbledhja inauguruese e Këshillit për Stabilizim Asociim do të zhvillohet në fund të vitit 2016 dhe cikli i parë i takimeve të nënkomisionit do të fillojë duke zëvendësuar takimet e Dialogut të **Procesit të Stabilizim-Asociimit**.

Për të udhëhequr reformat në kuadër të zbatimit të MSA-së, Komisioni dhe Kosova filluan punën në **Agjendën për Reforma Evropiane** për Kosovën. Agjenda përshkruan veprimet prioritare në fushën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, konkurrencës dhe klimës së investimeve, si dhe punësimin dhe arsimin.

Kosova ka vazhduar të adresojë prioritetet e përcaktuara në Raportin e vitit të kaluar. Në veçanti, ajo ka zbatuar reformat mbi sundimin e gjerë të ligjit për të përmbushur kërkesat e mbetura të dialogut për **liberalizimin e vizave**. Që nga viti 2012, Komisioni ka lëshuar katër raporte për progresin e Kosovës drejt liberalizimit të vizave (më i fundit në dhjetor 2015 dhe maj 2016) dhe paraqiti një propozim legjislativ për të hequr vizat për qytetarët e Kosovës në Parlamentin e Këshillit dhe Evropian më 4 maj 2016. Propozimi është duke u shqyrtuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, në pritje të plotësimit të dy kërkesave të mbetura nga Kosova.

Për sa i përket **asistencës financiare**, programi IPA 2015, në kuadër të kornizës financiare të IPA II, u miratua nga Komiteti IPA, më 25 nëntor 2015 me një kontribut të BE-së prej 78 milionë euro, i plotësuar me bashkëfinancim nga Kosova për një buxhet të përgjithshëm prej 81 milionë euro. Në vitin 2015, Zyra e BE-së ka nënshkruar 111 kontrata për projekte në Kosovë me një total prej 55.29 milionë euro. Ajo vazhdoi të sigurojë koordinimin e donatorëve aktivë në Kosovë, duke organizuar - së bashku me Ministrinë e Integritimit Evropian të Kosovës – takime të rregullta koordinuese të donatorëve. Programi IPA 2016 për Kosovën është duke u përgatitur.

Propozimi i vitit 2013 i Komisioni për pjesëmarrjen e Kosovës në **programe të Bashkimit** është duke u diskutuar nga Këshilli.

Institucionet e Kosovës kanë përmbushur obligimet e mbetura që kanë të bëjnë me themelimin e **Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale** për hetimin e akuzave për krime gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Në shkurt 2016, kadri ligjor është plotësuar me ratifikimin e marrëveshjes bilaterale me Holandën, duke lejuar që Dhomat Speciale të vendosen në Hagë.

Deri më sot, sipas qeverisë, Kosova është njohur nga 110 shtete anëtare të OKB-së, duke përfshirë edhe 23 shtetet anëtare të BE.

Gjatë periudhës së raportimit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka vazhduar të ofrojë përditësime të rregullta mbi zbatimin e misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Ai ka përgëzuar Kosovën për nënshkrimin e marrëveshjes së MSA-së. Ai shprehu shqetësimin

për polarizimin e spektrit politik dhe bëri thirrje për udhëheqje të fortë nga autoritetet në Prishtinë dhe Beograd për zbatimin e marrëveshjeve të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, në veçanti për themelimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe.

Forca e udhëhequr nga NATO në Kosovë (KFOR) ka vazhduar të ndihmojë në ofrimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë. Gjatë periudhës së raportimit, ka pasur staf prej 4 600 personave.

## Shtojca II – Shtojca e statistikave

### TË DHËNAT STATISTIKORE (që nga 5.10.2016)

#### Kosovë

Të dhënat themelore	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Popullsia (mijëra)	1)	1 985	1 799b	1 816	1 821e	1 805e	1 772p
Sipërfaqja e përgjithshme e vendit (km <sup>2</sup> )		10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	:

Llogaritë Kombëtare	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Bruto produkti vendor (BPV) (milion €)		:	4 815	5 059	5 327	5 568	:
BPV (euro për kokë banori)		:	2 700	2 800	2 900	3 100	:
BPV (në Standarde të Fuqisë Blerëse (SFB) për kokë banori)		:	:	:	:	:	:
BPV (në Standarde të Fuqisë Blerëse (SFB) për kokë banori) në raport me mesataren e BE-së (EU-28 = 1-100)		:	:	:	:	:	:
Rritja reale e BPV-së: ndryshimi nga viti i kaluar I vëllimit të BPV-së (%)		:	4.4	2.8	3.4	1.2	:
Rritja e punësimit (të dhënat e llogarive kombëtare), në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	:	:	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: rritja e BPV-së (çmime konstante) për person të punësuar, në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	:	:	:	:	:
Njësia e rritjes së kostos së punës, në krahasim me vitin e kaluar (%)		:	:	:	:	:	:
Ndryshimi gjate 3 viteve (T/T-3) në indeksin e rritjes nominale të kosto të punës për njësi 2005 = 100)		:	:	:	:	:	:
Produktiviteti i punës për person të punësuar: BPV-së (në SFB) për person të punësuar, krahasuar me mesataren e BE-së (EU-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto nga sektorët kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		:	15.6	14.8	14.4	14.3	:
Industria (%)		:	19.7	19.9	20.3	19.4	:
Ndërtimtaria (%)		:	9.2	8.2	7.9	7.3	:
Shërbimet (%)		:	55.5	57.1	57.4	59.0	:
Shpenzimet e konsumit final, si përqindje e BPV-së (%)		:	103.4	105.2	104.0	105.2	:
Formimi i bruto kapitalit fiks, si përqindje e BPV-së (%)		:	30.7	26.0	24.8	23.2	:
Ndryshimet në inventar, si përqindje e BPV-së (%)		:	3.3	2.9	2.8	2.6	:
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV (%)		:	19.6	18.2	17.4	19.6	:
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV (%)		:	56.8	52.4	49.0	50.6	:
Formimi bruto i kapitalit fiks nga sektori qeveritar i përgjithshëm, si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:

Biznes	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2010 = 100)		:	:	:	:	:	:
Numri i ndërmarrjeve aktive (numri)		:	35 897	36 886	34 235	34 962	39 815
Norma e themelimit: numri i themelimit të ndërmarrjeve në periudhën referencë (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	12.7	9.4	8.5	9.0	11.7
Norma e shuarjes: numri i shuarjeve të ndërmarrjeve në periudhën referencë (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	4.7	5.5	4.4	6.6	:
Personat e punësuar në NVM, si pjesë e të gjithë personave të punësuar (në kuadër të ekonomisë afariste jofinanciare) (%)		:	64.2	65.1	65.9	67.6	67.8



Vlera e shtuar nga NVM-të (në ekonomi afariste jofinanciare) (milion euro)		:	:	:	:	:	:
Vlera e përgjithshme e shtuar (në ekonominë afariste jofinanciare) (milion euro)		:	:	:	:	:	:

<b>Norma e inflacionit dhe çmimet e shtëpive</b>	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), ndryshimi në raport me vitin paraprak (%)	2)	1.3	7.3	2.5	1.8	0.4	-0.5
**Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të deflatuara të shtëpive (2010 = 100)		:	:	:	:	:	:

<b>Bilanci i pagesave</b>	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Bilanci i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse (milionë euro)	3)	-204	-658	-380	-339	-437	-528
Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: bilanci tregtar (milionë euro)	3)	-941	-2 047	-2 050	-1 996	-2 059	-2 109
Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: shërbimet neto (milionë euro)	3)	-14	256	324	312	336	354
Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: të hyrat neto (milionë euro)	3)	152	111	154	122	114	78
Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: transferet aktuale neto (milionë euro)	3)	599	1021	1193	1222	1172	1149
Nga të cilat qeveria transferon (milionë euro)	3)	490	329	402	342	292	203
**mesatarja e lëvizjes 3 vjet prapa e bilancit të llogarisë rrjedhëse në raport me BPV (%)	3) 4)	:	12.0	11.4	9.5	7.3	7.2e
** Ndryshimi pesë vjeçar në pjesën e eksporteve botërore të mallrave dhe shërbimeve (%)		:	:	:	:	:	:
Investimet e huaja direkte (IHD) neto brenda vendit (milion euro)	3)	:	387.0	213.3	250.2	123.8	287.3
Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)	3)	:	5.0	15.8	30.0	27.3	37.1
nga të cilat IHD e ekonomisë raportuese në 28 vendet e BE-së (milion €)	3)	:	0.0	5.2	21.5	10.1	11.2
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë e raportuar (milion €)	3)	:	392.0	229.1	280.2	151.2	324.4
nga të cilat IHD e 28 vendeve të BE-së në ekonominë e raportuar (milion €)	3)	:	205.3	123.2	172.2	92.5	112.5
**Pozita e investimeve ndërkombëtare neto në raport me BPV (%)	3)	:	2.9	5.0	7.0	5.5	2.8p
Norma e ndryshimit vit pas viti në rrjedhën bruto të remitencave (në valutën kombëtare) nga punëtorët migruarë (%)	3)	:	0.1	3.6	2.5	11.7	8.5

<b>Financat publike</b>	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
*** Deficiti/suficiti i përgjithshëm i qeverisë, në raport me BPV (%)		2.2e	:	:	:	:	:
***Borxhi i përgjithshëm qeveritar, bruto, në raport me BPV (%)	5)	0.0	5.3e	8.3e	9.0e	10.5	12.8
Të hyrat e përgjithshme qeveritare, si përqindje e BPV (%)		:	27.1	30.4	26.8	26.3	29.6
Shpenzimet e përgjithshme qeveritare, si përqindje e BPV (%)		:	28.8	29.0	28.2	27.1	28.0

<b>Treguesit financiarë</b>	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Bruto borxhi i jashtëm i tërë ekonomisë, në raport me BPV (%)		:	29.7	30.0	30.2	32.3	:
Bruto borxhi i jashtëm i tërë ekonomisë, në raport me eksportet totale (%)		:	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat brenda nate, milion €)		891	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M2 (M1 plus depozitat me maturitet deri në dy vite, milion €)		1 111	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion €)		:	:	:	:	:	:
Kredidhënia totale nga institucionet monetare financiare për banorë (e konsoliduar) (million euro)		233	1 841	1 841	1 878	1 957	2 153

** Ndryshimi vjetor i detyrimeve të sektorit financiar (%)		:	:	:	:	:	:
* Rrjedha private krediti, të konsoliduar, në raport me BPV (%)		:	:	:	:	:	:
* Borxhi privat, i konsoliduar, në raport me BPV (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e interesit: shkalla e parasë ditë pas dite, për vit (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e interesit në kredi (një vit), për vit (%)	6)	:	14.14	13.42	12.36	10.70	:
Shkalla e interesit në depozita (një vit), për vit (%)	6)	:	3.49	3.57	3.39	1.07	:
Shkalla e këmbimit të euros: mesatarja e periudhës - 1 euro = ... monedhë kombëtare		1	1	1	1	1	1
Indeksi i shkallës efektive të këmbimit (2010=100)		:	:	:	:	:	:
**3. Ndryshimi për vit (T / T-3) në indeksin e tregtisë së ponderuar efektive të kursit të këmbimit, 42 vende (2005 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e asetëve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		:	491	760	724	746	861

### Tregtia e jashtme në mallra

Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Vlera e importit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)	:	2 437	2 462	2 421	2 538	2 635
Vlera e eksportit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)	:	306	267	272	325	325
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)	:	-2 131	-2 195	-2 148	-2 214	-2 309
Mënyrat e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / çmimeve të importit * 100) (numri)	:	97	87	97	107	107
Hisja e eksporteve në 28 vendet e BE-së në vlerën e totalit të eksportit	:	45.5	41.1	43.5	30.2	32.6
Hisja e importeve në 28 vendet e BE-së në vlerën e totalit të importit (%)	:	41.5	42.6	44.7	42.6	42.2

### Demografia

Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Shkalla e rritjes së natyrshme të popullsisë (ndryshimi natyral): numri i lindjeve minus vdekjet (në 1 mijë banorë)	12.8	11.4b	11.3	:	13.2e	12.4be
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave: vdekjet e fëmijëve nën moshën një-vjeçare për 1000 lindje	15.1	13.1	11.4	:	:	:
Jetëgjatësia në lindje: meshkuj (vjet)	:	:	:	:	:	:
Jetëgjatësia në lindje: femrat (vjet)	:	:	:	:	:	:

### Tregu i punës

Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Shkalla e veprimtarisë ekonomike për personat 20–64 vjeç: hisja e popullsisë 20–64 vjeç që është ekonomikisht aktive (%)	:	:	42.5	46.4	47.7	42.8
*Shkalla e punësimit për personat 20–64 vjeç: hisja e popullsisë 20–64 vjeç të punësuar (%)	:	:	29.7	33.0	31.3	29.1
Shkalla e punësimit të meshkujve 20–64 vjeç (%)	:	:	46.6	51.5	48.4	44.9
Shkalla e punësimit të femrave 20–64 vjeç (%)	:	:	12.4	14.9	14.5	13.2
Shkalla e punësimit të punëtorëve të moshuar (55-64): hisja e popullsisë në moshë 55-64 në punësim (%)	20.1	:	25.8	30.8	29.8	27.2
Punësimi sipas sektorëve kryesorë						
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)	17.3	:	4.6	5.9	2.6	2.3
Industria (%)	15.4	:	19.0	16.8	17.7	18.7
Ndërtimtaria (%)	11.3	:	9.5	11.4	10.9	9.5
Shërbimet (%)	56.0	:	65.0	64.1	67.2	68.3
Të punësuarit në sektorin publik si hise e punësimit të përgjithshëm, personat e moshës 20–64 (%)	:	:	35.0	31.5	31.4s	32.6
Të punësuarit në sektorin privat si hise e punësimit të përgjithshëm, personat e moshës 20–64 (%)	:	:	65.0	68.5	68.6s	67.4
Shkalla e papunësisë: hisja e fuqisë punëtore të papunë (%)	49.7	:	30.9	30.0	35.3	32.9

Shkalla e papunësisë te meshkujt (%)		40.3	:	28.1	26.9	33.1	31.8
Shkalla e papunësisë te femrat (%)		71.9	:	40.0	38.8	41.6	36.6
Shkalla e papunësisë te rinia: hisja e fuqisë punëtore 15–24 vjeç të papunë (%)		74.9	:	55.3	55.9	61.0	57.7
Shkalla e papunësisë afatgjate: hisja e fuqisë punëtore që ka qenë e papunë për 12 muaj apo më tepër (%)		21.2	:	18.5	20.7	26.1	23.8
Shkalla e papunësisë për personat (e moshës 25–64 vjeç) që kanë përfunduar jo më shumë se arsimin e mesëm (ISCED 0–2) (%)		:	:	43.9	37.3	44.0	45.5
Shkalla e papunësisë për personat (e moshës 25–64 vjeç) që kanë përfunduar arsimin terciar (ISCED 5 & 6) (%)		:	:	12.8	13.4	17.1	17.4

#### Kohezioni social

	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Mëditjet dhe pagat mesatare nominale (valutë kombëtare)		:	:	:	:	:	:
Indeksi i mëditjeve dhe pagave reale (indeksi mëditjeve dhe pagave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2000 = 100)		:	:	:	:	:	:
Koeficienti GINI		:	:	:	:	:	:
Hendeku i varfërisë		:	:	:	:	:	:
*Braktisja e hershme e shkollës dhe trajnimeve: hisja popullore 18–24 vjeç me më së shumti shkollim të mesëm të ulët që nuk vijojnë më mësim apo trajnime (%)		:	:	:	:	:	:

#### Standardi jetesës

	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Numri i automjeteve të udhëtarëve në raport me madhësinë e popullsisë (për një mijë persona)		:	111.2	111.3	124.7	160.1	193.0
Numri i parapaguesve të telefonisë mobile në raport me madhësinë e popullsisë (për një mijë persona)		158.7	543.7	532.5	:	487.8	464.3
Depërtimi i Telefonisë Mobile (për 100 banorë)		:	:	:	:	:	:
Depërtimi i Telefonisë Fikse (për 100 banorë)		:	:	:	:	:	:

#### Infrastruktura

	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat funksionale për 1000 km <sup>2</sup> )		:	30.6	30.6	30.6	30.6	30.6
Gjatësia e autostradave (kilometra)		0	38	60	80	80	80

#### Inovacionet dhe hulumtimi

	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Shpenzimet publike në arsim në raport me BPV (%)		:	4.1	4.0	:	4.4	:
* Bruto shpenzimet vendore për R&D në raport me BPV (%)		:	:	:	:	:	:
Ndarjet buxhetore të qeverisë apo shpenzimet për R & D (GBAORD), si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:
Përqindja e ekonomive familjare që kanë qasje në internet në shtëpi (%)		:	57	:	:	:	:

#### Mjedisi

	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
* Indeksi i emetimit të gazrave serrë, CO2 ekuivalent (1990 = 100)		:	:	:	:	:	:
Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg nafte ekuivalent për 1000 euro BPV me çmime konstante të 2010)		:	553.2	504.7	473.5	432.2	:
Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtërishe në % të bruto-konsumit elektrik		:	:	:	:	:	:
Hisja rrugore e transportit të mallrave brenda vendit (% e ton-km) (%)		:	:	:	:	:	:

<b>Energjia</b>	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Prodhimi primar i gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE)		1 407	1 795	1 749	1 792	1 605	:
Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi primar i thëngjillit të fortë dhe linjtit (1,000 TOE)		1 236	1 545	1 496	1 532	1 342	:
Prodhimi primar i gazit natyror (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Net importi i të gjitha produkteve energjetike (1,000 TOE)		534	700	650	506	523	:
Bruto konsumi i energjisë brenda vendit (1,000 TOE)		1 998	2 542	2 384	2 314	2 138	:
Gjenerimi elektrik (mijëra GVWh)		3.2	5.7	5.9	6.2	5.3	5.9

<b>Bujqësia</b>	Note	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Indeksi i mallrave dhe shërbimeve në vëllimin e prodhimit bujqësor (çmime të prodhuesit) (viti i kaluar = 100)		:	:	:	:	:	:
Sipërfaqja e punuar bujqësore (1,000 ha)	7) 8)	:	243e	276	295	414be	421p
Bagëtia: gjedhe të gjalla (1,000 krerë, fundi i periudhës)	8)	:	362e	314	321	270e	259
Bagëtia: derra të gjallë (1,000 krerë, fundi i periudhës)	8)	:	51e	56	49	44e	41
Bagëtia: dele të gjalla dhe dhi të gjalla (1,000 krerë, fundi i periudhës)	8)	:	247e	123	160	233e	218
Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit në fermë (gjithsej qumësht i papërpunuar) (1,000 tonë)		:	:	:	:	:	:
Të korrat: drithërat (përfshirë orizin) (1,000 tonë)	8)	:	435e	442	540	464e	444
Të korrat: panxharsheqeri (1,000 tonë)		:	:	:	:	0	:
Të korrat: perimet (1,000 tonë)	8)	:	247e	117	185	202e	146

= nuk është në dispozicion

b = ndarje në seri

e = vlerë e përafërt

p = e përkohshme

s = vlerësim i përafërt i Eurostat

\* = treguesi Europe 2020

\*\* = Treguesi i Procedurës së Çekuilibrit Makroekonomik (MIP)

\*\*\* = të dhënat për deficitin qeveritar dhe borxhin e vendeve në zgjerim publikohen ashtu siç janë, pa u siguruar për cilësinë dhe përputhshmërinë e tyre me rregullat e ESA.

1) 2011: të dhënat bazohen në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 dhe shifrat e përafërta të cilat Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) i ka për tri komunat veriore të cilat nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë si dhe rritjen natyrore për periudhën 15 prill - 31 dhjetor 2011.

2) Që nga janari 2015 indekset e çmimeve të konsumit (IÇK) janë harmonizuar dhe janë publikuar si indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit (IHÇK).

3) 2011–15: bazuar në doracakun për bilancin e pagesave, edicioni 6 (BPM6)

4) 2015: e matur për nëntë muajt e parë të 2015

5) 2011–15: vlera e BPV-së është marrë nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

6) Përfshinë tarifën për disbursim të ngarkuar nga bankat

7) 2014 dhe 2015: duke përfshirë token e përbashkët bujqësore

8) 2014: Burimi i të dhënave është regjistrimi i 2014 i bujqësisë i bërë në 34 (e 38) komunat e Kosovës; të dhënat për katër komunat mospjesëmarrëse në veri të Kosovës janë vlerësuar